# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXIII - Nr. 7362 E enjte 23 Nëntor 2017 **Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)**

Recensioni i Ditës

Nga ALEKS LUARASI



## "Dritëhijet e një diplomati si Konica"

Punimi i autorit Agron Alibali "Faik Konica, dritëhijet e një diplomati", (Argeta LMG, Tiranë, 2016) është pëlqyer nga lexuesit e shumtë të ... Vijon në faqen 19



Opinioni i Ditës

Nga BARDH SPAHIA

## Nuk ka shpëtim për Edi Komikun

Nga java në javë dhe nga muaji në muaj, kjo qeveri e delegjitimuar po demonstron të gjitha plagët e lëngimit, kalbëzimit dhe rrëzimit gradual dhe ... Vijon në faqen 22

**KESTI I TETE I LEKEVE. FORMULA E PAGESES PER PERFITUESIT**

# TE PERNDJEKURIT, QEVERIA: SI NDAHEN 350 MILIONE LEKE

VKM-ja, mbyllet kësti i 8-të për ish të dënuarit politikë që janë gjallë dhe mbi moshën 75 vjeç. Shpërndarja e parave brenda 2017-ës




*(Në foto)* Ish-të përndjekur në protestë

Në faqen 8



Flekenshtain: Politika jashtë prokurorisë

# "Habilaj" fundos policinë, tre zyrtarë të lartë gati për pranga

Prokuroria: Jael Çela, Gjergj Kohila e Sokol Bode lejuan trafikimin e drogës drejt Italisë

Nga INA ALLKANJARI

Prokuroria e Krimeve të Rënda në vijim të hetimeve për dosjen "Habilaj", ka lëshuar dje urdhër-arreste për tre ish-zyrtarët e policisë së Vlorës. Bëhet fjalë për ish-drejtorin e policisë së Vlorës, Jael Çela, shefin e sektorit të Luftës Kundër Krimit... Në faqet 2-3

KONVENTA

## Kryemadhi: Rama me paratë e krimit blen ndërkombëtarët

Në faqen 6

VENDIMI

## Radarët, kontrata e re me SHBA për shërbimin ujor

Në faqen 5

KERKESA

## "Hatiaj", akuza: italianët të ndajnë mendjen për ekstradimin

Në faqen 7

INVESTIMET NE SHENDETESI

## Lajm i mirë, prej janarit dyfishohet ndihma ekonomike

Në faqen 11

DEBATET TE LIGJET



## Halimi: Xhiroja vjetore e drogës 5 mld. Fino: Nuk do merrni pagën

Në faqen 4

Akademikët i përgjigjen Kryeministrit: Institucionin e dëmtoi politika, është simbol i kombit

# Rama: Akademia e Shkencave, shtëpi varrimi

*Shefi i qeverisë kërkon rithemelim: Keni afat deri në mars për ndryshim*

Nga FATMIRA NIKOLLI

Kryeministri Edi Rama ka pritur dje në Kryeministri një përfaqësi të Akademisë së Shkencave pas kërkesës së kësaj të fundit për një bisedë me shefin e qeverisë. Marrëdhëniet



Akademi-qeveri prej muajit shtator janë të ngrira, çka ka çuar në dorëheqje të kryetarit dhe nënkryetarit të zgjedhur në 4 shtator, Gudar Beqiraj dhe Muzafer Korkuti. Ndërsa kryeministri pat kërcënuar me prerje të buxhetit vjetor të Akademisë, para ... Në faqet 14-15

# ÇESHTJA "TAHIRI"
## REAGIMET



Raportuesi për Shqipërinë: Hapja e negociatave me BE, sa më shpejt

# "Tahiri", Fleckenstein: Të hetohet, shpresojmë të mos zhduket askush

## "Kolegët amerikanë po e shohin me vëmendje çështjen"

*Raportuesi për Shqipërinë, Knut Fleckenstein deklaroi në një intervistë ekskluzive për "ABC News", se nuk ka rrugë tjetër përveçse çeljes së dritës jeshile për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Ai shpreson që shtetet anëtare do ta mbështetin këtë rekomandim dhe nxit qeverinë shqiptare për rezultate të mëtejshme në procesin e vetingut dhe 5 prioritetet. I pyetur për hetimin ndaj ish-ministrit Saimir Tahiri, ai u shpreh: "Di që Prokuroria e Krimeve të Rënda të Shqipërisë mund të vazhdojë hetimet dhe të shpresojmë që asnjë nuk do zhduket ndërkohë. Kam gjithashtu informacione nga kolegët e mi amerikanë, se ata po e shohin këtë çështje me vëmendje".*



Raportuesi për Shqipërinë, Knut Fleckenstein

**DEKLARATA E JUNKER**

"Ishte një tjetër përgatitje joprofesionale nga ana e presidentit Juncker. Kjo, pasi presidenti Juncker nuk donte të thoshte që ne merremi vetëm me ata që janë më të avancuar në garë. Por kur të prezantohet strategjia e re e Komisionit Europian në shkurt, do të jetë e qartë që flitet për të 6 vendet e Ballkanit", tha dje Fleckenstein.

**Në kuadrin e tryezës së nivelit të lartë ndërparlamentar me deputetë të vendeve të Ballkanit, ju jeni takuar edhe me delegacionin shqiptar. Të gjitha forcat politike bashkohen se qytetarët e Shqipërisë e meritojnë hapjen e negociatave, por ata ndahen lidhur me forcën politike që mund të hapë negociatat dhe të mbajë barrën e tyre. Ç'mendoni për këtë?**

Unë mendoj se vendimi për hapjen e negociatave duhet të merret sa më shpejt në Bruksel. Duhet të tregojmë se duam të hapin negociatat e anëtarësimit. Ka një vullnet të qartë të Komisionit Europian dhe të Parlamentit Europian dhe shtetet anëtare duhet të marrin një vendim për këtë. Nuk ka rrugë tjetër, përveçse hapjes së negociatave. Kush do ta bëjë këtë në Shqipëri? Jam i sigurt që qeveria do të gjejë një zgjidhje, pasi ajo është zgjedhur për këtë. Sigurisht që i takon opozitës që të tregojë nëse ka gabime dhe unë e marr seriozisht faktin që mund të ketë gabime. Ne duhet t'i shohim ato dhe ndoshta ne mund të japim ndihmën tonë. Por shtrohet pyetja se si mund të thuhet që kjo qeveri nuk mund t'ia dalë këtij procesi, ndërkohë që qytetarët kanë vendosur ndryshe.

**Në kuadrin e luftës kundër krimit të organizuar ka një çështje aktuale, që ka krijuar tension në politikën shqiptare, që është dosja "Tahiri". A mendoni se vota në Kuvendin e Shqipërisë për të mos hequr imunitetin për arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, por kufizimin e imunitetit vetëm për kontrollin e personit dhe të banesës së tij ishte rruga e duhur për ta lënë drejtësinë të bëjë punën e saj?**

Nuk mund të them me siguri se cila palë ka të drejtë dhe cila e gabuar. Në këndvështrimin tim, nëse prokuroria do të kishte prova të mjaftueshme, duhet të ishte hequr imuniteti për arrestim, por më pas u argumentua që mund të bëhej hetim duke kontrolluar personin dhe banesën e tij, pa qenë nevoja për arrestim. Nuk e di ç'është e drejtë apo jo, pasi nuk kam folur me prokurorinë. Gjithsesi, nuk e kuptoj se ç'lidhje ka kjo me procesin e vetingut, pasi ai proces ka të bëjë me skanimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve për funksionimin e sistemit të ri të drejtësisë. Ndërsa, çështja për të cilën po flasim është një çështje e veçantë. Di që Prokuroria e Krimeve të Rënda të Shqipërisë mund të vazhdojë hetimet dhe të shpresojmë që asnjë nuk do zhduket ndërkohë. Kam gjithashtu informacione nga kolegët e mi amerikanë, se ata po e shohin këtë çështje me vëmendje.

**Ç'mendoni për deklaratën e presidentit Juncker, që iu referua një anëtarësimit të mundshëm të Serbisë dhe Malit të Zi në 2025, pa përmendur vende të tjera të Ballkanit?**

Ishte një tjetër përgatitje joprofesioniste nga ana e presidentit Juncker. Kjo, pasi presidenti Juncker nuk donte të thoshte që ne merremi vetëm me ata që janë më të avancuar në garë. Por, kur të prezantohet strategjia e re e Komisionit Europian në shkurt, do të jetë e qartë që flitet për të 6 vendet e Ballkanit.

**Një nga deputetët e opozitës shqiptare ka ngritur shqetësimin për gjuhën e rrumbullakosur dhe jo të drejtpërdrejtë të Brukselit lidhur me problematikat kryesore në vend. Po t'u referohemi deklaratave të përfaqësueses së lartë, Federica Mogherini kishte shumë përgëzime dhe progres. A ndihmon kjo gjuhë?**

Unë e kuptoj këtë kritikë. Së pari, është bërë progres. Shqipëria ka bërë progrese dhe këtu nuk flasim vetëm për qeverinë, por edhe procesin legjislativ në Kuvend. Por sigurisht që ne duhet t'u referohemi edhe deficiteve. Nuk flasim për deficite në stabilitet, por në vende të ndryshme të rajonit ka sërish mungesa në reforma të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, pavarësisë së drejtësisë, lirisë së mediave jo përmes formulimit të bukur të dokumenteve, por zbatimit të tyre. Sigurisht që nuk është e lehtë dhe nuk mund të bëhet me një të rënë të shkopit, por sigurisht që ka deficite dhe ne duhet t'i themi ato.

### Takimi për politikën e jashtme, Çuçi: Opozita hodhi baltë

## Bushati: Presim rezultate të matshme nga vetingu në pranverë, partnerët na vlerësojnë

Frytet e para të reformës në drejtësi do të jenë thelbësore në vendimmarrjen e vendeve të Bashkimit Evropian për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. "Vendimmarrjen ne e presim në këshillin e qershorit të vitit që vjen. Fillimisht në nivelin e ministrave të Jashtëm dhe më pas të kryetarëve të qeverive dhe shteteve anëtare të BE. Në maj do të ketë një samit të nivelit të lartë për herë të parë për Ballkanin Perëndimor që nga Samiti i Selanikut përgjatë Presidencës bullgare, ku kryetarët e qeverive të vendeve anëtare të BE dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor do të ulen së bashku për të diskutuar procesin e zgjerimit dhe përshpejtimin e këtij procesi për vendet e Ballkanit Perëndimor", bëri të ditur ministri Bushati gjatë takimit të tretë sektorial për politikën e jashtme dhe integrimin. Sipas tij, "ka pasur spekulime politike dhe mediatike në Shqipëri, duke lidhur deklaratat e presidentit të Komisionit Europian, përsa i përket kësaj strategjie vetëm me dy vende, Malin e Zi dhe Serbinë. Është fakt që Serbia dhe Mali i Zi janë më të përparuara në këtë proces nga pikëpamja formale. Mali i Zi ka hapur rreth 24 kapituj, Serbia është në fazat e para të bisedimeve për anëtarësim dhe është krejt e natyrshme për dy vende që janë në pistë të ketë një fokus më të madh. Ne presim - tha Bushati - që në pranverë të kemi rezultate të matshme nga verifikimi i rreth 800 personave, nga maja më e lartë e gjyqësorit, e prokurorisë e deri në bazën poshtë. Partnerët po ashtu - tha Bushati - i njohin përpjekjet e qeverisë shqiptare




në luftën kundër kanabisit si dhe kanë një vlerësim pozitiv sa i takon reformës në administratën publike". Ndërsa, kryetarja e Komisionit parlamentar për Punët e Jashtme, Mimi Kodheli theksoi se nga takimet e zhvilluara me komisionet homologe në vendet e BE është konstatuar se ata nuk janë skeptikë, por mbështetësit më të mëdhenj të reformimit të shtetit tonë. Nënkryetari i Komisionit të Integrimit, Bledi Çuçi tha: "Opozita ka hedhur baltë mbi Shqipërinë". Lidhur me këtë, ai u kërkoi anëtarëve të komisionit të fokusojnë punën në neutralizimin e baltës që po hedh opozita mbi Shqipërinë. "Është shumë i rëndësishëm konsolidimi i imazhit të Shqipërisë në sytë e Evropës", tha Çuçi.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafile VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



**ISH-ZYRTARET**

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka lëshuar dje urdhër-arreste për tre ish-zyrtarët e policisë së Vlorës. Bëhet fjalë për ish-drejtorin e policisë së Vlorës, Jael Çela, shefin e sektorit të Luftës Kundër Krimit të Organizuar në drejtorinë e qarkut Vlorës, Gjergj Kohila si dhe ish-drejtorin e Postës së Dhërmiut, Sokol Bode



### Prokurorët kandidatë për KLP dhe KED

## I pari në listë Llalla, me 13 prokurorë i dorëzohen vetingut

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka aktualisht në proces kontrollin e dosjeve për 13 prokurorët që janë të parët që po i nënshtrohen vetingut, pasi kandidojnë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Kryeprokurori Adriatik Llalla është i pari në listë që i "dorëzohet" vetingut. Prej disa ditësh Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka nisur nga puna për kontrollin e dosjeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Aktualisht në filtër po kalohen dosjet e përzgjedhura me short të 13 prokurorëve, të cilët janë kandidatë për KLP dhe KED. Në Prokurorinë e Përgjithshme janë përzgjedhur për t'u kontrolluar nga tri dosje për kreun e akuzës Adriatik Llalla, për anëtarin e KED Rovena Gashi si dhe për tre kandidatët për Këshillin e Lartë të Prokurorisë Kosta Beluri, Anila Leka, dhe Arben Dollapi. Në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, procesit të vetingut po i nënshtrohen Besnik Muçi, Gentian Osmani dhe Gentian Trenova. Ndërsa te prokuroria e Tiranës po kalojnë në këtë proces kontrolli Dritan Rreshka, Antoneta Sevdari, Shpëtim Kurti, Arben Nela dhe Adriatik Cama.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

Njoftim: Ne date 01.12.2017 ne oren 16.00 ne zyren e permbaruesit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit llojit "Apartament" me siperfaqe 52.01 $m^2$, me volum 1, faqe 175, numer pasurie 1/214+2-15, ne zonen kadastrale 1664, me adrese Lagjia "Puntori", Pll.14, Shk.2, Kt.3, Ap.15, Fushe Kruje.Cmimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 1,361,671.36 (nje milion e treqind e gjashtedhjete e nje mije e gjashteqind e shtatedhjete e nje pike tridhjete e gjashte) lekë.

### Masa ndalimi për Jael Çelën, Gjergj Kohilan e Sokol Boden

# Dosja "Habilaj", urdhër-arreste për 3 ish-zyrtarë të policisë së Vlorës

## Prokuroria: Lejuan trafikimin e drogës drejt Italisë

Ina Allkanjari

Prokuroria e Krimeve të Rënda në vijim të hetimeve për dosjen "Habilaj", ka lëshuar dje urdhër-arreste për tre ish-zyrtarët e policisë së Vlorës. Bëhet fjalë për ish-drejtorin e policisë së Vlorës, Jael Çela, shefin e sektorit të Luftës Kundër Krimit të Organizuar në drejtorinë e qarkut Vlorës, Gjergj Kohila si dhe ish-drejtorin e Postës së Dhërmiut, Sokol Bode. Masa e ndalimit ndaj tre ish-zyrtarëve është dhënë pasi akuzohen për mosveprim ndaj kultivimit të kanabis sativa në këtë qark, duke lejuar trafikimin e drogës së Habilajve në drejtim të Italisë. Urdhër-arrestet e lëshuara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda i janë dërguar për ekzekutim Policisë së Shtetit. Mësohet se ish-drejtori i policisë së Vlorës, Jael Çela, është shkarkuar nga detyra në prill të këtij viti me vendim të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Çela ka drejtuar policinë e Vlorës nga shtatori i 2014 deri në prill 2017. Ndërkohë ish-drejtori i Postës në Dhërmi, Sokol Bode ka qenë prej kohësh në vëmendje të publikut dhe medias, pas publikimit të një foto ku shihej përkrah Florian dhe Moisi Habilajt, (ky i fundit i arrestuar pak kohë më parë në Itali për trafik droge). Mësohet se -prokuroria po verifikon dhe tetë ish-zyrtarë të tjerë të policisë së Vlorës të dyshuar, gjithashtu, si pjesë e grupit kriminal të trafikut të drogës.



Jael Çela



Alban Çela



Gjergj Kohila

**ISH-MINISTRI TAHIRI**

Tre ish-zyrtarët e policisë së Vlorës akuzohen se kanë lejuar trafikun e drogës së Habilajve në drejtim të Italisë. Më herët Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kërkuar nga parlamenti autorizim për heqjen e imunitetit të deputetit Saimir Tahiri, ish-ministër i Bren-dshëm, si dhe autorizimin për "arrestimin, heqjen e lirisë dhe kontrollin personal e të banesës". Ndaj tij u ngritën akuzat "Trafikim i lëndëve narkotike" e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal" dhe "Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë të shtetit", i dyshuar si i implikuar në trafikun e drogës me Habilajt. Më herët ish-ministri i Brendshëm u paraqit pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ku për 2 orë e 30 minuta qëndroi përballë prokurorëve Vladimir Mara dhe Dritan Prençi duke sqaruar pozicionin e tij në këtë çështje. I shoqëruar nga avokatët e tij, Maks Haxhia dhe Artan Hajdari, Tahiri dëshmoi për lidhjet e tij me grupin e trafikantëve të drogës, Habilajt. Ai i mohoi akuzat se ka ndihmuar grupin e Habilajve në trafikun e kanabisit dhe hodhi poshtë akuzën për korrupsion. Ish-ministri i Brendshëm përmendej në përgjimet e Habilajve, por Kuvendi nuk e dha autorizimin për arrestimin e tij, përveç kontrollit në banesë.

### 40-vjeçari mohon akuzat, kërkon ekstradim

## Financieri i "Habilajve", gjykata lë në burg Nazer Seitin

**TIRANE**- Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda rrëzoi dje kërkesën e Nezar Seitit për të fituar lirinë duke lënë në fuqi masën e dhënë ndaj tij një javë më parë. Seiti, i njohur si "financieri" i grupit kriminal "Habilaj", do të vazhdojë të qëndrojë në qeli. Ndaj Seitit rëndon edhe masa e sigurisë arrest me burg me nga 20 ditë afat, për qëllim ekstradimi, masë kjo e dhënë nga shkalla e parë e Dhomës Penale në Tiranë. Por me vendimin e sotëm të Apelit të Krimeve të Rënda, ai mbetet në Shqipëri deri në përfundim të hetimeve. Sipas hetimeve të prokurorisë së Katanias, Seiti është personi që shpërndante fitimet që vinin nga aktiviteti kriminal i anëtarëve të grupit "Habilaj". Fitime me të cilat përfitoheshin nëpërmjet trafikut të drogës nga Shqipëria drejt Italisë. Më herët Prokuroria e Krimeve të Rënda ka marrë në pyetje të dyshuarin si bashkëpunëtorin e ngushtë të Moisi Habilajt, Nezar Seitin. Marrja në pyetje ka ardhur pasi Krimet e Rënda kanë siguruar dosjen e Nezar Seitit, të ardhur nga prokuroria e Katanias. Krimet e Rënda e kanë pyetur Nezarin për përgjimet dhe rolin e tij në trafikun ndërkombëtar të drogës. Seiti ka pranuar para prokurorëve të Krimeve të Rënda se ka lidhje krushqie me Habilajt, pasi gruaja e tij i ka kushërinj. Gjithashtu, ai ka thënë se ka udhëtuar shpesh drejt Italisë në kërkim të punëve të ndryshme, dhe se kthehej shpesh në Shqipëri për të parë prindërit e moshuar, që banojnë në Vlorë. Lidhur me trafikun e drogës, dhe rolin e tij si bashkëpunëtor i Moisi Habilajt, Nezar Seiti ka mohuar akuzën duke preferuar të mos japë shpjegime. Ai ka kërkuar që të gjykohet në shtetin fqinj, ku janë ngritur akuzat e para, duke i thënë "po" ekstradimit.



I arrestuari Nazer Seiti

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

Ne date 04.12.2017 ne oren 16.00 ne zyren e permbaruesit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Apartament" me sip.68 $m^2$, me nr.pasurie 2/166+1-5, ne zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur ne Lagjia 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5, Ure Vajgurore Berat.Cmimi ne ankand te trete eshte ne vleren 1,411,200 (nje milion e katerqind e njembedhjete mije e dyqind) lekë.

# BUXHETI 2018
## DEBATI

Përplasja, PS miraton e vetme projektbuxhetin, 30 mln lekë shtesë Presidencës

# Debatet, Halimi: Xhiroja vjetore e drogës, 5 mld. Fino: S'do merrni pagën

## Naço: Pensionistëve do u jepni kaposhin për Vitin e Ri?



Gjatë një seance parlamentare

Valentina Madani

Mazhoranaca dhe opozita u përplasën sërish dje për situatën e kriminalitet në vend, ndërkohë që diskutohej nen për nen projektbuxheti 2018. Mes deputetëve nuk munguan akuzat për drogën, por edhe ironitë për ndarjen e buxhetit të vitit të ardhshëm. Komisioni i Ligjeve miratoi nen për nen projektbuxhetin e vitit 2018 vetëm me votat e mazhorancës, por mbledhja është shoqëruar me debate të forta mes anëtarëve, teksa është diskutuar miratimi nen për nen i projektbuxhetit të vitit 2018. Kreu i komisionit, Ulsi Manja, është përplasur me deputeti i PD-së, Eduard Halimi, ku ka ndërhyrë dhe socialisti Bashkim Fino. Ky i fundit bëri edhe një përmbledhje të mënyrës si do ndahet buxheti i 2018, ku 30 milionë lekë shtesë i shkojnë Presidencës, ndërsa Prokuro-risë nuk i jepen punonjës shtesë. Mbledhja e Komisionit të Ligjeve është shoqëruar nga debatet dje, ndërsa po diskutohej buxheti. "30 milionë lekë shtesë Presidencës. Prokurorisë nuk i japim punonjës shtesë. I kanë aty, nëse ju duhen nga reforma në drejtësi. Dy milionë lekë shtesë për Avokatin e Popullit. Gjykata Kushtetuese, 8 punonjës dhe 11 milionë lekë shtesë. ILDKPI-së i japim 4 milionë lekë. Hapjes së dosjeve i japim 30 milionë lekë për godinën. Shkolla e Magjistraturës, 4 punonjës shtesë dhe 24 mln lekë", deklaroi z.Fino. Me gjithë përpjekjen e deputetëve të mazhorancës për ta mbajtur diskutimit tek shifrat, deputetët e opozitës sërish kanë hedhur akuza për çështjen e drogës. Deputeti i PD-së, Eduard Halimi deklaroi se xhiroja vjetore e drogës është 5 mld euro, 1 mld më shumë se buxheti i shtetit, çka sipas tij do të thotë se mafia në Shqipëri e ka mundur shtetin. "Xhiroja vjetore e drogës është 5 mld euro. Buxheti i shtetit, 4 mld euro. Komisioni i pavarur i kualifikimit, 15 mln lekë shtesë. E thotë reportazhi i 'BBC'. Mafia në Shqipëri e ka mundur shtetin. Ka buxhet më të madh se shteti", u kundërpërgjigj deputeti Halimi. Por, deputeti i LSI-së, Nasip Naço ironizoi duke thënë: "125 mln lekë për indeksimin e pensioneve. Janë rritur pensionet, apo po u jepni një kaposh për vitin e ri?". Fino iu drejtua më pas deputetëve të opozitës duke thënë: "Ne duhet të bëjmë punë në këtë komision. Sillni amendamente nëse doni, jo të hapni kasetat". Por, ndërsa mazhoranca propozoi 30 mln lekë shtesë për Presidentin, opozita nuk votoi. Sipas nenit 12, paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj dhe rritet gjatë vitit, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Teksa opozita po largohej nga mbledhja e komisionit, socialisti Fino u shpreh: "Votuat kundër pagës së presidentit dhe pagave tuaja. Do i kërkoj Gramoz Ruçit të mos u japë pagën".



Komisioni i Ligjeve gjatë mbledhjes së djeshme

**VOTIMI**
Komisioni i Ligjeve miratoi nen për nen projektbuxhetin e vitit 2018 vetëm me votat e mazhorancës, por mbledhja është shoqëruar me debate të forta mes anëtarëve, teksa është diskutuar miratimi nen për nen i projektbuxhetit të vitit 2018.

### DEKLARATAT

**AKUZA**
Deputeti socialist, Ervin Bushati sulmoi dje PD, teksa ka deklaruar se po dëmton shëndetin. Bushati u shpreh se PD politizon procesin e kontrollit bazë të shëndetit (check-up), duke shtuar se 27% e qytetarëve që nuk marrin pjesë sot në këtë skemë të parandalimit të sëmundjeve është ekzaktësisht sa përqindja e votuesve të PD.



**REAGIM**
OPDAT dhe EURALIUS deklaruan përmes opinioneve të tyre se, "Nuk ka organ në vend që mund të zgjasë mandatin e kryeprokurorit". Pas shprehjes së tyre kundër zgjatjes së mandatit të Llallës, reagoi ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani. Ai e cilësoi absurd këtë, duke thënë se dy misionet bënë atë që do të donte Rama.





## Donald Lu: SHBA, mbështetje Shqipërisë në luftën ndaj krimit

Në aktivitetin e organizuar nga Presidenca, në kuadër të "Javës së Fëmijëve Jetimë", ambasadori i SHBA-ve në Tiranë, Donald Lu dje shprehu mbështetjen për institucionet shqiptare në luftën kundër krimit të organizuar. "100 vite më parë, Amerika erdhi këtu për të ndihmuar në ngritjen e strehës së fëmijëve. Edhe sot SHBA mbështet shpresat e Shqipërisë përmes fuqizimit të Forcave të Armatosura, luftës kundër krimit dhe zhvillimit të institucioneve demokratike, përfshirë edhe ato që janë bërë më të forta nga reforma në drejtësi", deklaroi ambasadori Lu. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian janë angazhuar fuqishëm në Shqipëri për zbatimin e reformës në drejtësi, e cila pritet që të largojë të korruptuarit për të hapur rrugën e negociatave. Në Shqipëri prej disa ditësh ndodhen ekspertë nga FBI, por edhe vende të tjera të BE për të asistuar institucionet shqiptare.

**AMBASADORI**
Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian janë angazhuar fuqishëm në Shqipëri për zbatimin e reformës në drejtësi

### DEBATET E DJESHME NË KOMISIONIN E LIGJEVE

**BASHKIM FINO:** 30 milionë lekë shtesë Presidencës. Prokurorisë nuk i japim punonjës shtesë. I kanë aty, nëse u duhen, nga reforma në drejtësi. Dy milionë lekë shtesë për Avokatin e Popullit. Gjykata Kushtetuese, 8 punonjës dhe 11 mln lekë shtesë. ILDKP-së i japim 4 mln lekë. Hapjes së dosjeve i japim 30 mln lekë për godinën. Shkollës së Magjistraturës, 4 punonjës shtesë dhe 24 mln lekë.

**EDUARD HALIMI:** Xhiroja vjetore e drogës në vit, 5 miliardë euro. Buxheti i shtetit, 4 miliardë euro. E thotë edhe reportazhi i 'BBC', mafia në Shqipëri e ka mundur shtetin. Ka buxhet më të madh se shteti.

**ULSI MANJA:** Po, e tha 'BBC' dhe ti, është e vërtetë. Të bëhemi seriozë. Nuk ka lidhje kjo me buxhetin.

**EDUARD HALIMI:** 90 tendera me 20 mln euro ka marrë në një vit një kompani në Elbasan. A ka lidhje kjo me trafikun e drogës?

**BASHKIM FINO:** Ne duhet të bëjmë punë në këtë komision. Sillni amendamente nëse doni, jo të hapni kasetat.

**ULSI MANJA:** Ke të drejtë, por nuk ia prish dot z. Halimi, se e kam nënkryetar.

**NASIP NAÇO:** 125 mln lekë për indeksimin e pensioneve. Janë rritur pensionet, apo po u jepni një kaposh për vitin e ri? Kryetar, mos bini nën presionin e z. Fino! Na lër të diskutojmë nen për nen. Të bëjmë pyetjet e të sqarohemi.

Deputetët e PD nuk votojnë.

**BASHKIM FINO:** Votuat kundër pagës së presidentit dhe pagave tuaja, do i kërkoj Gramoz Ruçit të mos u japë pagën.



Presidenti, letër ligjvënësve për të zgjidhur ngërçin e krijuar

# Zgjedhja e anëtarëve të KED, Kuvendi hedh shortin më 7 dhjetor

Kuvendi lajmëroi dje, hapjen e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit për Emërimet në Drejtësi. Ky këshill e mbaroi mandatin kushtetues 1 vjeçar pa kryer asnjë punë. Më 7 dhjetor, ora 10:00, Kuvendi, në selinë e tij, do të hedhë shortin për të zgjedhur 9 anëtarët e rinj të Këshillit për Emërimet në Drejtësi që do e mbajnë këtë detyrë deri në 1 janarin e vitit 2019. Sipas Kushtetutës dhe ligjit, ky këshill përbëhet nga dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit, si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative si dhe anëtarët zëvendësues. Presidenti i Republikës i kërkoi Kuvendit të ndërhyjë për të zgjidhur ngërçin e krijuar me shortin për KED-në. Në kushtet kur nuk janë ngritur ende KLGJ dhe KLP, Meta shpjegon se e ka të pamundur që të marrë kandidaturat e nevojshme për t'i hedhur në short brenda datës 5 dhjetor, që parashikon ligji. Në këto kushte, Kuvendi ka vendosur ta zgjidhë vetë problemin, duke njoftuar hedhjen e shortit më datë 7 dhjetor. Vonesat në ngritjen e Këshillit të Lartë të Gjyqësorit dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë po pengojnë të gjithë zinxhirin e institucioneve të reja të reformës në drejtësi. Një prej tyre është pikërisht KED, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të cilin Presidenti i Republikës duhej të hidhte në short kandidatët e përcjellë nga KLGJ dhe KLP. Shorti do të drejtohet nga kryetari i Kuvendit me pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit, përfaqësuesve të gjykatave dhe prokurorisë, përfaqësues të grupeve parlamentare, diplomatëve dhe medias. Këshilli për Emërimet në Drejtësi është një organ i rëndësishëm në zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.



## Xhaçka në Kabul: Në 2018 do të rrisim me 60 për qind praninë në Afganistan

Vitin e ardhshëm Shqipëria do të rrisë me 60% të trupave prezencën e saj në Afganistan. Rritja e numrit të efektivëve, mes të cilëve edhe një kontingjent i Forcave Speciale, u konfirmua gjatë vizitës 24 orësh të ministres së Mbrojtjes, Olta Xhaçka në Kabul, Afganistan. Ministrja është pritur në një takim të veçantë nga Komandanti i Misionit të NATO-s Resolute Support, gjenerali John Nicholson. Ky i fundit ka vlerësuar kontributin e trupave shqiptare që prej vitit 2002 në Afganistan. Ministrja Xhaçka tha gjatë takimit se angazhimet në operacione ndër vite kanë sjellë më shumë përgjegjësi dhe detyrime. "Vendimi për zgjerimin e trupave në Kabul dhe Herat është përgjigjja jonë në emër të partneritetit strategjik me SHBA, ashtu sikundër kemi mbështetur strategjinë e qeverisë amerikane në Azinë Juglindore",- tha ministrja Xhaçka. Gjatë orëve të qëndrimit në Kabul, ministrja e Mbrojtjes është takuar me efektivët shqiptarë në komandën qendrore të NATO-s dhe në aeroportin ndërkombëtar "Hamid Karzai", ku kryen misionin kontingjenti i 6-të.

## Vendimi, marrëveshje Shqipëri-Kosovë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian

Qeveria ka miratuar në mbledhjen e djeshme, në parim, marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ky vendim është marrë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ndërkohë dje, zv. kryeministrja Senida Mesi ishte për një vizitë në Kosovë, ku u takua edhe me homologun Enver Hoxhaj dhe ministrin e Tregtisë & Industrisë Bajram Hasani. Gjatë takimit me Hoxhajn, Mesi ka nënvizuar bashkëpunimin e ngushtë politik që ekziston mes dy vendeve, si edhe ndërveprimin vëllazëror që karakterizon Shqipërinë dhe Kosovën. Në këtë kuadër, ato kanë rënë dakord që ta përforcojnë edhe më tepër bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe kanë insistuar për rritjen e mëtejshme të komunikimit në çdo fushë të interesit të përbashkët.

Marrëveshja fillestare u nënshkrua në Tiranë në mars të 2015

# Radarët, qeveria miraton kontratën me SHBA-në për vëzhgimin ajror

## *Dy muaj më parë, u zbulua mosfunksionimi i radarëve në det*

Qeveria miratoi dje, në mbledhjen e saj të përjavshme, miratimin e kontratës, për blerjen e pajisjeve për radarët, por për vëzhgimin hapësinor. Në vendimin e qeverisë, firmosur nga kryeministri Edi Rama, është miratuar lidhja e kontratës ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Lockheed Martin Global, Incorporated, SHBA, për blerjen e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës ajrore - Faza I. Marrëveshja fillestare me kompaninë amerikane është nënshkruar në Tiranë më 15 mars të vitit 2005. Ky vendim i qeverisë vjen disa javë pas debatit që u hap për mosfunksionimin e radarëve në det, gjë që solli edhe një tjetër debat më të rëndë se përmes kësaj taktike lejohej narkotrafiku. Në media u publikua në muajin shtator raporti konfidencial që qendra ndërinstitucionale operacionale detare i dërgonte ish-ministres së Mbrojtjes Mimi Kodheli 24 orë pas publikimit të lajmit. Në raportin sekret të Qendrës shkruhej se performanca e radarëve ka pësuar rënie, ndaj zbulimi i mjeteve lundruese nën shtatë metra bëhet i vështirë dhe në kushtet e motit të keq, radarët nuk filmojnë asgjë. Përpos të tjerave, Qendra pranon se për më shumë se një vit radari në Ksamil ka qenë jashtë gatishmërie, duke konfirmuar shqetësimet e ngritura nga Haki Çako dhe ish-ministri Dritan Demiraj në letrat e tyre. "Aktualisht përveç Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare janë në funksion edhe dy radarë të administruar nga Policia Kufitare dhe Migracionit; njëri në Hoxharë dhe tjetri në Ksamil. Këto radarë nuk janë të integruar, pasi i përkasin një gjenerate më të vjetër. Si rezultat Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) nuk merr pamje nga këto radarë, por vetëm nga njësitë e Policisë Kufitare dhe Migracionit, që shërbejnë atje. Radari i Ksamilit ka qenë jashtë gatishmërisë nga data 18 prill 2016 deri më datë 24 maj 2017",-thuhej në këtë raport. Por më pas veç sqarimit të dhënë nga ish-ministrja Mimi Kodheli, edhe ministrja aktuale Olta Xhaçka bëri me dije se, "Sistemi i integruar i monitorimit të hapësirës detare është plotësisht funksional dhe plotësisht operacional. Njerëzit që menaxhojnë sistemin, veçanërisht ata që janë nën uniformë, janë 24 orë në ditë në 7 ditët e javës. Qendra operacionale është një qendër që ka përfaqësues nga shtatë institucione dhe janë një për shtatë dhe shtatë për një. Xhaçka ka kërkuar që të mos hidhet baltë mbi punën e njerëzve me uniformë dhe për këdo që ka informacione komprometuese, ministrja kishte një propozim. "Nëse i shpëton gjë njërit, nuk u shpëton gjashtë të tjerëve. Nëse u ka shpëtuar të shtatëve, jemi të interesuarit kryesorë që kushdo që ka një informacion konkret se puna nuk ka shkuar siç duhet, ta denoncojë tek institucionet përkatëse dhe natyrisht që edhe ne jemi të interesuar që kjo të ndodhë",-u shpreh Xhaçka. Denoncime të njëpasnjëshme ka bërë gjatë këtij debati LSI, përmes nënkryetarit Luan Rama, i cili ka akuzuar qeverinë për mosfunksionimin e radarëve.



Foto ilustruese

KONVENTA
AKUZAT

Thirrja e kryetares e LSI-së: Të ngrihemi së bashku e të rrëzojmë qeverinë!

# Kryemadhi, akuza Ramës: Me paratë e krimit po blen ndërkombëtarët

## "Revoltë, Shqipëria po shpërbëhet"

Valentina Madani

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, bëri dje përgjegjës kryeministrin Rama për situatën e rëndë të kriminalitetit në vend. Nga Konventa Kombëtare e Lëvizjes së Gruas për Integrim, Kryemadhi akuzoi kreun e qeverisë se me politikat e tij po varfëron shqiptarët dhe po kërrus Shqipërinë. Monika Kryemadhi adresoi akuza ndaj qeverisë për presion dhe kërcënime ndaj grave dhe vajzave të kësaj partie, që kanë qenë pjesë e administratës shtetërore. Sipas saj, vendi është kapur nga krimi dhe se gratë duhet të bëhen bashkë për të dhënë një model për të ardhmen. Kryemadhi theksoi se gratë e LSI, PS, PD dhe shoqërisë civile janë njëlloj me pedagoget, të papunat dhe fermeret dhe se duhet të bashkohen pa dallime partiake për të larguar Ramën. "Misioni im është t'ju udhëheq juve së bashku me Klajdën, Irisin etj. Ky mision bëhet i mundur me bashkëpunimin e të gjithëve. Ta shpëtojmë rininë tonë, e cila po ikën çdo ditë e më shumë. Ta shpëtojmë edhe kryeministrin e rënë. Me paratë e tyre blejnë institucione dhe vota, blejnë ndërkombëtarët, por harron se Edi Rama është pronë e drogës, krimit, makthit të tij. Ky njeri nuk mund t'i zhdukë fobitë e tij për të larguar shqiptarët. Ky njeri nuk mund t'i shpërndajë shqiptarët", u shpreh Kryemadhi. Duke folur në Konventën Kombëtare "Lëvizja e Gruas për Integrim", Kryemadhi tha se Shqipëria ndodhet në udhëkryq midis të ardhmes dhe shpërbërjes së saj. "Ata po varfërohen çdo ditë e më shumë, mundësitë dhe shanset për të qenë europianë çdo ditë dhe më shumë po bëhen më të pamundura. Sot më shumë se kurrë ne jemi në një udhëkryq midis së ardhmes dhe shpërbërjes së Shqipërisë. Shqipëria, kjo zonjë e randë, siç i këndonin më përpara rilindësit, po kërruset, po mblidhet nga hallet, vuajtjet të cilat po e drobisin çdo ditë e më shumë. Shqipëria kjo zonjë e randë të cilën nuk e lodhën pushtimet, luftërat dhe regjimet diktatoriale, po e kërrus një grusht njerëzish, të cilët po e kriminalizojnë dhe më e dhimbshmja po e shkatërrojnë të ardhmen, shpresën, dritën e syrit të këtij vendi, që është rinia shqiptare. I them këto fjalë pasi ndjej dhimbje, revoltë dhe përgjegjësi. Ndjej dhimbje se jam shqiptare, besoj në Zot dhe flamur. Revoltë, sepse jam nënë dhe dua që fëmijët e mi ta duan Shqipërinë dhe jo ta shikojnë si një vend i huaj për ta. Ndjej përgjegjësi për këtë situatë politike, sepse kjo klasë politike është e saj ndaj kapjes së shtetit nga ky grup njerëzish. Sot dua të flas si nënë, por dua të flas edhe për herë të parë para jush si kryetare e LSI", theksoi Kryemadhi. Ajo akuzoi kryeministrin se është kthyer në një telekomandë të krimit dhe po zbaton me përpiktmëri planin e tij monstruoz, shpërbërjen e Shqipërisë. "Poezia e Pashko Vasos 'O moj Shqipni e mjera Shqipni' është sot më shumë se kurrë reale për ne. Kryeministri ynë po i bën Shqipërisë atë që nuk i bënë dot në shekuj armiqtë e saj. Ai po e varfëron çdo ditë, ai po e shkatërron çdo ditë e më shumë. Pasi është kthyer në një telekomandë të krimit, ai po e zbaton me përpiktmëri planin e tij monstruoz, shpërbërjen e Shqipërisë. Ai po varfëron 99% të shqiptarëve duke u rritur taksat dhe po pasuron akoma më shumë pasanikët e tij, që janë vetëm 1% e tyre", u shpreh kryetarja e LSI-së.



Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi

**AKUZA**

"Me paratë e tyre blejnë institucione dhe vota, blejnë ndërkombëtarët, por harron se Edi Rama është pronë e drogës, krimit, makthit të tij. Ky njeri nuk mund t'i zhdukë fobitë e tij për të larguar shqiptarët. Ky njeri nuk mund t'i shpërndajë shqiptarët", - u shpreh Kryemadhi.

### Krijohet Komiteti për Diasporën, pjesë kryeministri e 8 ministra

Qeveria miratoi dje ngritjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën, ku do të jetë e angazhuar thuajse e gjithë qeveria. Sipas vendimit të qeverisë, në përbërje të këtij komiteti do jetë kryeministri si dhe tetë ministra. Komiteti do kryesohet nga kryeministri, ndërsa anëtarët e tjerë do jenë ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministri i Brendshëm, ministri i Financave dhe Ekonomisë, ministri i Drejtësisë, ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministri i Kulturës, ministri i Mjedisit dhe Turizmit si dhe ministri i Shtetit për Diasporën. Në përbërje të Komitetit do jenë edhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, kryetari i Akademisë së Shkencave si dhe drejtori i INSTAT-it. Komiteti Shtetëror për Diasporën do shërbejë si organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave e të veprimtarive shtetërore në fushën e diasporës.

### Alibeaj zbardh dokumentet që implikojnë ish-ministrin

## PD: 863 mijë eurot e Sotës jo për "Kurumin", por të Tahirit

Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj, hodhi poshtë dje me fakte pretendimin se Saimir Tahiri udhëtoi pak ditë më pare drejt Gjermanisë për të parë babanë e tij. Nga selia e PD-së, Alibeaj nxori një dokument që sipas tij vërteton se biznesmeni nga Elbasani, Orest Sota nuk kishte mundësi të bënte biznes me "Kurumin". Sipas tij, 863 mijë eurot e gjetura në makinë Sotës bashkë me patentat vërtetojnë edhe njëherë akuzuat e ngritura nga opozita edhe më herët se paratë i takonin ish-ministrit Tahiri. Alibeaj deklaroi se disponon te një dokument gjykate që i përket qershorit 2016, sipas të cilit Jusuf Kurum e kishte të ndaluar transaksionin cash, ashtu edhe nëpërmjet bankës për shkak se kishte shpallur falimentin. "Sipas dokumentit të depozituar më 3 gusht 2017 në Qendrën Kombëtare të Biznesit, çdo transaksion mbi 20 milionë lekë i administratorit Jusuf Kurum do të ishte i pavlefshëm. Kjo do të thotë se Orest Sota e kishte të pamundur të bënte biznes me 'Kurum', me shifrën e 863 mijë eurove, pak më shumë se 1 milion dollar", deklaroi Alibeaj. Sipas tij, me mbështetje të kryeministrit Edi Rama, ish-ministri Tahiri po përpiqet të fshehë provat që e implikojnë në trafikun e drogës. Edhe vizita në Gjermani, tha deputeti demokrat, kishte këtë qëllim. "Versioni i hedhur prej Tahirit se po i qëndronte afër të atit për arsye shëndetësore nuk qëndron. Babai i Saimir Tahirit ka hyrë dhe ka dalë nga Shqipëria përpara largimit të Saimir Tahirit në Gjermani", u shpreh deputeti i PD-së.



Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj



### Denoncimi te Berisha: Tahiri takoi në Gjermani avokatin e Habilajve

Ish-kryeministri Sali Berisha deklaroi dje se Saimir Tahiri ka shkuar në Gjermani për të takuar avokatët e Habilajve. Ai postoi një mesazh të qytetarit dixhital dhe hedh dyshime për këtë gjë. "Një fakt shumë interesant dhuratë nga Noriega për popullin shqiptar. Sonte në mbrëmje udhëtova nga Rinasi drejt Milanos, Malpensa, bashkë me bashkëshorten time. Sapo zbritëm nga avioni na mori një autobus dhe zbritëm në një hyrje të pajisur me skaner dhe metal detector. Ushtruan kontroll personal për çdo pasagjer, njësoj sikur kontrollohemi në rastet para imbarkimit në avion. Duket se autoritetet italiane s'kanë më besim tek kontrollet shqiptare dhe tek 'pastërtia' e policisë sonë, sepse shembullin për ne e ka dhënë ish-ministri i dashur, Saje Qorri. Desha t'i bëj një pyetje edhe atij: Në Gjermani të kontrolluan në ndonjë dhomë të veçantë, apo i re nga Gjermania për të shku me taku avokatin e byrazerave?! Kot për muhabet po pyes... Flm Doktor e uroj ta bëni këtë denoncim, sepse vërtet na kanë vënë një njollë shumë të keqe ne si popull dhe shtetit tonë", thuhet në mesazhin drejtuar Berishës.

## Në arrati prej 5 muajsh, Hatiaj: Kam humbur besimin te drejtësia

# Çështja e Alket Hatiajt, prokurori Bashaj: Të zgjidhet ekstradimi

## "Kërkohet garanci nga Italia për rigjykimin e tij"

Klodiana Lala

**TIRANE**

Çështja e Alket Hatiajt, i cilësuar nga mediat italiane si zot i drogës, ka vënë në vështirësi drejtësinë shqiptare. Prokurori Kujtim Bashaj, i cili i është drejtuar Gjykatës së Durrësit me kërkesën për ekstradimin e të kërkuarit drejt Italisë, kërkon ndihmën e Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që t'i jepet zgjidhje çështjes. Në shkresën që mban firmën e tij, prokurori kërkon që autoriteteve italiane t'u vihen në dispozicion përmes letër porosisë, vendimet e dënimit të Alket Hatiajt nga drejtësia shqiptare, dhe të pyeten nëse i qëndrojnë sërish kërkesës për ekstradim. "Duke i vënë në dispozicion vendimin penal nr.190 të vitit 2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda si dhe atë të Apelit e Gjykatës së Lartë, për shqyrtimin e tij, t'iu kërkohet autoriteteve italiane nëse i qëndrojnë përsëri kërkesës për ekstradim. Kjo pasi në ligj sanksionohet se "nuk mund të jepet ekstradimi… kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri, edhe pse vepra penale është kryer jashtë shtetit", - thuhet në shkresë. Prokurori pranon më tej në letër se është e dukshme që Hatiaj, për periudhën kohore 2003-2004, që bën fjalë vendimi i gjykatës italiane për dënimin e tij me 20 vjet burgim, mbi të cilin është kërkuar ekstradimi, ai është gjykuar nga drejtësia shqiptare dhe e ka shlyer dënimin. "Të paktën në 15 episode bazuar në përgjime dhe akte procedurale të grumbulluara dhe të sjella në rrugë ligjore nga autoritetet e drejtësisë italiane në Shqipëri, rezulton që Hatiaj të jetë dënuar nga gjykata shqiptare, dënim i cili tashmë rezulton i vuajtur prej tij". Prokurori këmbëngul që shtetit fqinj, t'i kërkohet garanci për rigjykimin e Hatiajt, në rast ekstradimi. Për faktin se deri më tani garancia nuk ka mbërritur, gjykata e Durrësit firmosi për shtyrjen e seancës këtë të mërkurë. Alket Hatiaj, jeton në arrati prej 5 muajsh, dhe gjatë një interviste për "News 24" ai deklaroi se nuk do të dorëzohet pasi e ka humbur besimin te drejtësia. Ai është dënuar me 20 vite burgim nga Gjykata e Apelit në Milano, ndërkohë që këmbëngul se për të njëjtat vepra penale është dënuar në Shqipëri dhe i ka mbyllur hesapet me drejtësinë.


Alket Hatia


Gjykata e Durrësit

## Pika kontrolli të padukshme në zona me rrezikshmëri

# Radarët automatikë, Ervin Dervishi: Lotaria, 20 më të mirët fitojnë shpërblim nga policia




Policia Rrugore do të vendosë radarë të padukshëm anembanë vendit, për të gjobitur drejtuesit e mjeteve që tejkalojnë shpejtësinë. Nuk do të jetë më e nevojshme prania fizike e policit rrugor, pasi radarët janë automatikë dhe pasi pikasin shkelësit i fotografojnë ata dhe më pas në bazë të identifikimit fotografik të targave, atyre iu dërgohet gjoba në shtëpi, në adresat përkatëse. Në një deklaratë për mediat gjatë ditës së sotme, për të njoftuar mbi këtë nismë, drejtuesi i Policisë Rrugore, Ervin Dervishi njoftoi për nismën më të re që do të ndërmarrë policia për të disiplinuar dhe vlerësuar drejtuesit më korrektë të automjeteve. Nisma ka të bëjë me "lançimin e një lotarie për drejtuesit e mjeteve që respektojnë rregullat e qarkullimit rrugor. Do të përzgjedhim drejtuesin e mjetit model, që respekton rregullat e qarkullimit, duke ecur brenda kufijve të limiteve të shpejtësisë. Për drejtuesit që qarkullojnë brenda normave, do të përzgjidhen më korrektët dhe të premten do të zhvillojmë një shorte live në mjediset e policisë dhe bashkë me TAP dhe një kompani sigurimesh, do dhurohen 20 polica sigurimesh për një vit për ata që përzgjidhen," - tha Dervishi. "Do të ketë nisma të tjera, për vendosjen e rripit të sigurimit dhe të kaskave mbrojtëse. Radarët automatikë dhe pikat e kontrollit, do të jenë të padukshme dhe në akset kryesore, në zonat që ne i kemi konsideruar si me rrezikshmëri më të lartë për shkak të aksidenteve".

## SHKURT

### Hajdutja seriale, Gjykata e Tiranës burg për 41-vjeçaren

Gjykata e Tiranës ka dhënë dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për hajduten seriale Rozalina Konomi. Një ditë pasi u lirua për vjedhje, Konomi kreu serish të njëjtin krim. Ajo është arrestuar në datën 19 nëntor nga uniformat blu të Tiranës për veprën penale të vjedhjes. 41-vjeçaria ishte kthyer në tmerrin e qendrave tregtare në Tiranë. Viktimat e saja ishin gratë, ajo shfrytëzonte momente kur ato ishin të pakujdesshme dhe menjëherë Konomi ndërhynte, duke vjedhur çantat e dorës apo portofolat. Në 17 nëntor 2017 ajo ka dalë nga dalë nga burgu, Rozalina në 19 nëntor 2017 ka shkuar sërish në ambientet e qendrës tregtare dhe ka bërë goditjen e radhës.

### Grabitet lokali në Tiranë, i riu dhunon kamerierin dhe i merr lekët e xhiros

**TIRANE**- Një grabitje me dhunë ka ndodhur mëngjesin e djeshëm në kryeqytet. Një person ende i paidentifikuar, ka grabitur xhiron ditore të një lokali në sheshin "Wilson". I riu i veshur me një xhup të zi dhe një kapelë në kokë, sapo ka hyrë në lokal, ka goditur kamerierin dhe i ka marrë lekët e xhiros ditore. Sakaq ende nuk dihet shuma e parave që janë grabitur. Uniformat blu mbërritën menjëherë në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin e autorit dhe kapjen e tij.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: ***"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"***.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,046,800 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: ***"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"***

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 19 Dhjetor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: ***"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve UPS të dhomave të serverave të Bankës së Shqipërisë"***.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2,700,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: ***"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve UPS të dhomave të serverave të Bankës së Shqipërisë"***

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 18 Dhjetor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Miratohet dëmshpërblimi për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist

# Ish-të përndjekurit, qeveria: Ja si ndahen 350 milionë lekë

## VKM-ja, të parët përfitojnë ish-të dënuarit, më pas trashëgimtarët

Ornela Manjani



Foto ilustruese

Qeveria miraton dëmshpërblimin për ish-të dënuarit politikë. Fondi prej 352 milionë lekësh, i caktuar si shtesë për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë do të shpërndahet brenda këtij viti. Pjesa më e madhe e fondit do të shkojë me qëllim akomodimin e shlyerjes 100% të këstit të tetë dhe të fundit të kategorisë parësore të përfituesve të gjallë dhe pjesën që mbetet do ta marrin trashëgimtarët. Vendimi është miratuar dje në Mbledhjen e Qeverisë, ndërsa shtesa e fondit dhe radha e pagesës në ndryshimet e buxhetit të vitit 2017, pak ditë më parë.

**VENDIMI**

Qeveria vendosi dje miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë. Masa e dëmshpërblimit të bëhet me këste, sipas kritereve dhe kufijve të përcaktuar në nenin 12, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar. Neni 12 përcakton: "Në bazë të buxhetit vjetor, të vënë në dispozicion dhe sipas radhës së caktimit të dëmshpërblimit, fondet do të ndahen në mënyrë proporcionale për të gjithë ish-të dënuarit dhe familjarët e viktimave të pushkatuara, me kusht që vlera e dëmshpërblimit gjatë fazës së parë të mos jetë më shumë se 1 milion lekë. I njëjti mekanizëm do të përsëritet një ose më shumë herë, deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit për të gjithë ish- të dënuarit/familjarët e viktimave, me kusht që në çdo rast, pjesa takuese që kompensohet të mos jetë më e vogël se 100 mijë lekë. Asnjë ish-i dënuar apo familjar i tij nuk mund të dëmshpërblehet jashtë këtij mekanizmi". Në pikën tre të vendimit thuhet se shuma e llogaritur do të transferohet në një llogari speciale në Bankën e Shqipërisë. Pagesa e dëmshpërblimit për secilin përfitues behet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në llogaritë personale të tyre të hapura në bankat e nivelit të dytë, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9831, datë 12.11.2017, të ndryshuar. Këshilli i Ministrave ka ngarkuar Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

**LIGJI**

Sipas ligjit në fuqi Këshilli i Ministrave është autoriteti përgjegjës që miraton dëmshpërblimin financiar, në përputhje me këtë ligj, i cili me vendim përcakton gjeneralitetet përkatëse të ish-të dënuarit politik, llojin e dënimit, periudhën e plotë të vuajtjes së dënimit gjithsej në vite, muaj dhe ditë sipas rastit, shumën e dëmshpërblimit financiar dhe sipas rastit, gjeneralitetet e sakta të familjarëve të viktimave të pushkatuara si dhe masën përkatëse të dëmshpërblimit të tyre.

### DËMSHPËRBLIMI PËR TË BURGOSURIT E TË DËBUARIT POLITIKË

**Masa e dëmshpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit politikë do të jetë si më poshtë:**

**a)** Çdo i dënuar politik, për çdo ditë vuajtjeje dënimi të kryer në burg, spital psikiatrik, spital burgu, izolim në hetuesi nga data 30.11.1944 deri më 1.10.1991 dëmshpërblehet financiarisht sipas kritereve të këtij ligji, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në ditë.

**b)** Për personat që kanë vuajtur internim në kamp me rrethim me tela me gjemba deri në vitin 1954, masa e dëmshpërblimit është 1 000 (një mijë) lekë në ditë.

**c)** Për personat e tjerë të internuar ose të dëbuar parashikohet një skemë pensioni, e cila do të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Dëmshpërblimi i përcaktuar në paragrafin më sipër u takon edhe familjarëve të tij, në pjesë të barabarta takuese, kur i dënuari nuk jeton më. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake. Nga shuma që çdo i dënuar politik përfiton nga ky ligj, zbritet masa e dëmshpërblimit që ai ka përfituar me ligjet e mëparshme.

### LIGJI



### Masa e dëmshpërblimit për familjarët e të dënuarve me dënim kapital

Familjarët e viktimave të pushkatuara apo të ekzekutuara me dënim politik të padrejtë për vuajtjen dhe persekutimin përfitojnë një dëmshpërblim financiar të barabartë gjithsej në masën e 8 viteve kompensim dënimi me burgim. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake.



### Lame caktohet anëtar i Bordit të Hipotekave

## Vendimi miratohet nga Këshilli i Ministrave

Artan Lame, kreu i Agjencisë së Legalizimit do të jetë anëtar i Bordit Drejtues të Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Vendimi është miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe përcakton se Lame do të jetë përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë në këtë bord. Bordi drejtues i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme kryesohet nga një përfaqësues i kryeministrit dhe ka në përbërje përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave. Më herët, kryeministri Edi Rama ka paralajmëruar krijimin e një strukture unike për pronën përmes bashkimit në një institucion të vetëm të Agjencisë së Legalizimeve, Hipotekave dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronës.

### Vendimi, lojërat 'online', aplikimi tek Autoriteti i Mbikëqyrjes

## Lojërat elektronike në distancë, kapitali themeltar 10 mln dollarë

Qeveria miraton vendimin për funksionimin e lojërave elektronike në distancë. Në vendimin e saj të fundit qeveria qartëson kushtet që duhet të plotësojë një subjekt që operon në këtë kategori dhe një prej tyre ka të bëjë me kapitalin, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se 1.2 miliardë lekë apo pak më shumë se 10 milionë dollarë. Vendim përcakton kushtet dhe kërkesat teknike që duhet të plotësojë subjekti që aplikon për t'u licencuar për kategorinë "Lojëra elektronike në distancë". "Lojëra elektronike në distancë", për qëllime të këtij vendimi, janë lojërat e fatit 'online', ku lojtarët marrin pjesë nëpërmjet përdorimit të komunikimit në distancë, internetit, telefonit, por pa u kufizuar vetëm në to. Lojërat luhen në faqet zyrtare të internetit (web) të subjekteve të licencuara për kategorinë "Lojëra elektronike në distancë". Aplikimi kryhet me dorëzimin e kërkesës për pajisje me licencë pranë Autoritetit, së cilës i bashkëngjiten dokumentet shoqëruese, sipas parashikimeve të këtij vendimi. Dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dhe të jenë të hartuara sipas formaliteteve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës në fuqi. Dokumentet shoqëruese, ku përfshihet edhe e gjithë korrespondenca dhe dokumentet për këtë aplikim duhet të jenë në gjuhën shqipe. Aplikanti mund të depozitojë edhe dokumente në gjuhë të huaj, të shoqëruara me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe. Aktet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Aplikuesi do të përballojë të gjitha kostot në lidhje me përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit, duke përfshirë ndër të tjera, të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me përgatitjen e përgjigjeve të pyetjeve apo kërkesave për sqarime a takime të Autoritetit.



## FMN "zbarkon" te Tatimet

# Për dy javë, asistencë për strukturën e borxhin tatimor



Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar do të qëndrojë dy javë në Shqipëri ku do të asistojë administratën tatimore. Referuar njoftimit zyrtar, misioni i FMN-së i kryesuar nga Allan Jensen si dhe përfaqësues të tjerë të lartë, do të ofrojnë asistencë teknike me synim lehtësimin e përpjekjeve për të forcuar më tej administratën tatimore. Gjatë qëndrimit të misionit të FMN në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve do të trajtohen çështje që lidhen me strukturën organizative, konsolidimin e kapaciteteve në komponentët kryesore të administratës, fokusimi te borxhi tatimor dhe risku, si dhe vlerësimi i situatës së përgjithshme të zbatimit të reformave. Gjatë ditës së sotme, anëtarët e misionit të FMN-së janë pritur nga drejtoresha e Përgjithshme e Tatimeve Vasilika Vjero.

## Reagon Konfindustria

# Ulja e kufirit të TVSH-së, rrezikon 6 mijë biznese



Konfindustria vlerëson se të paktën 6 mijë biznese të vogla me qarkullim vjetor 2-5 milion lekë, rrezikojnë mbylljen, nëse do të përfshihen në TVSH, sipas skemës së ekzekutivit në Paketën Fiskale 2018. Përmes një njoftimi për shtyp, Konfindustria bën me dije se ka dërguar kërkesë zyrtare Kuvendit të Shqipërisë, që të shtyhet me të paktën një vit skema e përfshirjes së biznesit të vogël në këtë skemë. "Koha e mësipërme kërkohet me qellim përgatitjen e paketës shoqëruese ligjore dhe biznezit, të domosdoshme për mënjanimin e pasojave negative të përfshirjes në skemën e TVSH sipas projektligjit në diskutim." Kërkesa e drejtuar Kuvendit, bën më dije Konfindustria, bën pjesë në grupin prej 14 kërkesash, që Konfindustria ka paraqitur për Paketën Fiskale 2018.

### Procedura për plotësimin e akteve për marrjen e tokave në pronësi

# Tapitë për tokën bujqësore me ligjin 7501, afati i ri

## *Ndryshimet hyjnë në fuqi në dhjetor*

Ornela Manjani

Afati për plotësimin e akteve për marrjen në pronësitë tokave bujqësore, të shpërndara me ligjin 7501 do të përfundojë më datë 31 dhjetor 2018. Shtyrja e afatit është vendosur me ndryshimin e ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i cili është botuar në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në fillim të muajit dhjetor. "Në nenin 17, pika 1/1, shkronja "e", fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë: "Afati i plotësimit të AMTP-ve përfundon në datën 31 dhjetor 2018. Ndërkohë neni 18 ndryshohet si më poshtë: "Neni 18, Verifikimi i titujve të pronësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, përfundon më 31 dhjetor 2018.",-thuhet në ndryshimet e bëra në ligj. Shtyrja e afatit të procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve deri më 31 dhjetor 2018 ka për qëllim përfundimin e procedurave ligjore të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore përfituesve sipas ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", të ndryshuar", të cilët nuk kanë bërë kalimin në pronësi, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

**DOKUMENTET**

Procesi i plotësimit të dokumentacionit të pronësisë mbi tokën bujqësore kryhet nga bashkitë. Për rastet kur komisioni i ndarjes së tokës, ka ndarë tokën bujqësore, por nuk ka plotësuar aktet e marrjes së tokës në pronësi, ligji ngarkon kryetarët e Bashkive, t'i plotësojnë ato, në përputhje me kriteret dhe procedurën e përcaktuar, ndërsa prefekti i qarkut mbikëqyr realizimin e këtij procesi. Nga informacioni i mbledhur nga prefektët e qarqeve dhe bashkitë deri më datë 10 tetor 2017 rezulton se janë paraqitur 2300 kërkesa nga familjet bujqësore. Relacion për projektligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar". Shumë bashki kanë proceduar me kërkesat e paraqitura, por nuk kanë finalizuar procesin deri në plotësimin e titujve të pronësisë, për shkak të disa problematikave të hasura. Referuar nenit 2, pika 2, paragrafi "v", Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), nuk mund të plotësohen për sipërfaqet e tokave bujqësore që janë "objekt kërkese, e cila po shqyrtohet nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, por nuk është dhënë ende vendim". Përcaktimi i këtyre sipërfaqeve të tokave bujqësore është detyrim i Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP). Gjatë procesit të zbatimit të ligjit, bashkitë i janë drejtuar zyrtarisht kësaj agjencie për të marrë informacionin respektiv. Ndërsa ATP, në përgjigjet zyrtare të saj konfirmon se është në kushtet e pamundësisë të japë një përgjigje përfundimtare dhe të saktë, sepse kërkesat e depozituara për njohje pronësie nuk janë të plotësuara me dokumentacionin hartografik sipas kërkesave ligjore, apo ekzistojnë mospërputhje ndërmjet dokumentacionit ligjor dhe atij hartografik të paraqitur. Mungesa e këtij informacioni zyrtar nga ATP, e ka bllokuar vijimin dhe përfundimin e procesit nga bashkitë. Në këto kushte, në projektligjin e propozuar, parashikohet që kalimi i tokës bujqësore në pronësi të përfituesve (familjeve bujqësore) të mos kushtëzohet me konfirmimin e faktit nëse kjo sipërfaqe toke është ose jo objekt kërkese që shqyrtohet nga ATP. Një ndryshim i tillë nuk cenon të drejtën e subjekteve pretendues, që pas vendimit të ATP për njohjen e kësaj prone, të kompensohen sipas ligjit. Në këto kushte, me qëllim që procesi i nisur nga bashkitë të konkretizohet me plotësimin e AMTP-ve, propozohet që afati i përfundimit të këtij procesi të jetë data 31 korrik 2018. Ky afat është i mjaftueshëm për realizimin e gjithë procedurave të nevojshme që përcakton ligji, thuhet në një relacion të qeverisë. Nëse ky afat nuk do të shtyhet, pra procesi nuk përfundon në rrugë administrative, përfituesit megjithëse kanë të drejtë t'i drejtohen organeve gjyqësore (kjo e drejtë është e parashikuar në ligj), procesi do të shtyhet edhe më tepër në kohë dhe do të shoqërohet edhe me kosto më të mëdha për përfituesit.



Foto ilustruese

## Raporti i tranzicionit i BERZH

# "Shqipëria të përmirësojë mjedisin e biznesit"

Shqipërisë i nevojiten reforma për përmirësimin e mjedisit të biznesit, reforma në sektorin energjetik nuk duhet neglizhuar, sundimi i ligjit duhet forcuar, për të përmbushur kërkesat e BE-së për hapjen e bisedimet e pranimit. Këto janë prioritetet që BERZH i adreson vendit tonë në raportin më të fundit të tranzicionit 2017-2018. Raporti i tranzicionit i BERZH për 2017-2018 tregon se rritja në vendet e BERZH aktualisht është duke mbetur mbrapa dhe shumë ekonomi duket se janë mbërthyer në një "kurth të ardhurash të mesme", që i mban ata nga lëvizja në nivelin e ardhshëm. "Duke përdorur përparësitë që përdorën për të mbështetur performancën e tyre të fuqishme të rritjes në të kaluarën, vendet e rajonit të BERZH tani kërkojnë një model të ri rritjeje",-thotë raporti. Publikimi fokusohet në tri fusha kyçe që duhet të përqafojë modeli i ri: përmirësimi i produktivitetit të firmave individuale, investimet në infrastrukturë dhe theksimi i rritjes së gjelbër. Në theksimin e rëndësisë së rrjeteve efektive të infrastrukturës, raporti thotë se shumica e ekonomive në rajonin e BERZH-it kanë nevojë për shpenzime të mëdha për të ruajtur, përmirësuar dhe zgjeruar infrastrukturën e tyre për të mbështetur rritjen ekonomike dhe për të ndihmuar nivelet e të ardhurave të konvergojnë me ato të ekonomive të përparuara. Sa i përket vlerësimeve për vendin tonë, raporti i tranzicionit 2017-18, thotë se performanca makroekonomike vazhdon të forcohet. "Normat e rritjes së PBB-së janë në një trajektore rritëse dhe programi i FMN-së është përmbyllur me sukses, duke kontribuar në rritjen e stabilitetit fiskal dhe një nivel në rënie (megjithëse ende të lartë) të borxhit publik."

**PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2018**

1.Reformat e orientuara kah BE duhet të rriten. Është thelbësore për prosperitetin afatgjatë të Shqipërisë që vrulli në përafrimin e BE-së të ruhet dhe të përshpejtohet dhe se gjithçka bëhet në fushën e reformës së administratës publike dhe sundimit të ligjit (në mesin e fushave të tjera) për të përmbushur kërkesat e BE-së për hapjen e bisedimet e pranimit.

2. Nevojiten reforma të mëtejshme të mjedisit të biznesit. Fushata kundër informalitetit ka dhënë rezultate të rëndësishme, por nevojiten përpjekje shtesë për të trajtuar problemet e rrënjosura thellë si marrja e energjisë elektrike, regjistrimi i pronës dhe zbatimi i kontratave.

3.Momenti i reformës në sektorin e energjisë duhet të jetë i qëndrueshëm. Hapat e marra tashmë përfshijnë: mbledhjen e numrit të faturave dhe zvogëlimin e humbjeve të shpërndarjes dhe shlyerjen e borxheve në sektorin privat.

## Meta: Më shumë përkrahje nga shteti për integrimin e jetimëve

# Veprimtari për fëmijët pa përkrahje prindërore


Presidenti Ilir Meta

Në kuadër të Javës së Fëmijëve pa përkrahje prindërore, Presidenti i Republikës, Ilir Meta zhvilloi veprimtarinë ndërgjegjësuese për fëmijët jetimë. Gjatë këtij aktiviteti, Presidenti bëri thirrje ndaj shtetit dhe shoqërisë për më shumë përpjekje të përbashkëta për integrimin e fëmijëve jetimë. "Ndiej përgjegjësi të shumëfishtë që shteti, qeverisja qendrore dhe vendore, politikat publike dhe iniciativat private si dhe mbarë shoqëria shqiptare të bëjnë përpjekje të përbashkëta për integrimin e fëmijëve jetimë, që të rriten të shëndetshëm, të edukuar dhe arsimuar, të ndjejnë ngrohtësinë e shtetit dhe të shoqërisë",-tha Meta në fjalën e tij. Më tej ai theksoi se varfëria, problemet ekonomike, papunësia, dhuna në familje dhe emigracioni po shkaktojnë çdo ditë e më shumë divorce e si pasojë edhe shumë fëmijë jetimë. "Përballë varfërisë, shteti dhe mbarë shoqëria jonë duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha. Ulja e nivelit të varfërisë, ngritja e minimumit jetik, kërkimi dhe gjetja e rrugëve të reja për të ndihmuar individët, familjet e shtresat më të varfëra si dhe kategoritë me vulnerabël të vendit duhet të jenë në krye të prioriteteve të politikave tona",-u shpreh Presidenti i Republikës. Gjithashtu, ai tha se për të minimizuar këto fenomene, duhet të investohet në fuqizimin e familjes shqiptare dhe rritjen e mbështetjes për nënat kryefamiljare në veçanti. Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Institucionin Kombëtar të Integrimit të Jetimëve Shqiptarë, në prani të përfaqësuesve të qeverisë e të Kuvendit, ambasadorëve të huaj, aktivistëve të shoqërisë civile dhe të organizatave rinore, artistëve të shquar etj. Në këtë veprimtari, Meta solli si shembuj për fëmijët jetimë disa nga artistët tanë më të shquar të kombit shqiptar që dolën nga kategoria shoqërore e fëmijëve jetimë.

## Ambasada: Kujdes nga njoftimet e paligjshme mbi përzgjedhjen, si duhet të verifikoni

# Përfundon procesi i aplikimit për Lotarinë Amerikane

## *Ja kur shpallen fituesit e DV-2019*

Voltiza Duro

Të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë në "tokën e premtuar", dje kanë pasur shansin e fundit për të aplikuar. Ashtu siç ishte bërë me dije edhe më parë nga Departamenti i Shtetit, afati i fundit për t'u regjistruar në Lotarinë Amerikane, ishte data 22 nëntor i këtij viti. Më tej do të bëhet përzgjedhja rastësore e kandidatëve, ku çdo aplikuesi i vendoset një numër dhe kompjuteri në Qendrën Konsullore Kentucky përzgjedh numrat, pa asnjë dallim. Më pas, shikohen aplikimet që kanë kryer regjistrim më shumë se një herë dhe skualifikohen.

Për ata që kanë aplikuar për Programin e Lotarisë DV-2019, njoftimi zyrtar i përzgjedhjes do të kryhet drejtpërdrejt nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Aplikimit. Ky i fundit do të jetë në përdorim duke filluar nga data 2 maj 2018, në faqen e internetit të Departamentit Amerikan të Shtetit. Për aplikantët, kjo është e vetmja mënyrë me të cilën mund të njoftohen nëse janë përzgjedhur apo jo e për ta verifikuar këtë, ata duhet të përdorin numrin e tyre unik të konfirmimit të dhënë në regjistrim. Pasi personi rezulton i përzgjedhur dhe i caktohet data e intervistës, është oficeri konsullor që shqyrton çështjen e tij/saj dhe merr vendimin final për vizën, bazuar në kualifikimin dhe pranueshmërinë për vizë të aplikantit. Më tej, fituesit do të informohen nga Kontrolli i Statusit të Regjistruarve, se si të aplikojnë për vizën e anëtarët e tyre të familjes. Në faqen zyrtare të Ambasadës Amerikane bëhet me dije se të përzgjedhurit duhet të plotësojnë formularin elektronik DS-260. "Sa më herët ta plotësoni formularin DS-260, aq më shpejt keni mundësinë e caktimit të datë së intervistës për vizë. Caktimi i datës së intervistës varet nga dy faktorë: 1. numri juaj, sa më i ulët - aq më shpejt intervista, dhe 2. sa më shpejt të plotësoni DS-260, aq më shpejt intervista.", -thuhet në njoftimin e ambasadës. Ndërkohë, në të gjitha ato raste kur kandidatët marrin njoftime mbi përzgjedhjen me anë të postës elektronike apo me postë, duhet të tregohen të kujdesshëm pasi këto njoftime janë të paligjshme.

**PËRZGJEDHJA**

Kontrolli i Statusit të Aplikimit do të jetë në përdorim duke filluar nga data 2 maj 2018, në faqen e internetit të Departamentit Amerikan të Shtetit. Për aplikantët, kjo është e vetmja mënyrë me të cilën mund të njoftohen nëse janë përzgjedhur apo jo.



## Panairi i Brukselit, kryebashkiaku Veliaj takon delegacionin që do përfaqësojë Tiranën

Kryeqyteti do të bëhet pjesë e panairit të dimrit "Winter Wonder", i zhvilluar në Bruksel nga data 24 nëntor- në 31 dhjetor, ku Shqipëria do të ketë mundësi promovimi mbi kulturën, historinë e turizmin tonë. Kryebashkiaku Erion Veliaj, mirëpriti para nisjes delegacionin shqiptar që do të përfaqësojë Tiranën dhe traditat e vendit në panairin më të njohur të Europës. "Ne do të kemi stendën kryesore të Panairit të Brukselit, të mbushur me produkte shqiptare, muzikë shqiptare, kostume shqiptare, do të flasim shqip, do të kemi vallëzime dhe shumë aktivitete, pothuajse në të gjitha 40-të netët e Brukselit", - tha Veliaj. Më tej, ai theksoi se ky panair do të jetë një mundësi e mirë bashkëpunimi mes bizneseve vendase dhe atyre të huaja, për t'i dhënë një impuls pozitiv ekonomisë së vendit.

## Të rinjtë: Më tepër mbështetje nga qeveria

# Raporti: Rreth 58% e fëmijëve shqiptarë dhunohen fizikisht, 34% pre e bulizmit



Rreth 58% e fëmijëve shqiptarë dhunohen fizikisht, ndërsa 34% e tyre kanë rënë pre e bulizmit e madje nuk ndihen të sigurt në shkollat ku mësojnë. Këto janë të dhënat e studimit më të fundit "Zëri i të Rinjve në Shqipëri", realizuar me grupmoshën e të miturve 12-17 vjeç nga organizata "Save the children". Rreth 1200 fëmijë janë pyetur në lidhje me shqetësimet që kanë sot, por edhe në të ardhmen, dhe kanë dhënë mendimet e tyre mbi masën që iu cenohen të drejtat në vendin ku jetojnë. Sipas raportit, vajzat janë ngacmuar dy herë më shumë se djemtë dhe 56% e fëmijëve shprehen se strukturat përkatëse duhet të bëjnë më shumë për të eliminuar fenomenin e bulizmit në shkolla. Ndërsa një numër i lartë të miturish, pra 87% e tyre tregojnë se strukturat përkatëse duhet të bëjnë më shumë për të ndihmuar fëmijët që dëmtojnë veten. Një problem shumë i rëndësishëm që kanë ngritur fëmijët është edhe mungesa e psikologut në shkolla, ku 90% e tyre kërkojnë praninë e tij për t'i ndihmuar të kalojnë stresin e madh të shkaktuar nga detyrat apo rezultatet e shkollës. "73% ndjehen të stresuar nga detyrat dhe 75% ndjehen të stresuar nga rezultatet në shkollë", - citohet në raport.


**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"**
**SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:**

1- **Apartament** me sip. 147 $m^2$, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8270, Numri Pasurise 3/40+1-16, , Volum.42, Faqe.56. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **148.176 Euro**.

2- **Garazhd, Nr.1** me sip. 520 $m^2$,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G1, vol.18, faqe.72. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III eshte **445.536 Euro**.

3- **Njesi** me sip. 50 $m^2$, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N2, vol.18, faqe.76. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha.Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **120.960 Euro**.

4- **Garazh N.2** me sip. 50 $m^2$.Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane.ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G2, vol.18, faqe.73. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha.Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **42.840 Euro**.

5- **Garazh N.3** me sip. 570 $m^2$, Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G3, vol.18, faqe.74. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **488.376 Euro**.

6- **Apartament** me sip. 402.9 $m^2$,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane,ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise 3/241+1-1, Volum.18, Faqe.78. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **731.022 Euro**.

7- **Njesi** me sip. 310 $m^2$,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane,ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N1, vol.18, faqe.75. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **750.920 Euro.**

8- **Njesi** me sip. 364.7 $m^2$,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane,ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N3, vol.18, faqe.77. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **827.139 Euro**.

**Ankandi** per te gjitha pasurite e sipërcituara **do te zhvillohet datë 05.12.2017 ora 16.00** në zyrat e shoqerise EPSA shpk te ndodhura ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane.

Ministrja: Investime edhe në përmirësimin e infrastrukturës në spitale, analiza falas

# Prej 1 janarit, dyfishohet pagesa e ndihmës ekonomike

## *Manastirliu: Mbi 49 miliardë lekë financim për shëndetësinë*

Voltiza Duro

Nga 1 janari i vitit 2018-të, pagesa e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë do të dyfishohet duke e shtrirë skemën në të gjithë vendin. Ky lajm është bërë me dije nga Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu në Komisionin parlamentar të Ekonomisë. "Skema e re e ndihmës ekonomike do të eliminoje kriteret përjashtuese, do të lehtësojë dokumentacionin për qytetarët në nevojë, do të eliminojë ndihmën e pjesshme për 40.000 familje të skemës së ndihmës ekonomike, duke rritur dyfish masën e pagesës së ndihmës ekonomike",-u shpreh Manastirliu. I ndarë në dy fushat e aktivitetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për Shëndetësinë do të financohen 49 miliardë e 294 milionë lekë ose 2.98% të PBB, ndërsa për Mbrojtjen Sociale do të financohen 23 miliardë 785 milionë e 750 mijë lekë. Ndërsa për sa i përket investimeve në shëndetësi, ministra deklaroi se do të ketë dyfishim të investimeve, duke financuar rreth 3 miliardë lekë për përmirësimin e infrastrukturës në qendrat shëndetësore dhe spitalet në të gjithë vendin. "Në fakt, Kontrolli Mjekësor Bazë është një program shumë i rëndësishëm për parandalimin e sëmundjeve kronike jo të transmetueshme, si ato kardiovaskulare, diabeti apo hipertensioni, të cilët janë shkaktarët më të mëdhenj të vdekshmërisë në Shqipëri. Ne sot e ofrojmë këtë mundësi për 1.2 milionë rezidentë",-tha Manastirliu. Më tej ministrja theksoi se shërbimi i laboratorëve do të shtrihet gjatë vitit 2018 në 18 spitale të vendit, nga të cilat 5 spitale universitare, 11 spitale rajonale dhe 2 spitale bashkiake atë të Sarandës dhe të Lushnjës. "Do të kryhen 160 lloje analizash për të gjithë pacientët e shtruar dhe pacientët e referuar ambulatorë, duke iu kursyer shqiptarëve pagesat nga xhepi dhe duke rritur standardin dhe cilësinë e shërbimit laboratorik në spitalet tona publike",- tha ajo.

**ANALIZA FALAS**

Kontrolli Mjekësor Bazë është një program shumë i rëndësishëm për parandalimin e sëmundjeve kardiovaskulare, diabeti apo hipertensioni, të cilët janë shkaktarët më të mëdhenj të vdekshmërisë në Shqipëri. Ne sot e ofrojmë këtë mundësi për 1.2 milionë rezidentë. Do të kryhen 160 lloje analizash për të gjithë pacientët e shtruar dhe pacientët e referuar ambulatorë", - tha Manastirliu.



Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu në Komisionin parlamentar të Ekonomisë

**INVESTIMET**

Në Komisionin e Ekonomisë, Manastirliu, gjithashtu, prezantoi edhe investimet që do të bëhen në përmirësimin e infrastrukturës së spitaleve. Sipas saj, në 2018-ën, do të bëhet financimi i punimeve për dy spitale të reja brenda QSUT-së si dhe do të do të përfundojë ndërtimi i maternitetit të Sarandës, rikonstruksioni i maternitetit të Korçës, spitalit të Pediatrisë në Durrës, shërbimit të Urgjencës dhe imazherisë në Elbasan si dhe një sërë ndërhyrjesh infrastrukturore, ku 260 milionë lekë do t'i akordohen përmirësimit të infrastrukturës së 80 qendrave shëndetësore dhe ambulancave në të gjithë vendin.

### Muçaj: Organizimi sindikal, përmirësim në kushtet e punës

## Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomunikacionit takim me homologen gjermane

Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomunikacionit Shqiptar ka organizuar takimin me sindikatën homologe gjermane, VER.DI mbi hartimin e një plani strategjik për më shumë bashkëpunim mes sindikatave tona. Përfaqësuesit e SPPTSH-së, kryesuar nga Renato Muçaj shprehën edhe njëherë vendosmërinë e tyre për të kontribuar në organizimin e punonjësve të telekomunikacionit në Shqipëri në sindikatë, të cilët janë të vetmit pjese e kësaj kategorie në Europë që nuk kanë një organizim sindikal, përveç një operatori. Të gjithë përfaqësuesit e SPPTSH-së që merrnin pjesë në këtë takim kane zhvilluar një dialog konstruktiv duke gjeneruar ide të ndryshme që u bënë pjesë e protokollit të këtij plani veprimi. Në mënyrë vullnetare të gjithë pjesëmarrësit morën përsipër detyra të veçanta si pjesë e grupeve të punës që u ngritën gjatë këtij takimi për realizimin e planit të veprimit. Në vazhdim të partneritetit që u dakordësua në Berlin, Sindikata Gjermane u shpreh e gatshme për të aplikuar të njëjtën formë partneriteti që i jepet edhe Sindikatës Amerikane të Komunikimit (CWA), e cila po bën një betejë të gjatë prej vitesh për organizimin e punonjësve të telekomunikacionit në Amerikë. Kreu i Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomunikacionit, Renato Muçaj theksoi se deri më tani në vendin tonë vetëm një operator telekomunikacioni ka arritur që të organizojë punonjësit e vet në sindikatë. Sipas tij, nëse bëhen pjesë e sindikatës, punonjësit mund të shprehen lirisht mbi problematikat e tyre në lidhje me sigurinë, shëndetin e kushtet që iu ofrohen në vendin e punës. Ndërkaq, përfaqësuesja në Federatën Ndërkombëtare UniGlobla Union, Alke Boessiger shprehu kënaqësinë e saj që për herë të parë vizitonte vendin tonë edhe sindikatën e Punonjësve të Postë-Telekomunikacionit Shqiptar. Ajo tha se rezultatet gjatë takimit dy ditor në Tiranë ishin të arrira dhe priste me padurim vënien në jetë të planit strategjik të veprimit. Gjithashtu, Boessiger theksoi se 'UniGlobal Union" do të vazhdojë të mbështesë sindikatën shqiptarë të punonjësve të telekomunikacionit në rrugën e forcimit dhe zgjerimit. Më tej ajo shtoi se u vlerësua puna e bërë deri tani dhe deklarua se UniGlobla Union ka filluar studimin e tregut të Call Center për kushtet e punës në këtë sektor që ka një numër të lartë të punësuarish dhe ku të drejtat e punonjësve shkelen në mënyra të ndryshme. Ndërkaq, Renato Muçaj vlerësoi edhe njëherë takimin dhe i garantoi të gjithë pjesëmarrësit se SPPTSH do të vazhdojë të kontribuojë që askujt prej punonjësve të sektorit të telekomunikacionit mos t'i mohohet e drejta kushtetuese për organizimin e tij në sindikatë.





### Jokaluesit humbasin punën

## Punonjësit e administratës civile, testim mbi njohuritë

Punonjësit e administratës publike do t'i nënshtrohen provimit për testimin e njohurive, në të gjithë strukturat me funksione inspektimi, e në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil. Të gjithë ata që marrin më pak se 51 pikë, do të deklarohen si jokalues në testim dhe për pasojë do të humbasin vendin e punës. Ky njoftim është publikuar në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike në të cilin theksohet se provimi i parë do të bëhet në 9 dhjetor të këtij viti dhe do të bazohet në njohuritë mbi ndryshimet e ndodhura në legjislacionin e fushës së inspektimit. Gjithashtu, janë përcaktuar edhe drejtoritë, inspektoratet dhe entet e para shtetërore, punonjësit e të cilëve do t'i nënshtrohen provimit për testimin e njohurive. Punonjësit e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe të drejtorive të bujqësisë do të jenë të parët që do t'i nënshtrohen testimit me shkrim për përditësimin e njohurive. Më 9 dhjetor do të testohen, gjithashtu, edhe punonjësit e Njësisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit. Ky testim do të përmbajë pyetje teorike dhe ushtrime praktike. "Bazuar në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 1037, datë 16/12/2015 të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë", Departamenti i Administratës Publike do të fillojë testimin për të vlerësuar përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë, për nëpunësit civilë në të gjithë strukturat me funksione inspektimi, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil", - thuhet në njoftim.

"Dy kandidaturat e mundshme të konkursit të organizuar nga MSHMS, u skualifikuan padrejtësisht"

# Shkodër, mjekët kundër përzgjedhjes së kreut të spitalit

## "Ish-kandidati për deputet i PS-së Vilson Masmalaj, s'ka lidhje me shëndetësinë"

Senad Nikshiqi

**SHKODËR**


Vilson Masmalaj


Përparim Çela


Senad Halluni

Përzgjedhja e Vilson Masmalajt si drejtor i spitalit rajonal të Shkodrës në konkursin e zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë nuk ka lënë aspak një shije të mirë te mjekët dhe infermierët e këtij institucioni shëndetësor. Deri në fund të garës, dy kandidaturat e mundshme për t'u shpallur fitues kanë qenë drejtori që ishte deri më tani, Përparim Çela dhe mjeku gjinekolog, Senad Halluni. Në fakt, Ministria e Shëndetësisë nuk ka shpallur asnjërin prej tyre fitues, por ka renditur në vend të parë ish-kandidatin për deputet të PS-së në zgjedhjet e 2017-ës, Vilson Masmalajn. Kjo përzgjedhje nuk është pritur mirë nga një pjesë e mjekëve të spitalit të Shkodrës, të cilët nuk kanë heshtur përballë kësaj situate. Mësohet se Urdhri i Mjekut ka zhvilluar një takim me mjekët e këtij spitali dhe këta të fundit kanë shprehur indinjatën e tyre në lidhje me emërimin në krye të këtij institucioni të Vilson Masmalajt. Burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije se mjekët e qytetit verior nuk e kanë mirëpritur këtë përzgjedhje që ka bërë ministria duke thënë se Vilson Masmalaj nuk ka lidhje me shëndetësinë dhe nuk mund të jetë në krye të shëndetësisë në Shkodër. Urdhri i Mjekut, gjatë diskutimeve të zhvilluara në takimin në fjalë ka kërkuar që Ministria e Shëndetësisë të mos emërojë zyrtarisht Masmalajn si drejtor të spitalit. Kjo për faktin se ka dyshime për mënyrën se si ai ka fituar, ndërsa kanë kërkuar që në drejtim ose të vijojë mjeku që ishte deri më tani (Përparim Çela) ose gjinekologu Senad Halluni, që u rendit i dyti në këtë proces të gjatë konkurrimit. Në fund të mbledhjes, Urdhri i Mjekut në Shkodër përgatiti një shkresë zyrtare që pritet t'i dërgohet Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me këtë rast.

**KONKURSI**

Mësohet se konkursi për drejtor të spitaleve në mbarë Shqipërinë u zhvillua në tri faza të ndryshme. Faza e parë me 20 pikë, përfshinte plotësimin e dosjes së plotë; faza e dytë, një provim me shkrim me pyetje shkencore rreth mjekësisë, ndërsa faza e tretë, pyetje përgjigje me gojë përpara një komisioni prej 12 personash rreth menaxhimit të shëndetësisë, por sërish me pyetje profesionale. Duke qenë se Vilson Masmalaj nuk e njeh mjekësinë dhe shëndetësinë, për shkak se është diplomuar në ekonomi, ndërsa ka menaxhuar një kompleks blegtoral, kanë lindur dyshime te mjekët e spitalit të Shkodrës, të cilët këtë herë nuk kanë zgjedhur heshtjen.

**REAGIMI**

"Ne nuk mund të lejojmë që në spital të vijë një person që nuk ka lidhje me shëndetësinë. Mund të jetë një figurë e nderuar, por është e qartë se nuk e njeh as mjekësinë dhe as shëndetësinë. Nëse në këtë mes ka pasur një proces politik duke shkelur mbi mjekët dhe duke bërë farsë konkursin, atëherë ne nuk duhet të lejojmë që të ndodhë kjo gjë. Në krye të spitalit na duhet një mjek, pra një koleg i yni që e njeh spitalin, shëndetësinë dhe i di të gjitha problemet që janë. Kjo mënyrë na godet të gjithëve ne, ndaj është momenti të bashkohemi dhe të ngremë zërin deri në Ministrinë e Shëndetësisë në mënyrë që emërimi i Vilson Masmalaj të ndalet",- janë shprehur mjekët gjatë mbledhjes. Gjithashtu, disa nga bluzat e bardha kanë thënë se "Nuk është aspak normale që të veprohet kështu. Ministria ka dy mundësi: ose të lejë në detyrë Përparim Çelën ose të emërojë Senad Hallunin që është mjek dhe u rendit i dyti. Ka ardhur koha që në spital të kemi drejtues vetëm profesionistë ashtu siç e ka gjithë bota dhe nuk duhet të heshtim e aq më tepër të kemi frikë. Shpresojmë që ministria ta dëgjojë zërin tonë dhe të veprojë ashtu siç duhet".

**GARA**

Mësohet se deri në fund të garës, dy kandidaturat e mundshme për t'u shpallur fitues kanë qenë drejtori që ishte deri më tani, Përparim Çela dhe mjeku gjinekolog, Senad Halluni. Në fakt, Ministria e Shëndetësisë nuk ka shpallur asnjërin prej tyre fitues, por ka renditur në vend të parë kandidatin për deputet të PS-së në zgjedhjet e 2017-ës, Vilson Masmalajn.

**PROTESTA**

Mjekët e spitalit të Shkodrës kanë reaguar ashpër pas përzgjedhjes së Vilson Masmalajt në krye të këtij institucioni. "Mund të jetë një figurë e nderuar, por është e qartë se nuk e njeh as mjekësinë dhe as shëndetësinë. Nëse në këtë mes ka paSur një proces politik duke shkelur mbi mjekët dhe duke bërë farsë konkursin, atëherë ne nuk duhet të lejojmë që të ndodhë kjo gjë",- thanë ata.

**DEKLARATA**

Sipas mjekëve të Shkodrës, Ministria e Shëndetësisë ka dy mundësi: ose të lejë në detyrë Përparim Çelën ose të emërojë Senad Hallunin që është mjek dhe u rendit i dyti. "Ka ardhur koha që në spital të kemi drejtues vetëm profesionistë, ashtu siç e ka gjithë bota, dhe nuk duhet të heshtim e aq më tepër të kemi frikë. Shpresojmë që ministria ta dëgjojë zërin tonë dhe të veprojë ashtu siç duhet",- deklaruan bluzat e bardha.

---

### Alfred Tereziu: Vajzën e mora në makinë se binte shi

## 13-vjeçarja nga Kruja e denoncoi se e përdhunoi në hotel, gjykata lë në burg 32-vjeçarin



**DURRËS** - Gjykata e Shkallës së Parë e Durrësit ka dhënë dje masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj 32-vjeçarit Alfred Tereziu nga Tirana, i cili akuzohet se ka abuzuar seksualisht me një 13-vjeçare nga Kruja. Ka qenë e mitura me inicialet D.P.. Ka qenë vetë e mitura, e cila tre ditë më parë ka deklaruar në policinë e qytetit bregdetar, se Terezia e ka futur me forcë në makinën e tij dhe e ka çuar në një hotel në autostradë. "Ky djali më ndaloi në autostradë, më mori në makinë dhe më çoi në një hotel ku më përdhunoi",-është shprehur vajza. Pas denoncimit të saj, policia e qytetit bregdetar a ka shkuar në një hotel që ndodhet në autostradën Tiranë-Durrës dhe ka sekuestruar pamjet filmike. Përmes kamerave, e mitura ka arritur të dallojë të riun Alfred Tereziu. Ndërkaq, 32-vjeçari ka mohuar akuzat në gjykatë duke thënë se nuk ka bërë gjë me të miturën dhe se ajo e akuzon kot. "Vajzën e pashë në rrugë. Ajo ngriti dorën dhe unë e mora në makinë, pasi po binte shi. E çova deri ku donte ajo. Nuk e kam prekur me dorë dhe aq më pak ta kem përdhunuar. Nuk e di se çfarë thotë ajo, por unë nuk kam lidhje fare me këtë histori",-ka pohuar 32-vjeçari. Ndërkaq, materialet në ngarkim të tij i kanë kaluar për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale: "Marrë dhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur".

---

## Punonjësit e 55 kompanive të bypasit Fier-Vlorë hidhen në protestë për pagat

Punonjësit e 55 kompanive nënkontraktore dhe furnitore te bypasit të Fierit dhe Vlorës dje protestuan për pagat e pa marra prej afro një vit e gjysmë . Tubimi është zhvilluar në Mbrostar, vendin ku nis kjo vepër. Protesta e tyre vjen në një moment kur shteti shqiptar ka çelur procedurat për rihapjen e tenderimit të kësaj vepre, ndërsa afro 600 punonjësit të bypasit Fier dhe 350 të bypasit Vlorë që kanë punuar me parë në punimet e këtyre rrugëve, kanë 6 muaj pa u paguar për 2015-n dhe gjithë vitin e kaluar. Gjatë protestës, punonjësit, të cilët aktualisht janë të papunë kërkuan nga qeveria shqiptare të paguhen për periudhën e papaguar. Ata u shprehën se nuk do të lejojnë asnjë



firme tjetër të nisë punimet, nëse nuk do të marrin pagat e prapambetura, dhe nëse nuk do të dëgjohet kërkesa e tyre, do të përshkallëzojnë protestën deri në Kryeministri dhe në bllokimin e rrugëve.

---

### Grabitet me armë supermarketi, policia shoqëron dhe merr në pyetje 8 persona

**LEZHË**-Një grabitje me armë ka ndodhur ditën e djeshme në Lezhë. Një person ende i paidentifikuar ka marrë xhiron e një supermarketi në rrugën "Shtraus" të këtij qyteti, pasi ka kërcënuar me armë punonjësit. Mësohet se pasi ka marrë paratë e xhiros ditore (rreth 300 mijë lekë), ai është larguar me shpejtësi. Menjëherë në vendngjarje ka mbërritur policia dhe ka nisur hetimet për ngjarjen. Deri më tani janë shoqëruar 8 persona për t'u marrë në pyetje, nëse kanë dijeni mbi ngjarjen. Sipas policisë, autori i grabitjes është një person rreth të 20-ave, dhe dyshohet se kishte dijeni për xhiron ditore të supermarketit.

### "Një në prokurorinë e Fierit dhe një te Krimet e Rënda"

## Lirimi i një prej 3 të arrestuarve gjatë operacionit "Forca e ligjit", policia: Ka 2 procedime penale

**DEKLARATA**
Një javë më parë, pas operacionit "Forca e ligjit", policia deklaroi se tre personat e arrestuar si anëtarë të grupit të strukturuar kriminal dyshohet se ndër vite në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë trafikuar lëndë narkotike të llojit kokainë, heroinë dhe kanabis sativa brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**TIRANË** - Një ditë pas publikimit të lajmit për lirimin e një prej tre të arrestuarve gjatë operacionit "Forca e ligjit" në Fier, ka reaguar Policia e Shtetit, e cila ka sqaruar se në lidhje me këtë grup kriminal ka dy procedime penale, një në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier dhe një në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Reagimi ka ardhur pas lirimit nga Gjykata e Shkallës së Parë të Fierit të 45-vjeçarit Kujtim Kuçi për arsye shëndetësore (është paraplegjik), i cili u vu në pranga pasi iu gjet një pistoletë pa leje. Ndërsa, ngriheshin dyshime për referimin e policisë, e cila ditën e arrestimit të Kuçit, Dritan Tushës dhe Bashkim Ahmetos deklaroi se ata akuzohen edhe për rrëmbime e vrasje. Por, sërish në reagimin e policisë nuk përmenden veprat penale: "Vrasje" e "rrëmbim".


Operacioni "Forca e ligjit"

**REAGIMI I POLICISË**

Në njoftimin zyrtar të ditës së djeshme, Policia e Shtetit bëri me dije se në bazë të objektit të veprave penale të ndara në kapitujt e Kodit Penal, "Armëmbajtja pa leje", "Prodhim dhe mbajtje të lëndëve narkotike" dhe "Përshtatje të ambienteve për tregtim të lëndëve narkotike" janë referuar në Prokurorinë e Rrethit Fier. Ndërsa për grup të strukturuar kriminal mbi bazën e ligjit 1092, Antimafia, për pastrim të produkteve të veprës penale për "Trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike" dhe "Falsifikim dokumentesh" janë referuar në datë 15.11.2017 dhe hetohen nga Prokuroria për Krimet e Rënda, Tiranë. Sakaq, Policia e Shtetit siguron qytetarët se operacioni "Forca e Ligjit" do të vazhdojë edhe më me intensitet në ditët e muajt në vijim, për të goditur me ashpërsi çdo grup kriminal të përfshirë në listën e zezë të këtij operacioni, përmes bashkëpunimit intensiv me partnerët ndërkombëtarë.

### Gjykata lë në burg 7 të akuzuarit. Rinard Tota: Kam pasur aktivitet të ligjshëm

# "Në lokalin e Tatës ishim të punësuara, të tjerat vinin dhe pinin kafe për qejf"

## *Femrat e arrestuara: Ishim grup shoqëror*

Senad Nikshiqi

**SHKODËR**

Gjykata e Shkallës së Parë e Shkodrës dje ka dhënë masën e sigurisë "Arrest me burg" për 7 personat e arrestuar pak ditë më parë në operacionin e koduar "Balerina", të cilët akuzohen se janë pjesë e një grupi kriminal, i përfshirë në shfrytëzimin dhe ushtrimin e prostitucionit. Gjatë seancës gjyqësore, gjyqtarja Izabela Radovani ka lënë në burg 50-vjeçarin Rinard (Federik) Tota, i akuzuar nga policia si kreu i grupit të prostitucionit, që u godit nga efektivët e qytetit verior. Po ashtu, togat e zeza të Shkodrës dhanë masën e sigurisë "Arrest me burg" edhe për 41-vjeçarin Kastriot Musa, që përfundoi në pranga si pjesë e këtij grupi kriminal. Ndërkohë që në këtë operacion të policisë vendore të Shkodrës u arrestuan edhe 5 shtetase të tjera. Gjykata vendosi lënien në qeli për shtetaset: Anita Lleshi, 33 vjeçe, banuese në Burrel; Sonila Meja, 32 vjeçe e dënuar më parë për prostitucion dhe banuese në Shkodër; Ardita Muça, 33 vjeçe, banuese në Shkodër; Albana Musa, 33 vjeçe banuese në Shkodër dhe Angje Ndrecaj, 25 vjeçe, banuese në Lezhë. Gjyqi ndaj personave të mësipërm është zhvilluar nën masa të rrepta sigurie nga forcat e policisë, teksa gjatë gjithë kohës ambientet jashtë gjykatës ishin nën mbikëqyrje. Seanca për masën e sigurisë ndaj 7 të arrestuarve u zhvillua me dyer të mbyllura, duke mos lejuar askënd brenda, qoftë nga familjarët apo mediat.

**DËSHMIA E TË ARRESTUARVE**

Burime për "Gazeta Shqiptare" pohuan se Rinard (Federik) Tota ka mohuar akuzat ndaj tij. "Unë kam pasur një aktivitet të ligjshëm dhe kam pasur disa persona të punësuar. Nuk kam lidhje me prostitucionin dhe lokali ka qenë normal. Ndërsa, shtetaset e arrestuara kanë qenë thjesht punonjëse dhe pjesë e një grupi shoqëror", mësohet të ketë thënë 50-vjeçari i akuzuar. Avokati i tij, Ilir Golemi ka kërkuar një masë më lehtësuese për klientin e tij, pasi provat e paraqitura nga organi i akuzës ishin të pamjaftueshme. Golemi ka argumentuar se Tota nuk ka lidhje, ashtu siç akuzohet, si koka e grupit të prostitucionit. Nga ana tjetër, Kastriot Musa është akuzuar si klient dhe se kishte shkuar në lokalin "Tata" për të kryer marrëdhënie me njërën prej vajzave që u arrestuan. Musa ka hedhur poshtë këto pretendime, duke thënë se ka qenë thjesht duke pirë një kafe në lokal dhe asgjë më shumë. Ndërkohë që edhe 5 shtetaset nuk kanë pranuar akuzat ndaj tyre. Sipas burimeve, ato janë shprehur se kanë qenë thjesht një grup shoqëror, që nuk ka lidhje me prostitucionin siç akuzohen. "Ne kemi qenë një grup shoqëror dhe s'kemi asnjë lidhje me prostitucionin. Kemi qenë në lokal duke punuar, siç punon çdokush dhe duke ushtruar një veprimtari të ligjshme dhe asgjë tjetër. Kemi punuar tek lokali si kameriere apo edhe sanitare, disa shoqet tona vinin aty për qejf", ka thënë njëra nga femrat e arrestuara. Në të njëjtën linjë kanë qenë edhe pjesa tjetër, duke mohuar se ushtronin prostitucion në ndërtesën në pronësi të "Tatës".


Rinard (Federik) Tota në gjykatën e Shkodrës

**GRUPI KRIMINAL**

Policia e Shkodrës i cilësoi 7 personat e arrestuar si grup kriminal të evidentuar në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit". Sipas bluve, arrestimet u bënë pas një hetimi disamujor me metoda speciale, duke qenë se kishte informacion se në lokalin "Tata" ushtrohej prostitucion. Në këtë mënyrë u sekuestrua ambienti trekatësh ku realizohej veprimtaria, dy automjete, një pistoletë, shtatë ora dore, bizhuteri floriri, një laptop, 8 telefona celularë si dhe një sasi parash në prerje të ndryshme, që dyshohet se janë siguruar nga prostitucioni. Të arrestuarit akuzohen për veprat penale: "Prostitucioni", "Shfrytëzim prostitucioni", "Mbajtje e ambienteve për prostitucion" dhe "Pastrim produktesh të veprave penale".

**SHKURT**

### Flakët shkrumbojnë shtëpinë njëkatëshe, nuk ka të lënduar

**SHKODËR** - Një shtëpi njëkatëshe në Shkodër është shkrumbuar nga flakët. Në momentin e rënies së zjarrit brenda banesës fatmirësisht nuk ndodhej asnjë prej familjarëve. Ngjarja ndodhi mëngjesin e djeshëm në rrugën "Fahri Ramadani" në Shkodër në afërsi të shkollës së mesme "Oso Kuka". Mësohet se pak minuta para se shtëpia të përfshihej nga flakët, gruaja që banonte aty kishte dërguar dy fëmijët e vegjël në shkollë, duke shmangur kështu një tragjedi të mundshme. Pas sinjalizimi për zjarrin e rënë në banesë, policia dhe zjarrfikësit kanë shkuar shpejt në vendngjarje dhe kanë bërë të mundur lokalizimin e shuarjen e flakëve. Ndërkaq, policia bëri me dije se dyshohet që zjarri është shkaktuar nga pakujdesia me ndonjë pajisje elektrike nga ana e familjarëve (banesën e kishin me qira), ose nga ndonjë shkëndijë elektrike.

### Zjarr në uzinën e naftës, plagoset lehtë punëtori 53-vjeçar

**BALLSH** - Vladimir Ymeri ka mbetur i plagosur pas një zjarri të rënë mëngjesin e djeshëm në ambientet e uzinës së naftës në Ballsh. Sipas burimeve nga policia lokale, zjarri ka rënë në repartin e "Koksit", ndërsa janë djegur mbetjet toksike të naftës. "Sot (dje) rreth orës 07:20, në Uzinën e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh ka rënë zjarr. Si pasojë e zjarrit është dëmtuar lehtë shtetasi L.Y., 53 vjeç, banues në fshatin Drenovë, Mallakastër (punëtor i këtij reparti), i cili po merr mjekim në spital. Në vendngjarje kanë shkuar forcat zjarrfikëse, të cilat po punojnë për shuarjen e plotë të zjarrit, i cili është vënë nën kontroll. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes", - thuhet në njoftimin e policisë.

## Iu gjet kanabis sativa në çantë, arrestohet 25-vjeçarja franceze

**QAFË THANË** - Një 25-vjeçare franceze është arrestuar dy ditë më parë nga forcat e Drejtorisë së Policisë së Qarkut të Korçës, pasi është kapur me një sasi lënde narkotike. Bëhet fjalë për shtetasen franceze me inicialet S.W.. Mësohet se 25-vjeçarja është ndaluar në pikën e kalimit kufitar të Qafë-Thanës, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në çantën e saj u gjet një sasi kanabis sativa. Pas sekuestrimit të drogës në cilësinë e provës materiale, materialet në ngarkim të shtetases franceze iu dërguan për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë. Pritet që gjykata e këtij rrethi të vendosë masën e sigurisë ndaj saj.

TAKIMI

# Rama kërkon rithemelim: Akademia e Shkencave, si shtëpi varrimi




Fatmira Nikolli

*"Shkurtim drastik fondesh, keni afat deri në mars për reformën, Eqrem Çabejt do t'i vinte turp"*

Kryeministri Edi Rama ka pritur dje në Kryeministri një përfaqësi të Akademisë së Shkencave pas kërkesës së kësaj të fundit për një bisedë me shefin e qeverisë. Marrëdhëniet Akademi-qeveri prej muajit shtator janë të ngrira, çka ka çuar në dorëheqje të kryetarit dhe nënkryetarit të zgjedhur në 4 shtator, Gudar Beqiraj dhe Muzafer Korkuti. Ndërsa kryeministri pat kërcënuar me prerje të buxhetit vjetor të Akademisë, para se Parlamenti të miratojë buxhetin për vitin 2018, Rama para akademikëve doli sërish me ultimatum.

Duke e quajtur Akademinë një kufomë, që hap dyert për të përcjellë arkivole, ai tha se përkrah profesorëve si Luan Omari, në Akademi ka edhe "mashtrues, marifteçi e zullumqarë". Në vazhdë të kësaj ideje, ai kërkoi rithemelim të Akademisë, duke lënë afat për kryerjen e reformës deri në mars. Bëri me dije se do të ketë një shkurtim drastik të fondeve. Rama tha se qeveria do ndihmojë kërkimin shkencor dhe për këtë qëllim do të investohet në krijimin e bibliotekës dixhitale pranë Universitetit të Tiranës.

## AKADEMIA SIPAS RAMËS

Kryeministri Rama tha dje se e vërteta është "që pavarësisht ftesës dhe përpjekjes sonë, nuk patëm asnjë reagim që të na nxiste në këtë proces e të na përfshinte ku humbëm, humbët më shumë se një vit në një inerci, që është inercia e kalbëzimit të vazhdueshëm të një institucioni, që u krijua si xhevahiri më rrezatues së kurorës së dijes shqiptare dhe sot është butim pezmatimi permanent, për të mos thënë brengë, për të gjithë ata që e zhvilluan Akademinë e Shkencave dhe i dhanë asaj shkëlqimin e autoritetit të tyre". Sipas tij, kjo situatë i ka shtyrë që të shkojnë deri tek ideja refuzimit për ta financuar më tutje këtë institucion me paratë e taksapaguesve shqiptarë.

"E vërteta është se sot Akademia e Shkencave është kufoma e vetvetes dhe nuk reflekton as vizionin e etërve themelues. Më vjen mirë që kam përballë një nga ata zanafillorët e Akademisë, Luan Omarit, që është edhe një nga dëshmitarët e rrugëtimit të Akademisë, ndërtimit dhe rrënimit të tij. Akademia nuk ka arritur që të reflektojë në asgjë, as në ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur, as në transformimin epokal të gjithë botës së dijes shqiptare në një botë të mbyllur e të centralizuar në një botë, që është shumë më e madhe se sa kufijtë e Shqipërisë sot". Rama shtoi se është e vërtetë se ligji i njeh Akademisë pavarësinë, por i ka garantuar në të njëjtën kohë edhe vegjetimin. Sipas tij, falë mjeteve të reja të komunikimit mund të përfshijë të gjithë trurin shqiptar në një rrjet kontributorësh, që pa asnjë diskutim do kishin gatishmërinë që të ndihmonin.

"Të jemi realistë, kjo Akademi kështu siç është, nuk motivon as ata që janë brenda saj, jo më të motivojë të tjerët që e shohin atë në distancë. Sfida nuk është një reformim i brendshëm strukturor, por është një rithemelim i këtij institucioni nga e para, duke marrë në konsideratë terrenin në të cilin do veprojë, burimet që do shfrytëzojë dhe impaktin që do ketë", tha Rama. Ai shtoi se po të kthehemi në vitin e themelimit të Akademisë, ishte një kohë tjetër me qëllime të tjera, me burime të tjera dhe me një impakt të shkencës në jetën e institucioneve krejt tjetër. Ai tha se na duhet një Akademi e Shkencave e riparë, na duhet një Akademi shqiptare që të ketë synimin e ambicien që të mund të përmbajë brenda vetes së vet të gjithë trurin e shkencës dhe të dijes së kombit dhe jo thjesht të shtetit. "Besoj se që këtu duhet të nisë rrugëtimi për ta rithemeluar këtë institucion. Flasim për shkencë, por nëse ne sot kemi një sistem akademik të botës ku s'ka një bibliotekë shkencore që të mund ta mbajë këtë emër, për çfarë diskutojmë"?

## AKADEMIA QË DUAM

Pyetja sipas Ramës, është shumë e thjeshtë çfarë duam ne nga kjo Akademi? Dhe çfarë i shërben sot vendit, të ketë si rezultat i rithemelimit të këtij institucioni? "Akademia vetë nuk e bën shkencën, por është kuvendi i atyre që e bëjnë shkencën në sektorët përkatës dhe që garantojnë një lloj llogarie të gjithë jetës akademike dhe shkencore të vendit ku ndikimi mbi autoritetet dhe mbi opinionin, vjen si rezultat i cilësisë së përfaqësimit në këtë kuvend të shkencës". Sipas tij, sot, nëse shohim, kemi një shërbim social për njerëzit e shkencës, me pensione e honorare për një grup njerëzish që kanë meritat e tyre në fushat përkatëse, ku është përzier i njomi me të thatin dhe në krahun e një profesori të nderuar është një pothuaj analfabet dhe ka të njëjtën peshë me titullin doktor, që nuk dihet si e ka marrë. "Ky është një shërbim social dhe nuk mund të vazhdojmë ta mbajmë në këmbë këtë shërbim social. Duke respektuar gjithsecilin dhe pikërisht për të mos djegur të njomin me të thatin mendojmë që nga një anë, pjesën e fondeve që shkon dëm do ta spostojmë për të krijuar Bibliotekën Shkencore të Universitetit. Është një shumë e konsiderueshme, të cilën mund të marrim menjëherë ta vëmë në dispozicion të universiteteve. Një bibliotekë digjitale të vitit 2017 në të gjitha fushat e në të gjitha materialet e orës së fundit".

## FINANCIMI

Rama tha se do të bëjmë një shkurtim drastik të fondeve, por do të ruajmë pjesën e financimit që ka të bëjë me ata që sipas statusit marrin një honorar apo një shpërblim, me një kusht që kjo të përkthehet brenda marsit me një platformë rithemelimi të Akademisë.

Sa i takon financimit, Rama tha se, "sa i përket pjesës së pagave dhe shpërblimeve që janë në fuqi për një grup njerëzish të nderuar, qoftë për pjesën tjetër, do të vëmë një afat. Ky afat do të jetë muaji mars, do të jetë afati i materializimit të këtyre që po diskutojmë. Diçka që mban të rrjetëzuar njerëzit që duan ta ndryshojnë këtë situatë. Por, që ne të vazhdojmë dialogun me një institucion, ku krahas Luan Omarit gjen personazhe që nuk dihet si kanë hyrë dhe pse janë aty dhe të gjithë flasin sikur përfaqësojnë një Akademi të lartë të Shkencave. Kjo është një tallje e madhe me themeluesit". Sipas ti, nuk ka nevojë të bëjmë asnjë debat, mjaft të përfytyrojmë vetëm një gjë: sikur të ngjallej sot Eqrem Çabej dhe të hynte në derën e asaj godine, si do të ndjehej? "Do të ndjehej krenar për atë që themeloi dhe për mënyrën si u zhvillua? Apo do thoshte po iki më mirë në botën tjetër, se sa të rri mes jush. Shyqyr që Eqrem Çabej e ca të tjerë janë në botën tjetër, përballë kësaj marrëzie që kemi para nesh, me emrin Akademia e Shkencave. Nëse do të shohim përgjegjësitë, sigurisht janë të gjithanshme, secili ka të vetat". Ai kujtoi se herën e parë kur u takuan ishte gjallë akoma Alfred Uçi. Sot nuk është më. "Unë uroj që të gjithë të jemi gjallë kur të takohemi përsëri, po këtu njerëzit po ndahen nga kjo botë dhe Akademia po mbetet si vendi ku po organizohen funeralet. Është bërë si shtëpi varrimi. Hap derën për të nxjerrë arkivolet jashtë. Nuk mund të vazhdojë më kështu dhe ju të gjithë jeni të vetëdijshëm për këtë. Ne të gjithë jemi. Besoj se mundësitë për të bërë diçka dinjitoze, modeste, në përmasën e vendit dhe kombit shqiptar, se ne nuk mund të bëjmë një akademi franceze, as një akademi sovjetike të rangut të lartë", tha kryeministri. Sipas tij, "ne mund të bëjmë një kuvend të shkencës dhe dijes që t'u japë mundësi atyre që kanë dëshirë, pasion dhe ndjenë detyrimin për të dhënë për shkencën e dijen në këtë vend që të jenë të përfaqësuar dhe të jenë në shoqërinë e tyre dhe jo në një shoqëri që nuk merret vesh ku mbaron profesori i nderuar dhe ku fillon një mashtrues, një marifteçi, një zullumqar që bën lëmsh gjithë sistemin". "Të paktën këtë ndarje ne duhet ta garantojmë, ndaj them rithemelim, jo rregullim. Se s'ka çfarë rregullohet. E vetmja gjë që ka bazë për rithemelimin është kapaciteti njerëzor. Nuk e bën dot qeveria me urdhra, as me një ligj", tha Rama. Teksa kritikoi botimet e Akademisë që sipas tij janë sa dramatike dhe komike, pa asnjë recencë e pa asnjë oponencë, tha se duam të fuqizojmë qoftë Qendrën e Studimeve Albanologjike se është një pikë themelore dhe referencë themelore e asaj, që mund të quajmë sot kërkimi shkencor në Shqipëri, për çka u takon domosdoshmërive që kanë të bëjnë me trashëgiminë, me identitetin dhe me gjuhën tonë.




*Në foto:*
**Kryeministri Edi Rama**



*Në foto:*
**Akademia e Shkencave**

# AKADEMIKËT, RAMËS: AKADEMINË E DËMTOI POLITIKA, ËSHTË SIMBOL I KOMBIT

Para kryeministrit Edi Rama, dje akademikët shqiptarë kanë parashtruar disa probleme. Secili prej tyre ka paraqitur vizionin e vet për Akademinë e Shkencave, reformën, të ardhmen e saj dhe vëmendjen që i duhet kushtuar. Sipas akademikëve, ndër vite Akademia është lënë pas dore ajo nuk është godina, as gjendja e sotme, Akademia është historia.

*Më poshtë fjalët e akademikëve.*

## *"Të biem dakord çfarë roli do ketë akademia, ka ikur jashtë truri i vendit"*

**VASIL TOLE**

Mes reformimit të detyruar dhe vetëreformimit, ne zgjodhëm këtë të dytën, si shenjë e qartë reflektimi institucional. Qëndrimi ynë sot është i dakordësuar, pas një procesi të gjatë edhe të vështirë për të sjellë në një kohezion të vetëm mendimet tona, sepse reformat kanë gjithmonë dy palë. Mbetemi të ndërgjegjshëm, se ky proces është një proces i vetëm edhe ai që do ta shërojë gjendjen edhe si një përgjigje ndaj trendeve të kohës për të ndërtuar ura të duhura komunikimi mes shkencës dhe politikës dhe anasjelltas. Theksoj faktin se ne besojmë se Akademia nuk janë thjesht akademikët e një me kohe të caktuar, as ne të sotmit, Akademia është trashëgimia që ata lënë për vendin. Edhe për këtë arsye fjalën ua jap dy kolegëve, që janë përfaqësues të reformës, që kanë një dokument draft për reformën.


*Në foto:*
**Përfaqësues të Akademisë së Shkencave në takim me Edi Ramën**

**SKËNDER GJINUSHI**

Duhet të t'i ndajmë gjërat, pasi janë dy probleme: 1) Reformimi i brendshëm i Akademisë, dhe 2) Çfarë vendi do të zërë Akademia në kuadrin e kërkimit shkencor në Shqipëri? Duhet që të kuptohet se situata ku ndodhet nuk është përgjegjësi e Akademisë në tërësinë e vet. Kërkimi shkencor në Shqipëri ka bërë mbrapa për dy arsye, 1) U godit dhe ra statusi i instituteve, një numër institutesh edhe u shkrinë. 2) Vetë kërkimi shkencor në shkollat e larta nuk është në atë nivel që duhet, se kemi mijëra doktoratura, që nëse flasim për cilësinë e tyre, lë shumë për të dëshiruar. Por një problem kryesor që ka Shqipëria është edhe eksporti apo emigracioni i trurit, që do të thotë se më të zotët apo më të aftët nuk rrinë më këtu. Kështu që për të dyja këto arsye, edhe për një politizim shumë të madh të reformës së fundit, bëri që ASH të kthehet në një organ honorifik. Një organ honorifik nuk është ai që prodhon shkencën, sepse shkenca prodhohet në katedra, atje ku investohet edhe njerëzit janë aktivë.

A do të kemi një ASH honorifike apo një ASH, e cila të ketë edhe funksione në institute? Problemi është që në të gjithë piramidën e kërkimit shkencor, cili do të jetë roli i ASH, i një qendre të koordinimit të kërkimit shkencor, por ka rëndësi edhe reformimi i brendshëm. Në bazë të funksionit, të shihet edhe përbërja apo kriteret e Akademisë. Në kohën e lavdishme, Akademia e kishte gjithë trurin e Shqipërisë këtu. Atëherë Akademia ka pasur cilësi më të lartë për shkak të kësaj, por edhe sepse kërkimet e instituteve kanë qenë në kuadër të ASH-së. Sot problemi është i qeverisë, ministrisë, instituteve, se si do luftojmë për ta rimarrë apo ringritur? Nëse do të anatemojmë ASH, anatemohet ajo që vetë kërkimi shkencor në Shqipëri është i hallakatur, ka rënë niveli edhe ata që kanë pasur më shumë sukses janë larguar.

**APOLLON BAÇE**

Ne jemi koshientë për nevojën, edhe ndoshta për modelin. Kemi bërë disa mbledhje dhe kemi arritur në një emërues të përbashkët me modelet. I qëndroj mendimit që ka thënë Dritëro Agolli, se Akademia është një simbol, që duhet të forcohet edhe jo të dobësohet. Një simbol i kombit, siç mund të jetë flamuri, apo edhe Kuvendi - vullnet i kombit dhe Akademia duhet që të jetë simbol i intelektit të kombit. Unë nuk e quaj veten ndonjë vaj të kualitetit të parë, sepse para meje mund të ishin shumë mirë Neritan Ceka dhe Pëllumb Xhufi, por puna qëndron këtu: Ne jemi një vaj, që një ditë do të digjet edhe aq dritë sa mund të bëjmë, kurse kandili, që është simboli, mendoj se nuk duhet hedhur. Por duke pasur parasysh fjalën e Agollit, mendoj se Akademia nuk duhet që të dobësohet, por të forcohet. Edhe në Procesin e Berlinit kërkohet dialogu midis shkencës e politikës dhe njëkohësisht kërkohet që politika të bisedojë intensivisht me shkencën, por të mos e drejtojë ajo. Në pikën e pestë të Procesit të Berlinit kërkohet kjo gjë, që Akademia apo mendimi dhe kërkimi shkencor duhet të fillojë të nivelohet në drejtim me vendet e BE-së, në mënyrë që të mos jetë vetëm ekonomia e niveluar, por edhe mendimi e kërkimi shkencor.

Po ndaloj tek një fjali juaja, që m'u duk interesante: "Karakteri i njeriut është fati i tij". Një fjali e Heraklitit, që për mua është filozofi më i dashur. Por, shpresoj që të shihni edhe shprehjet e tij të tjera, siç është edhe: "Ndihi ata që tentojnë progresin, qoftë edhe vonë. Edhe kuptimi i problemit është gjysma e përgjigjes". Modeli që ne kemi përzgjedhur nuk ka qenë modeli i Akademisë me institucione, por duke qenë se jam përfaqësues i Akademisë për Reformimin e Kërkimit Shkencor, jemi mundur që të përshtatemi me atë model.

**AURELA ANASTASI**

Pavarësisht nga pritshmëritë që keni pasur nga ky dialog, mendoj se dialogu midis shkencëtarëve dhe qeverisë është thelbësor, jo vetëm duke mbajtur parasysh interesat tona kombëtare, por edhe platformat ndërkombëtare edhe ato evropiane, diktojnë qartë nevojën për afrimin e kërkuesve shkencor edhe qeverisë, që studimet e studiuesve të përthithen më mirë nga Akademia. Dua që të mëshoj në faktin se Asambleja e Akademisë së Shkencave ka shqyrtuar një koncept-ide për reformimin. Ne duam që të ruajmë një Akademi, si organ të pavarur me autonominë e saj, që i ka njohur ligji, por natyrisht që e konsiderojmë të domosdoshme, t'i qasemi më mirë, në të gjithë reformën e sistemit të kërkimit shkencor në Shqipëri edhe e quajmë të domosdoshme, që të vendosim ura lidhëse midis komunitetit mbarëkombëtar shkencor edhe institucioneve të tjera kërkimore shkencore në vend edhe Akademisë së Shkencave. Duam që të jemi përfaqësues të denjë të kombit tonë në botë dhe të shkencës. Këtu i mëshoj idesë për një forcim të bashkëpunimit midis dy akademive, të Shqipërisë edhe Kosovës. Duam që të mos mbetemi thjesht koordinues të instituteve, por të jemi edhe më shumë dhe pse mund të jemi vetëm. Kërkojmë që të jemi pararendës dhe të marrim pjesë së bashku me qeverinë për hartimin e kërkimeve shkencore dhe të hapim fusha të reja studimi. Shumë i rëndësishëm është edhe aspekti që Akademia të ketë një rol vlerësues, monitorues, që të koordinojë studimin shkencor mbarëkombëtar ose të marrë pjesë, në mënyrë që këto vlera shkencore të jenë më të aksesueshme nga Akademia dhe qeveria në vend.

# Artan Fuga: Ka inatçinj që më kanë fyer, por bien dakord me mua

Deri tani është konceptuar dhe aprovuar unanimisht propozimi për pozicionimin e ri të saj, jo më si institut kërkimi shkencor, as si drejtori dikasteri, por si forum shkencëtarësh akademikë, që kontribuojnë në strategjinë e kërkimit shkencor në partneritet me qeverinë, si komunitet përfaqësues i kërkuesve shkencorë shqiptarë përtej ndarjeve të tyre disiplinore, institucionale, metodologjike. Në kuptimin hegelian se ndarja konceptuale nuk mund të ekzistojë pa konceptin tërësor, që bëhet garant për çdo koncept të veçantë. Unë me kolegë të tjerë kam punuar me këtë ide, jam shprehur dakord për të, e cila pas vitesh rezistence u pranua edhe nga ata që deri dje më kanë fyer ku kanë mundur, në gazeta, intervista, televizione, para dhe pas shpine, në zyrat dhe korridoret e Akademisë dhe më tej. Më fyenin kur ua propozoja si të vetmen alternativë. Disa inatçinj vazhdojnë të më fyejnë, kurse presionet e përditshme nuk pushojnë as sot, natën dhe ditën. Por, nuk ka rëndësi deformimi, rëndësi ka reformimi! Por ka mbetur në mes të udhës reforma në këto plane:

**1.** Reforma e analizës së deritanishme të punës së Akademisë dhe e rezultateve të kërkimit shkencor të çdo akademiku dhe e agjencisë në përgjithësi. Ende nuk ka një vështrim kritik të punës nga ana e kryesisë së mbetur apo e këshillit ekzekutiv për ecurinë e punës në këto vite, si edhe për pranimet pa kriter të akademikëve apo edhe për organizimin e zgjedhjeve të fundit-farsë? Pa u bërë ky katarsis, besoj Akademia nuk do të vendoset dot në shina.

**2.** Reforma lidhet me auditimin e përdorimit të fondeve deri tani, sepse nuk mund të kërkosh fonde të tjera, pa parë me hollësi si janë përdorur të vjetrat, çfarë rezultatesh kanë dhënë ato? Auditim jo thjesht si inventar, por i performancës të fondeve të marra. U bënë vite që e kërkoj, ia kam kërkuar edhe zonjës ministre publikisht para tri vitesh, por asnjë përgjigje nuk kam marrë. Cili është rentabiliteti i përdorimit të fondeve, kur asnjë agjenci nuk i mat ato, kur botimet janë pa oponenca, pa komitet botimi, pa përkthime në gjuhë të huaj, pa redaksi?

**3.** Reforma e personelit. Cili është potenciali real në funksion të moshës, të statusit profesional, të vendbanimit, të akademikut? A mundet që personeli i Akademisë të mos ketë as gradën doktor? A duhet akademiku të jetë edhe një burokrat, pra një punonjës administrate? A nuk i duhen nëpër seksione Akademisë së Shkencave doktorë të rinj, plot vullnet dhe pasion në shërbim të akademikëve që punojnë sipas një strategjie të caktuar?

**4.** Reforma e statusit të akademikut dhe e pranimeve të reja. A është akademiku vetëm përfaqësues i punës së tij, apo duhet të konsiderohet si përfaqësues i fushës të shkencëtarëve brenda së cilës punon dhe të rekrutohet me mbështetjen e tyre? Pse nuk ka pranime mbi bazën e oponencave dhe paraqitjeve të arritjes të fushës? Pse ka pasur frikë Akademia të bëjë thirrje të hapur për anëtarësim? Përse nuk ka marrë gjykimin dhe aprovimin institucional të agjencive kërkimore dhe universitare nga vijnë anëtarët e rinj?

Si është e mundur që nuk ka më asnjë dallim midis akademikëve dhe akademikëve të asociuar, si rezultat i presionin për honorarët?

A do të dalin akademikët në pension në moshën e të gjithë profesorëve të tjerë? Po të rinjtë, a nuk duhet të jenë detyrimisht nën moshën 60 vjeç kur hyjnë në Akademi? Se përndryshe Akademia do të bëhet vend oazi para pensionit!

**5.** Reforma e matjes së punës shkencore dhe e rezultateve të saj. A mund të matet puna shkencore vetëm me botimet, edhe ato pa performancën e duhur dhe pa recencën e duhur? Ku i ka Akademia e Shkencave kriteret e performancës të punës shkencore? Apo në botime pa komitet shkencor, pa oponenca nga jashtë vendit dhe Akademisë?

**6.** Reforma e shpërndarjes të fushave, e hapjeve të fushave të reja, si edhe a vlen që Akademia e Shkencave të ndahet në seksione, sipas fushave, logjikë që na vjen që nga pozitivizmi klasik i shekullit të 19, apo duhet organizuar sipas funksionaliteteve ndërdisiplinore?

**7.** Reforma e marrëdhënieve të Akademisë të Shkencave me shoqërinë. A duhet edhe të përfshijë inovacionin? Si të mos bashkëpunojë edhe kërkimin shkencor universitar? Pse Akademia fondet e veta për botim librash nuk i propozon për kontribute bibliografike të të gjithë komunitetit? Sa libra u shitën në panair? Perse projektet i ka mbajtur për veten e vet, pa i shpallur me konkurs të hapur publik?

**8.** Reforma e legjitimitetit. Kush e përfaqëson tani Akademinë? Komisioni i reformës, këshilli ekzekutiv, seksionet?

DPSHTRR: Detyrimet që fshihen, si të kryeni verifikimin nga targat

# Amnistia për makinat, afati deri në 31 dhjetor

## Janë 140 mijë automjete që përftojnë nga falja

Ornela Manjani

Drejtoria e Shërbimet të Transportit Rrugor ju kujton drejtuesve të mjeteve që kanë detyrime të pashlyera se kanë afat deri në 31 dhjetor për të përfituar nga amnistia. Zbatimi i ligjit "Për pagesën dhe fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore", ka hyrë në një fazë të rëndësishme. Kështu thotë në një njoftim të fundit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, ku thekson se procedurat mund të ndiqen deri më datë 31 dhjetor 2017. "Brenda datës 31.12.2017, njoftohen të gjithë qytetarët që të përfitojnë nga procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka publikuar dhe azhurnuar listën e mjeteve objekt i ligjit 33/2017, ku të gjithë personat e interesuar mund të bëjnë verifikimin e targës dhe karakteristikave të tjera të mjetit në këtë listë. Subjektet/personat përgjegjës të paraqiten pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor për të kryer pa pagesë, veprimet e heqjes nga qarkullimi të mjetit apo për të kërkuar moskryerjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi dhe mbajtjen aktiv të tij.

### FSHIRJA E DETYRIMEVE

Subjektet që duan të mbajnë mjetin në qarkullim u fshihen detyrimet tatimore për periudhat dhjetor 2010 e më parë, me kusht që të paguajnë detyrimet për periudhën janar 2011 e në vijim, me përjashtim të gjobave për mospagesë së taksave të periudhës janar 2011 deri në dhjetor 2014, të cilat fshihen/shuhen me kushtin e pagesës së të gjitha detyrimeve të plota", thuhet në njoftim DPSHTRR.

## TARGAT E MJETEVE QË KANË DETYRIME TË PASHLYERA

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **TARGA** | TR3341J | TR3391U | TR3447E | TR3494D | TR3543I | TR3590T | TR3630M | TR3675H | TR3720H | TR3765U | TR3822F |
| TR3290F | TR3342I | TR3394J | TR3447I | TR3495J | TR3543S | TR3591F | TR3631C | TR3675U | TR3720M | TR3768A | TR3822G |
| TR3290G | TR3342J | TR3395H | TR3447M | TR3495L | TR3545F | TR3591H | TR3631N | TR3676I | TR3722L | TR3768F | TR3822J |
| TR3290J | TR3342M | TR3395S | TR3448M | TR3496G | TR3545J | TR3591N | TR3632F | TR3677I | TR3722M | TR3769F | TR3822N |
| TR3290N | TR3342N | TR3396E | TR3449K | TR3496N | TR3545L | TR3591T | TR3632G | TR3678F | TR3722S | TR3769M | TR3823F |
| TR3291E | TR3343F | TR3396F | TR3449N | TR3497F | TR3545S | TR3592B | TR3632L | TR3678J | TR3723J | TR376D | TR3823J |
| TR3291F | TR3343G | TR3396J | TR344D | TR3497R | TR3546R | TR3592E | TR3632N | TR3678L | TR3723L | TR376F | TR3823U |
| TR3291K | TR3344A | TR3396L | TR344F | TR3498I | TR3546S | TR3592H | TR3632T | TR3679E | TR3724T | TR376H | TR3824G |
| TR3291L | TR3344F | TR3397J | TR3450G | TR3499I | TR3546T | TR3592I | TR3633A | TR3679I | TR3725F | TR3770F | TR3825G |
| TR3292F | TR3345F | TR3397S | TR3450H | TR3499P | TR3547G | TR3592J | TR3634B | TR3679K | TR3725J | TR3770K | TR3825U |
| TR3292I | TR3345I | TR3398B | TR3451J | TR349C | TR3547I | TR3592L | TR3634F | TR3679P | TR3725L | TR3771H | TR3826T |
| TR3292M | TR3346G | TR3398F | TR3451S | TR349E | TR3548D | TR3592P | TR3634J | TR367H | TR3725R | TR3771J | TR3827M |
| TR3292P | TR3346J | TR3398S | TR3452G | TR3500E | TR3549C | TR3593B | TR3634R | TR3681E | TR3725U | TR3771M | TR3828J |
| TR3293J | TR3346N | TR3399H | TR3452I | TR3500J | TR3549M | TR3593F | TR3635H | TR3681I | TR3726H | TR3772A | TR3829E |
| TR3293P | TR3347G | TR3399U | TR3453J | TR3500S | TR354D | TR3593H | TR3635U | TR3682F | TR3726K | TR3772D | TR3829J |
| TR3295F | TR3347P | TR339D | TR3454F | TR3501H | TR3550D | TR3593M | TR3636G | TR3682N | TR3726P | TR3773F | TR3829U |
| TR3295S | TR3348D | TR339F | TR3454G | TR3501J | TR3550L | TR3594C | TR3636H | TR3682P | TR3727M | TR3773L | TR382E |
| TR3296I | TR3348H | TR3400I | TR3454K | TR3501M | TR3550M | TR3594F | TR3637H | TR3683E | TR3728D | TR3774E | TR382F |
| TR3297H | TR3348I | TR3400K | TR3454M | TR3501N | TR3550U | TR3594G | TR3637M | TR3683I | TR3728F | TR3774P | TR3830E |
| TR3297J | TR3348L | TR3401E | TR3455J | TR3502K | TR3551J | TR3594J | TR3638C | TR3684H | TR3728S | TR3775H | TR3830M |
| TR3297M | TR3349G | TR3401T | TR3456J | TR3504F | TR3552J | TR3595D | TR3638M | TR3684K | TR372BTX | TR3775I | TR3831E |
| TR3297S | TR3349K | TR3402F | TR3456S | TR3504G | TR3552L | TR3595H | TR3638U | TR3684P | TR372E | TR3775N | TR3831I |
| TR3298G | TR3349L | TR3402G | TR3457I | TR3505J | TR3553L | TR3595J | TR3639D | TR3685H | TR372G | TR3776L | TR3831M |
| TR3299L | TR3349M | TR3402H | TR3457J | TR3505N | TR3553U | TR3595K | TR3639H | TR3685S | TR372H | TR3776S | TR3831N |
| TR329C | TR334E | TR3402I | TR3457K | TR3506B | TR3554F | TR3596C | TR3639I | TR3687B | TR3730B | TR3778F | TR3831S |
| TR329D | TR3350G | TR3402J | TR3459I | TR3506I | TR3554J | TR3596G | TR3639L | TR3687F | TR3730I | TR3778I | TR3832P |
| TR329G | TR3350I | TR3402M | TR345D | TR3508G | TR3555P | TR3596T | TR363D | TR3688I | TR3730P | TR3779T | TR3833P |
| TR3300G | TR3350S | TR3402P | TR3460C | TR3508H | TR3556I | TR3597F | TR363E | TR3689I | TR3730R | TR377E | TR3834F |
| TR3300U | TR3351I | TR3403F | TR3460E | TR3508I | TR3556J | TR3597H | TR363F | TR3689P | TR3731H | TR3780F | TR3834H |
| TR3301D | TR3351N | TR3403I | TR3460I | TR3509T | TR3556N | TR3597I | TR363H | TR368B | TR3732H | TR3781M | TR3834J |
| TR3302A | TR3352H | TR3404J | TR3460R | TR350D | TR3558T | TR3597N | TR3640I | TR368E | TR3732I | TR3783K | TR3834M |
| TR3303S | TR3353I | TR3404M | TR3461B | TR3510I | TR3559K | TR3598G | TR3640L | TR3690B | TR3732J | TR3783L | TR3834P |
| TR3304L | TR3353J | TR3405I | TR3461E | TR3512H | TR3559T | TR3599F | TR3640S | TR3690F | TR3733I | TR3784K | TR3835M |
| TR3304S | TR3355K | TR3405K | TR3462D | TR3512J | TR355D | TR3599G | TR3641B | TR3690K | TR3734H | TR3784N | TR3835S |
| TR3305I | TR3355L | TR3405P | TR3462L | TR3512M | TR355F | TR3599U | TR3641E | TR3691J | TR3734U | TR3785E | TR3836A |
| TR3306G | TR3355U | TR3406I | TR3463M | TR3512U | TR3561H | TR359D | TR3641G | TR3691L | TR3735D | TR3785G | TR3836B |
| TR3307J | TR3356I | TR3407F | TR3463P | TR3513G | TR3562G | TR359E | TR3641J | TR3691M | TR3735H | TR3785J | TR3836R |
| TR3307L | TR3356L | TR3407M | TR3464I | TR3513U | TR3562T | TR359F | TR3642E | TR3692G | TR3735J | TR3785L | TR3837F |
| TR3307R | TR3357L | TR3407S | TR3464J | TR3514N | TR3563K | TR3600K | TR3642J | TR3692I | TR3735U | TR3786D | TR3837I |
| TR3308F | TR3357N | TR3407U | TR3464K | TR3514T | TR3563M | TR3601G | TR3643C | TR3692M | TR3736F | TR3786I | TR3837J |
| TR3308J | TR3357S | TR3408E | TR3464S | TR3514U | TR3564J | TR3603J | TR3644F | TR3693C | TR3737F | TR3786T | TR3837N |
| TR3309D | TR3359A | TR3409A | TR3465F | TR3515E | TR3564K | TR3603U | TR3645G | TR3693F | TR3737N | TR3787M | TR3838F |
| TR3309I | TR3359N | TR3409F | TR3465M | TR3515L | TR3566F | TR3604I | TR3645J | TR3693I | TR3738A | TR3788P | TR3838M |
| TR3309J | TR335C | TR3409H | TR3465S | TR3515P | TR3566K | TR3604J | TR3645M | TR3693J | TR3738K | TR3789J | TR383G |
| TR3309K | TR335E | TR3410E | TR3466J | TR3516F | TR3567E | TR3606I | TR3646G | TR3694B | TR3738L | TR378F | TR3842J |
| TR3310J | TR335G | TR3411K | TR3466R | TR3516I | TR3567J | TR3606R | TR3646K | TR3694J | TR3738M | TR378G | TR3843C |
| TR3311H | TR3360P | TR3412L | TR3466S | TR3517D | TR3568F | TR3607G | TR3647H | TR3695F | TR3739R | TR3790F | TR3843G |
| TR3311K | TR3361I | TR3415E | TR3469R | TR3517L | TR3568P | TR3609G | TR3647J | TR3695J | TR373E | TR3791E | TR3843L |
| TR3311P | TR3361N | TR3415F | TR346E | TR3519F | TR3569J | TR3609M | TR3648S | TR3697J | TR373H | TR3792S | TR3844C |
| TR3312C | TR3362E | TR3416I | TR3470F | TR3519H | TR356D | TR3609S | TR3649I | TR3698G | TR3740D | TR3793F | TR3844N |
| TR3312J | TR3362H | TR3416L | TR3470G | TR3519J | TR356F | TR360D | TR364E | TR3699G | TR3740N | TR3793I | TR3844U |
| TR3312N | TR3362L | TR3416R | TR3470H | TR3519S | TR3570M | TR360F | TR364F | TR369C | TR3741D | TR3794K | TR3845F |
| TR3313S | TR3363K | TR3417C | TR3471G | TR351D | TR3570U | TR360H | TR364H | TR369H | TR3741I | TR3795B | TR3845K |
| TR3315J | TR3364D | TR3419F | TR3471R | TR351F | TR3571F | TR3610N | TR3650B | TR3700L | TR3741L | TR3795M | TR3846F |
| TR3315M | TR3364G | TR341E | TR3472I | TR351G | TR3571J | TR3611D | TR3650J | TR3701G | TR3743I | TR3795R | TR3846T |
| TR3316F | TR3365E | TR3420J | TR3472R | TR3520A | TR3572C | TR3612H | TR3650M | TR3701H | TR3743P | TR3796I | TR3847G |
| TR3317J | TR3365J | TR3421J | TR3473P | TR3520E | TR3572F | TR3612I | TR3650T | TR3701M | TR3744A | TR3796K | TR3848B |
| TR3317N | TR3366D | TR3422F | TR3474J | TR3520K | TR3572J | TR3612N | TR3651T | TR3701R | TR3744C | TR3797K | TR3848F |
| TR3317S | TR3367G | TR3422J | TR3475R | TR3521K | TR3572M | TR3612S | TR3652G | TR3702I | TR3744N | TR3798C | TR3848J |
| TR3318N | TR3367P | TR3422L | TR3476I | TR3521N | TR3573G | TR3612U | TR3652N | TR3703M | TR3746I | TR3798K | TR3848M |
| TR3318R | TR3368G | TR3423D | TR3476L | TR3524I | TR3575F | TR3613D | TR3653T | TR3704M | TR3746J | TR3799E | TR3849N |
| TR3318S | TR3368I | TR3423E | TR3476T | TR3525J | TR3575J | TR3613G | TR3654E | TR3706I | TR3747N | TR3799F | TR384B |
| TR3319M | TR3368J | TR3425J | TR3477H | TR3525K | TR3575L | TR3613I | TR3654I | TR3706J | TR3748E | TR379E | TR384D |
| TR3319S | TR3369K | TR3427L | TR3477N | TR3526H | TR3575M | TR3614A | TR3654J | TR3706P | TR3748G | TR379F | TR384E |
| TR331G | TR336D | TR3427U | TR3478J | TR3526M | TR3576F | TR3615L | TR3655I | TR3707F | TR3748T | TR379G | TR3851R |
| TR3320C | TR336G | TR3428J | TR3478L | TR3527J | TR3576H | TR3616D | TR3656H | TR3707I | TR3749J | TR3800D | TR3851U |
| TR3320D | TR3371K | TR3428L | TR3479I | TR3527T | TR3577F | TR3616I | TR3658H | TR3708H | TR374E | TR3800F | TR3852F |
| TR3321D | TR3372K | TR3429P | TR3479K | TR3528F | TR3577H | TR3616L | TR3658N | TR3708L | TR374H | TR3800H | TR3852J |
| TR3323F | TR3372L | TR342E | TR347F | TR3529G | TR3578E | TR3617I | TR3658P | TR3709B | TR3750T | TR3800J | TR3852P |
| TR3323L | TR3373I | TR342F | TR3480F | TR3529K | TR3578F | TR3617J | TR3659D | TR3709F | TR3751J | TR3801J | TR3853E |
| TR3323M | TR3374F | TR342H | TR3480J | TR352D | TR3578L | TR3618E | TR3659L | TR3709G | TR3751M | TR3802F | TR3853J |
| TR3324E | TR3374I | TR3430F | TR3480K | TR352H | TR3578M | TR3618R | TR365D | TR3709I | TR3753F | TR3803L | TR3854E |
| TR3324H | TR3374K | TR3431E | TR3481G | TR3530G | TR3579E | TR3619B | TR3660E | TR3709J | TR3753I | TR3805C | TR3854J |
| TR3327H | TR3375M | TR3431F | TR3481I | TR3530H | TR3579F | TR3619K | TR3661R | TR370D | TR3754I | TR3805E | TR3854L |
| TR3327I | TR3376F | TR3431H | TR3481J | TR3530J | TR3579R | TR3619L | TR3662F | TR370G | TR3754M | TR3805F | TR3854U |
| TR3327M | TR3376J | TR3432A | TR3481R | TR3531G | TR357E | TR361E | TR3662G | TR3710E | TR3755H | TR3805H | TR3856G |
| TR3328G | TR3376L | TR3432R | TR3482K | TR3531J | TR357F | TR361F | TR3662I | TR3710F | TR3756H | TR3806A | TR3856K |
| TR3328H | TR3377F | TR3433I | TR3482M | TR3531K | TR3580D | TR361G | TR3663N | TR3710K | TR3756I | TR3806R | TR3856L |
| TR3328I | TR3377I | TR3434H | TR3483I | TR3532J | TR3580J | TR361H | TR3664F | TR3711N | TR3756J | TR3808I | TR3856P |
| TR3328L | TR3378D | TR3434K | TR3484C | TR3532M | TR3581F | TR3620J | TR3666I | TR3711T | TR3756N | TR380D | TR3857J |
| TR3329D | TR3378J | TR3434L | TR3484I | TR3533B | TR3581J | TR3621A | TR3666N | TR3712B | TR3757E | TR3810B | TR3857L |
| TR3329L | TR3378R | TR3435J | TR3484L | TR3533G | TR3581K | TR3621G | TR3667F | TR3712C | TR3757H | TR3810E | TR3857P |
| TR332D | TR3379N | TR3435M | TR3485L | TR3533H | TR3583G | TR3621N | TR3667J | TR3712F | TR3757J | TR3810I | TR3858K |
| TR3330N | TR337C | TR3436A | TR3485P | TR3535D | TR3583I | TR3621T | TR3667M | TR3712L | TR3757P | TR3811E | TR3858S |
| TR3330S | TR337E | TR3437R | TR3485R | TR3536D | TR3583L | TR3622G | TR3667U | TR3712T | TR3758F | TR3811R | TR3858U |
| TR3330U | TR337G | TR3438J | TR3486N | TR3536P | TR3583N | TR3622I | TR3668G | TR3713I | TR3758R | TR3812F | TR3859B |
| TR3332I | TR3381F | TR3438L | TR3487J | TR3537E | TR3583P | TR3622J | TR3668H | TR3714H | TR3758S | TR3813A | TR3859L |
| TR3333K | TR3382T | TR3438M | TR3488J | TR3537H | TR3584P | TR3623I | TR3668M | TR3715E | TR375D | TR3814J | TR385D |
| TR3334G | TR3383F | TR3439I | TR3489G | TR3537I | TR3585F | TR3624E | TR3669F | TR3715I | TR375H | TR3815T | TR385G |
| TR3334J | TR3383N | TR343CTX | TR3489I | TR3537J | TR3585K | TR3624F | TR3669I | TR3715U | TR3760G | TR3816G | TR3860F |
| TR3335G | TR3384L | TR343D | TR3489L | TR3538E | TR3586B | TR3624I | TR3669T | TR3716F | TR3760P | TR3817C | TR3860J |
| TR3335I | TR3385F | TR3440H | TR348E | TR3539A | TR3586S | TR3624N | TR366D | TR3716I | TR3760R | TR3817E | TR3861H |
| TR3335L | TR3385H | TR3441C | TR348F | TR3539F | TR3587I | TR3627H | TR3670P | TR3716J | TR3761B | TR3818I | TR3861L |
| TR3335R | TR3385I | TR3441P | TR3490F | TR3539K | TR3587K | TR3627U | TR3670T | TR3717L | TR3761E | TR3819G | TR3861S |
| TR3336K | TR3387I | TR3442F | TR3490G | TR353H | TR3587S | TR3628E | TR3671I | TR3717N | TR3761F | TR3819N | TR3862N |
| TR3337H | TR3388E | TR3442M | TR3490I | TR3540I | TR3588I | TR3629K | TR3671J | TR3717T | TR3761G | TR381D | TR3864F |
| TR3338I | TR3389M | TR3442S | TR3491L | TR3540J | TR3589J | TR362E | TR3673D | TR3718E | TR3762J | TR381F | TR3864K |
| TR3338L | TR338D | TR3443C | TR3491M | TR3540K | TR3589M | TR362G | TR3673J | TR3718I | TR3762U | TR381G | TR3864S |
| TR3339B | TR338E | TR3443I | TR3492L | TR3542K | TR358D | TR3630H | TR3674J | TR3718T | TR3763P | TR3820J | TR3865I |
| TR3340N | TR3390I | TR3443L | TR3493F | TR3543F | TR358E | TR3630I | TR3674K | TR3719H | TR3764L | TR3821B | TR3866H |
| TR3341H | TR3390P | TR3444C | TR3493H | TR3543H | TR358F | TR3630K | TR3674R | TR3719I | TR3764R | TR3821K | TR3867R |

Opinioni i Ditës

# "Kukulla" e Kadaresë, një roman që lexohet me një frymë

Sulejman Mato

Romanin më të ri të shkrimtarit I. Kadare, "Kukulla", e kam pritur me padurim, ashtu si çdo vepër të këtij shkrimtari, krijimtaria e të cilit ka disa dekada që i ka kapërcyer kufijtë e Shqipërisë. Kjo gjë ka ndodhur me mua, qysh me "Ëndërrimet" (viti 1957) e gjer te ky roman i ri "Kukulla" (viti 2017). Ka gjashtëdhjetë vjet që Kadare nuk resht së sjelli një krijimtari unike për nga vlerat dhe unë kam gjashtëdhjetë vjet që i pres veprat e tij si të jetë një festë, nuk i lexoj, i përpij. Ka ndodhur që të blej një roman në librari dhe ta nis leximin qysh te stenda, pa u dhënë rëndësi personave që më shohin me çudi.

Kjo gjë ka ndodhur fillimisht dhe me librin poetik "Shekulli im" ( 1959) i cili i theu të gjitha klishetë e poezisë së kohës. Kjo gjë ndodh sot, pas 60 vjetëve, me romanin e tij të fundit "Kukulla". Tani që po hedh në letër këto shënime për këtë roman të mrekullueshëm, mendoj ftohtësisht se çfarë sekreti duhet të ketë një shkrimtar i vërtetë që të rrëmben qysh në faqen e parë dhe të detyron ta lexosh me një frymë. Kjo ndodh pasi, përveç stilit të tij brilant të rrëfimit, shkrimtari di të prekë subjekte intriguese dhe tema të rëndësishme për njeriun dhe kombin.

Tema e romanit është tejet e thjeshtë dhe tejet personale. Sipas E. Muir. "Mendimet dhe ndjenjat e thjeshta nuk janë asnjëherë të thjeshta".




Mënyra se si fillon romani, me një lajm të keq, që të mban qysh në fillim në suspansë. Në kapitullin vijues, autori i thyen të gjitha rregullat e rrëfimit, duke kaluar në një kohë para-Kadare, te fejesa e një vajze të familjes së njohur të Dobajve. Më pas ngjarjet zhvillohen në familjen Kadare, për të cilën kushdo që ka lexuar veprat e shumta të Kadaresë, do të ishte kureshtar të dinte diçka më shumë, mirëpo, autori dhe këtu jep aq sa duhet dhe aq sa duhet thënë, duke sjellë dhe ca imtësi tejet origjinale, të cilat vetëm një shkrimtar i vërtetë mund t'i konstatojë. Them me bindje se një roman të tillë të tipit "biografi familjare", mund ta shkruante vetëm një shkrimtar me përvojë të gjatë si I.Kadare, duke nxjerrë "nga thesi i kujtimeve" ca imtësi që përbëjnë sekretin e letërsisë së vërtetë. Unë e kam kaluar fëmijërinë në sokakët e Gjirokastrës, shtëpinë e kemi pasur pranë Dobajve. Në oborrin e Dobajve loznim me Rexhepin. Më kujtohet se si aneja e Rexhepit na ndiqte pas me fetat e bukës, lyer me marmaladë. Pra, unë, lexues dhe dëshmitar njëkohësisht i atyre mjediseve dhe personazheve të një kohe të largët, sigurisht do ta shijoja dhe më shumë "Kukullën" e Dobajve dhe çastin kur ajo niset në shtëpinë e madhe të Kadareve. Magjia e penës së Kadaresë më gjallëroi pamjet e viteve pesëdhjetë, Qafën e Pazarit, portën e madhe të shtëpisë së doktor Vasilit, shkollën "Drita", gjimnazin "Asim Zeneli", shtëpinë e rrënuar e Hoxhatëvë, shtëpinë aristokrate e Kokalarëve, gjer te legjendari "Sokak i të marrëve", i njohur në të gjithë botën prej romanit të Kadaresë "Kronikë në gur".

"Çdo autor nxjerr ujë nga pusi i vet", - thotë shkrimtari Milan Kundera. 'Pusi' i Ismailit është Gjirokastra. Kadare ka kohë që hedh 'kovat' në atë 'pus' të thellë me ujë qelibar. Hidh 'kovën' e nxirr nga një roman. Kujtimet e mia përzihen me kujtimet e autorit, pasi autori jo vetëm në këtë roman, por edhe në romanet e tjera si "Qyteti pa reklama", "Kronikë në Gur", "Çështje të marrëzisë", "Darka e gabuar" etj. përshkruan episode, personazhe, rrugë, zakone dhe mjedise nga qyteti i gurtë, por nuk shkruan kujtime, ai na shfaq artistikisht shkumën e kujtimeve. Dhe në këtë roman të ri, autori edhe pse më së fundi i afrohet me dinjitet përshkrimit surealist të nënës së tij, nuk ka ndërmend të sajojë një nënë kukull, as të trillojë ngjarje befasuese, as të fantazojë një qytet të pa qenë. Ajo është Gjirokastra, me personazhet e saj realë, me rrugët e saj reale, me zakonet, bisedat, legjendat, tipat realë. Ky realitet jo i shpikur, ose me pak shpikje, futet me guxim në letërsi dhe me një siguri të papërballueshme, duke i thënë jo vetëm lexuesit që i njeh mirë ato ambiente, por edhe lexuesit tjetër, të madh, se kjo është nëna e tij reale, ky është qyteti ku u rrit ajo dhe ai, dhe kjo është letërsia.

Lexon romanin dhe vëren me kënaqësi se është po ai stil psikologjik i të treguarit, është po ajo letërsi që I.Kadare ka dhe te romanet e tjerë… Një realizëm i thellë, përzier me pak magji trillimi.

Kështu nisi "Kronika"…, "Gjenerali". Kështu nisi edhe "Dasma", e cila fillimisht u quajt nga Ll.Siliqi në diskutimin e tij të gjatë "himn për klasën punëtore". "Problemi që një shkrimtar kërkon të zgjidhë në punën e tij është një problem që u takon të gjithëve", - thotë J.P.Sartre.

Atëherë unë jetoja në Berat, arsimtar. Fati im që ishte edhe Ismaili në Berat dhe munda ta ndjek me kujdes jetën e tij dhe krijimtarinë e tij. Të prekje një temë të tillë aq aktuale, të futje në letërsi për herë të parë klasën punëtore, aksionet, rindërtimin e hekurudhave; të kapje temën e ditës ishte një risi që nuk mund ta bënte kushdo. Duhet të shqetësoheshe vërtetë për fatet e vendit tënd, që të shkruaje "Dimrin e vetmisë së madhe", duke futur personazhe dhe njerëz realë, ngjarje reale, madje si personazh dhe E.Hoxhën, një gjë tepër e frikshme dhe e guximshme në ato vite… "Eksperimentimi që nuk thellohet në problemet themelore të shoqërisë sjell rënie të publikut", thotë nobelisti Pessoa. Kjo gjë nuk ka ndodhur me poezitë e Kadaresë si "Fillrojtësi". "Njeriu me shat", "Mësueset e fshatit", ku thyheshin klishetë e një poezie të vjetruar, duke futur me guxim heronj të gjallë dhe temat e kohës. Kjo gjë ka ndodhur me 20 romanet e tij, gjer sa erdhi tek ky roman intim, njerëzor, human tepër i veçantë, tepër i thjeshtë në stil, tepër muzikal në frazë, tepër poetik në ngjarjen që trajton.

Gjatë gjithë këtyre viteve romanet e I.Kadaresë i kam pritur me emocion dhe i kam lexuar me një frymë. Nuk kam shkruar për to. Kam heshtur? Po. Kam heshtur modestisht, siç hesht një mik për mikun, kur të tjerët e lavdërojnë në sy. Më janë dukur gjithmonë natyrale sukseset e tij. 'Është detyrë e kritikës', - thosha. Ndërkohë që vëreja rreth e rrotull që kritikë nuk kishte. Kritikët dhe studiuesit e letërsisë kishin nisur të vdisnin, njeri pas tjetrit. U desh ky libër, i lehtë si lehtësia e Kukullës, që hyri si një hije në familjen e madhe të Kadareve e që lindi tre fëmijë, më i madhi do të bëhej edhe më i madhi i letrave shqipe që unë të ulesha e të shkruaja. Por edhe autorit iu deshën tetëdhjetë vjet jetë kur të sigurohej nga Zoti se do të jetonte shumë gjatë, të ulej e të shkruante një libër si ky, për nënën dhe për jetën e vet. Nëna të tilla, të heshtura dhe të pa peshë në familjen e prindërve, por edhe pas lindjes së tre fëmijëve janë shumë të dhembshura. Ishte "Kukulla", ajo që kishte lindur atë, që më vonë do të quhej "gjeniu i letrave shqipe". Shkrimtari Kadare, pas krijimit të qindra personazheve realë e gjysmërealë, një ditë do të kujtohej se kishte harruar pa përmendur një grua që e priste pas dere. Ishte ajo, Shën Mëria e autorit, e cila u ngjante "maskave të teatrit japonez", apo heshtjes sublime të Mona Lizës. E lehtë si ajri, e rëndë si kujtimet… Priste që të futej në një libër. Ky roman s'mund të shkruhej më parë. Më pas, jo e jo. Mjeshtër në dhënien e atmosferës së kohës dhe nxjerrjen në dritë të disa imtësive, të cilat përbëjnë bërthamën e letërsisë. "Shkrimtari ruan artin e të gjeturit të fjalëve plot shkëlqim", - thoshte Sartre. Për një lexues serioz, Kadareja është një shkrimtar që duhet lexuar me laps në dorë për të kapur fjalë të humbura dhe të reja, shprehje filozofike, psikologjike dhe humoristike. Edhe pse në qendër të romanit autori vendos nënën, është një fëmijë inteligjent, që vëzhgon imtësitë e asaj familjeje. "Gjithçka në atë shtëpi ishte ndërtuar enkas për të ruajtur sa më gjatë ftohtësinë dhe moskuptimin", - shkruan autori për familjen e vet. Personazhet si Xhexheja, Izmini Kokobobo, gjyshja, Shahini, Helena janë personazhe reale. Në atë shtëpi të madhe, me mëri të fshehura duhet të ishe vërtet një qenie e heshtur "kukull" "me naivitetin e saj të papëlqyer" në kuptimin e një "përzierje bardhësore dhe gipsi, enigmë, si në ato maskat e teatrit japonez, për të përballuar denjësisht konfliktet e zgjatura përtej kufirit të tejzgjatjes".

Në këtë roman në pjesën e parë gjen atmosferën e një kohe kur edhe pse hynte një nuse e re në shtëpi, kyçet e dollapëve duhet t'i mbante nënëmadhja. Në pjesën e dytë, autori bën një truk tjetër. Historinë e nuses së vjetër të Kadareve e zëvendëson me historinë e nuses së re të Kadareve, shoqja jone e kursit, shkrimtarja e njohur, Helena Gusho. Edhe pse në pjesën e dytë të romanit ka më shumë jetë dhe atmosferë tiranase, unë do të doja të dija diçka më shumë për "Kukullën". Biseda e fundit me të ishte një çast para nisjes së familjes Kadare në Paris. Ajo i kishte bërë një pyetje të çuditshme, të cilën duhet ta kishte menduar gjatë: "Francez je tani?", një pyetje e cila sado për të qeshur të ishte, më pëlqeu shumë. Mund ta kisha bërë edhe unë.

Do të doja të shkruaja edhe më gjatë për këtë roman të ri kaq mbresëlënës dhe për ta ilustruar më konkretisht me thënie të spikatura, me figura dhe shprehje inteligjence dhe humori, njëkohësisht, duke treguar edhe një farë pendese për atë që unë për vite me radhë, edhe pse i kam lexuar me padurim të gjitha veprat e Kadaresë, nuk kam shkruar asnjë fjalë në shtyp, mirëpo, çfarë t'u themi botuesve tanë që kanë filluar t'u vënë limite shkrimeve tona. Një arsye tjetër është edhe përshtypja e keqe e disa "titullarëve të letrave shqipe", të cilët ashtu si unë, gjatë gjithë këtyre viteve kanë treguar një heshtje fyese ndaj krijimtarisë së Kadaresë. Mund të kenë pasur arsye. Si për shembull: "Ismaili i arriti të gjitha ato që donte edhe në sajë të ndihmës së shtetit", ose "Ismaili nuk ka bërë asgjë për mbrojtjen e Lidhjes se Shkrimtarëve dhe Artistëve, "Se po të donte ai dhe Dritëroi…", ose "Ismaili dhe Dritëroi pas krijimit të kultit të vet, nuk bënë asgjë për të tjerët". Mund të jenë të pranueshme të gjitha, mirëpo unë që s'kam pasur kurrë ndonjëherë xhelozi për të tjerët, arsyetoj me mendje të qetë. Të krijojmë veprën tonë. Të bëjmë atë që bëri Ismaili, që bëri dikur Jeronimi, Migjeni, Noli, Mjeda etj.. "Një shkrimtar - thotë diku Ismaili - lë lëkurën si gjarpri". Kadareja e krijoi veprën e vet. Sikur ta bënte çdo shkrimtar këtë gjë, Shqipëria do të kishte edhe shumë shkrimtarë të njohur në botë.

RECENSION

# Agron Alibali, "Faik Konica, dritëhijet e një diplomati"

Prof. dr Aleks Luarasi*

*(Vijon nga faqja e parë)*

... letërsisë biografike dhe dokumentare. Konfirmim i këtij suksesi ishte edhe çmimi i fituar në panairin e librit "Tirana 2017", që u zhvillua gjatë muajit nëntor të këtij viti.

Faik Konica është një nga personalitetet madhore të Rilindjes sonë Kombëtare, të pavarësisë dhe të shtetit shqiptar, deri në pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, me kontribute të shumanshme si politikan, shkrimtar, publicist, diplomat etj. Si e tillë, figura e F. Konicës ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e studiuesve për të ndriçuar pamje të ndryshme të këtij personaliteti poliedrik dhe historik.

Punimi i studiuesit Agron Alibali hedh dritë në mënyrë të veçantë mbi veprimtarinë diplomatike të F. Konicës, si i dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë i Shqipërisë në SHBA nga v. 1926 deri në 1939, por nuk kufizohet vetëm me kaq.

Veprimtaria diplomatike e personazhit kryesor krijon lidhje pune me qeverinë shqiptare të kryesuar nga A.Zogu, si president deri në vitin 1928 dhe monark deri në vitin 1939, me dikasteret e ndryshme të kësaj qeverie, veçanërisht me MPJ, me autoritetet shtetërore të SHBA dhe me trupin diplomatik të akredituar në atë vend.

Punimi përmban një galeri të tërë personazhesh nga radhët e diasporës në Federatën Panshqiptare "Vatra", pasqyron mosmarrëveshjet midis përkrahësve të qeverisë së A. Zogut dhe kundërshtarëve të saj fanolistë, kontradiktat e F. Konicës me Fan.S.Nolin, kur ai endej në Evropë dhe shkruante poezinë "Anës lumenjve", si dhe me vonë, kur u rikthye në SHBA.

Vepra është rezultat i një pune kërkimore shumë të gjatë, i konsultimit me dokumente arkivore në Shqipëri, në SHBA, në disa vende të Evropës, si dhe me një literaturë shumë të pasur.

Gjatë kësaj pune kërkimore autori ka bërë të paktën dy gjetje të rëndësishme, sikurse është dosja e praktikës diplomatike në SHBA, zbuluar në arkivin e MPJ të Italisë, në bashkëpunim me prof. Pëllumb Xhufin, si dhe gjetja e një pjese të vogël të bibliotekës personale të F. Konicës, të cilën e solli dhe e dorëzoi në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë.

Për jetën dhe veprën e F. Konicës është shkruar gjerësisht në shtypin tonë letrar dhe shkencor, duke ndriçuar më shumë veprimtarinë e tij si shkrimtar dhe publicist dhe më pak atë si diplomat.

F.Konica shërbeu në SHBA rreth 13 vjet, nga v. 1926- 1939, pas rikthimit të A.Zogut në Shqipëri. Punimi i autorit e plotëson këtë boshllëk në mënyrë të kënaqshme dhe përbën një kontribut të rëndësishëm në fushën e historisë së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të historisë së shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri.

Kjo veprimtari diplomatike dhe juridike pasqyrohet në të gjithë punimin e autorit, por në mënyrë të veçantë gjen vend në pjesën e katërt me titullin "Zhvillime diplomatike - juridike" dhe në pjesën e shtatë, ku flitet për botëkuptimin kushtetues të F. Konicës.

1.F.Konica si diplomat ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis Shqipërisë dhe SHBA-ve në periudhën midis dy luftërave botërore, për njohjen e Shqipërisë dhe të shqiptarëve në këtë vend të largët.

Një nga arritjet e Konicës si ministër fuqiplotë ishte lidhja e disa traktateve dypalëshe midis Shqipërisë dhe SHBA, si Traktati i Natyralizimit, ai i Ekstradimit, i Arbitrimit etj.

F.Konica si diplomat ndikoi nga SHBA-të edhe në zhvillimin e marrëdhënieve me Italinë, që ishte një nga preferencat e A. Zogut.

F.Konica ka treguar vëmendje të ndryshme të shtetit iliro-shqiptar, që nga kohët e lashta si, Mbretëria e Bardhylit, deri në mesjete. Një vëmendje të veçantë i kushton shtetit autonom të Ali Pashë Tepelenës, përpjekjeve për pavarësi në periudhën e Rilindjes Kombëtare, qeverisë së I. Qemalit, të drejtës zakonore shqiptare, etj.

F.Konica hedh vështrimin te përvoja kontinentale dhe anglosaksone për të gjetur modelin më të mirë të legjislacionit shqiptar. Autori zbulon disa nga parimet themelore kushtetuese të F.Konicës, si parimi i lirisë dhe i demokracisë, të cilat duhet të jenë "feja dhe ideali i Shqipërisë moderne". Konica parashtron pikëpamjet e tij për sistemin e qeverisjes, për qeverisjen vendore dhe marrëdhëniet me pushtetin qendror.

Përvoja e gjatë në shërbimin diplomatik i jep mundësi Konicës të japë mendime dhe gjykime për të drejtën ndërkombëtare.



Njohja e shumë gjuhëve të huaja i jep mundësi të japë mendime dhe vlerësime të sakta për terminologjinë juridike në gjuhën shqipe.

Punimi i autorit Agron Alibali është shkruar në mënyrë tërheqëse, lexohet me kënaqësi dhe ka sharmin e një vepre letraro-artistike, ndonëse është një vepër e mirëfilltë shkencore. Kjo, për arsye se vepra ka një subjekt që zhvillohet nga faqja në faqe, ka personazhe reale, historike, përmban intrigë, dramë dhe fate njerëzish që gërshetohen me fatet e kombit.

Punimi është një shkrim i historisë sipas kritereve bashkëkohore; nuk ka paragjykime ideologjike, personazhe bardhe e zi, pozitive dhe negative; ka vetëm një kriter: pasqyrimin e realitetit me vërtetësi dhe në mënyrë objektive, aq sa flasin burimet historike; atje ku dokumenti hesht, hesht edhe autori.

Gjuha e autorit të këtij punimi është shqipja standarde dhe krejtësisht korrekte; ndonëse flitet për një veprimtari shtetërore dhe diplomatike, nuk ka asnjë shenjë të zyrtarizmit; përkundrazi ajo është një gjuhë e njomë, e pasur dhe një stil i këndshëm, plot figura artistike.

Kuptohet se personazhi kryesor i kësaj vepre është vetë F. Konica. Qysh nga titulli i punimit "Dritëhijet e një diplomati" lexuesi paralajmërohet për një personazh sa të kompletuar, aq edhe të komplikuar.

Dihet se F.Konica ka qenë një personalitet kompleks dhe kontrovers. Aristokrat i lindur nga origjina, jashtëzakonisht i aftë dhe i pajisur me një kulturë evropiane, zotëronte rreth 12 gjuhë të huaja, me një kontribut të shquar si rilindës, një nga themeluesit dhe drejtuesit e Federatës Panshqiptare "Vatra" dhe i gazetës "Dielli", diplomat i një vendi të vogël e të panjohur, i cili "vezullonte" në Uashington me sharmin dhe aftësitë e tij personale, sikurse shkruante shtypi i kohës në SHBA.

Në të njëjtën kohë, si diplomat ai ushtroi një lloj veprimtarie përçarëse te shqiptarët e Amerikës dhe e denoncoi Nolin padrejtësisht si "bolshevik" tek organet hetimore amerikane, pa ia kërkuar njeri.

F.Konica qysh në fillim e ngriti selinë e misionit diplomatik në një hotel të shtrenjtë në Uashington, vazhdimisht kërkonte të holla nga shteti shqiptar për të mbuluar shpenzimet e misionit, por edhe jetesën, sikurse ia kërkonte rangu prej diplomati dhe aristokrati, nuk e kishte fort për zemër kontrollin financiar mbi të ardhurat dhe shpenzimet e misionit, etj. Të gjitha këto teprime mund t'i quajmë trille të një aristokrati.

Sidoqoftë, në fund mund të dalë një pikëpyetje nga ana etike, bëri mirë apo bëri keq që pranoi detyrën e diplomatit në shërbim të A. Zogut, që e kishte pasur kundërshtar politik? Dihen vargjet e Nolit, që e dënonin këtë kompromis. Cili ishte motivi i vërtetë i F.Konicës, t'i shërbente shtetit shqiptar me aftësitë e tij të njohura, siguronte një jetesë dinjitoze në Uashington apo të dyja së bashku? Motivet nuk gjenden asnjëherë qartë në burimet historike, më shumë merren me mend dhe gjithmonë mbeten hipoteza.

Denoncimi i Nolit - përfshihet padyshim te "hijet" e tij. Për të tjerat mund të diskutohet.

Pranimi i detyrës së ambasadorit të Shqipërisë në SHBA mund të shihet si një shërbim ndaj Shqipërisë, jo ndaj kryetarit të shtetit, si një pranim i pikëpamjes mbi ambasadorët jo politike, një debat që bëhet edhe në ditët tona.

Nga fundi i jetës së F. Konicës, dy protagonistët e mëdhenj të historisë gjetën paqen ndërmjet tyre, bashkëpunuan për të mirën e Shqipërisë dhe janë së bashku në Panteon. Noli mbajti fjalimin e lamtumirës për F.Konicën në vitin 1942 dhe theksoi vetëm anët e ndritshme të tij.

gjithashtu për marrëdhëniet me Greqinë, për çështjen çame, si dhe për marrëdhëniet me shtetet e tjera.

Autori i punimit ndalet dhe analizon disa çështje konkrete të marrëdhënieve ndërkombëtare të kohës dhe i sheh zhvillimet e kësaj periudhe nëpërmjet veprimtarisë së përfaqësisë diplomatike në SHBA.

Misioni i F.Konicës në SHBA mori fund me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste. Pas kësaj, ai u rikthye në drejtimin e "Vatrës".

2. Një pjesë e rëndësishme dhe shumë interesante e punimit është ajo që i kushtohet botëkuptimit kushtetues të F.Konices, e cila trajtohet për herë të parë në shkencat historiko-juridike.

Në këto faqe të veprës e shohim F.Konicën si një nga ideologët e shtetit shqiptar. Kultura e gjerë e ndihmonte të orientohej në fusha jo aq të njohura për atë, sikurse ishin filozofia e së drejtës apo historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri. Mirëpo atje ku hynte, Konica do të shkëlqente patjetër.

Autori i punimit ndalet dhe ve në dukje gjykimet e mprehta e të sakta të F.Konicës për etapat e

Me këtë punim dinjitoz, autori Agron Alibali prezantohet si një kërkues shkencor i formuar plotësisht në fushën e shkencave historike dhe juridike. Vepra duhet lexuar për të shijuar nga afër e në mënyrë të plotë të gjitha vlerat e saj.

***Kryetar i Bordit të Administrimit të KU "LUARASI"***

## HOROSKOPI

### DASHI

Duke qenë se duhet të analizoni një situatë, duhet të merrni parasysh më shumë se një aspekt, nëse nuk doni të humbisni një gjë shumë të rëndësishme. Keni aftësi të shkëlqyera, por që nganjëherë mbeten në hije nga nxitimi juaj për të përfunduar çdo gjë.

### DEMI

Urani, Jupiteri dhe Saturni në harmoni me Hënën në shenjën tuaj do ju dhurojnë një ditë të paharrueshme, në të gjitha aspektet. Është e sigurt që nuk do mërziteni dhe do jeni gjithmonë në mes të aktiviteteve interesante dhe personave intrigues.

### BINJAKET

Mërkuri në lidhje me Plutonin mund t'ju shkaktojë reaksione të papritura të tepruara, edhe për motive banale dhe me pak rëndësi. Shkarkoni tensionin e krijuar duke u marrë me pak sport. Lodhja në nivel fizik do ju qetësojë në profilin mendor.

### GAFORJA

Falë Hënës në kënd me Saturnin, kjo ditë do jetë e përkryer për të kaluar kohë me të afërmit tuaj dhe miqtë. Nuk ka rëndësi nëse e kaloni në shtëpi apo jashtë. Vendime për t'u marrë? Falë sensit praktik, nuk do lini t'ju shpëtojë asnjë detaj.

### LUANI

Një çështje pune rrezikon t'ju prishë këtë ditë të qetë. Nëse nuk është aq urgjente, tregohuni të vendosur që ta mbani jashtë portës. Do ta zgjidhni nesër. Momente të këndshme të kaluara në familje dhe me miq do ju kthejnë humorin e mirë.

### VIRGJERESHA

Në sajë të Hënës në trekëndësh me Jupiterin, të tjerët do ju ndihmojnë në punët e shtëpisë, kështu që do arrini të keni pak kohë të lirë për vete. Jeni gjithmonë të gatshëm të ndihmoni të tjerët dhe asnjeri nuk do refuzojë t'ju japë një ndihmë të vogël, nëse ia kërkoni ju.

### PESHORJA

Nganjëherë nuk dini si të menaxhoni një lloj tendence që keni për t'u dekurajuar shpejt. U ktheheni mendimeve negative, që nuk kanë arsye të ekzistojnë. Përfitoni nga kjo ditë që të bëni një pushim nga të gjitha gjërat që ju rëndojnë pak.

### AKREPI

Falë mbështetjes së Marsit, në këtë periudhë mund të jepni maksimumin në sportin tuaj të preferuar. Aktiviteti fizik i moderuar është shumë i shëndetshëm, jeni shumë mirë. Ditë e gëzuar dhe kohë e lirë e çmuar, për t'ua përkushtuar të tjerëve, por sigurisht edhe pak vetes.

### SHIGJETARI

Do arrini më në fund të hidhni pas krahëve një çështje të së kaluarës që ju pengon të shihni përpara, sidomos në jetën private. Do ndjeheni shumë më mirë. Nuk jeni më të gatshëm të toleroni gjëra që nuk ju pëlqejnë dhe të tjerët do e kuptojnë vendosmërinë tuaj.

### BRICJAPI

Mos lejoni asgjë dhe asnjeri që t'ju shkatërrojë planet tuaja, edhe pse e keni planifikuar programin e ditës me shumë kujdes. Çdo detaj është i rëndësishëm dhe ju nuk ia keni lënë asgjë rastësisë.

### UJORI

Përpiquni të vendosni rregull në jetën tuaj, si në nivelin fizik, ashtu edhe në atë mendor, nëse nuk dëshironi të krijoni konfuzion, gjë që nuk ju pëlqen aspak. Përdorni kohën e lirë që ju dhuron kjo ditë për të organizuar më mirë hapësirën, ndoshta duke ndryshuar diçka.

### PESHQIT

Krijoni miqësi edhe kur gjendeni para opinioneve dhe pozicioneve të ndryshme. Këndi mes Hënës dhe Uranit do ju ndihmojë të zgjeroni rrethin e njohjeve. Në diversitetin natyral do zbuloni një tërësi që do arrijë t'ju pasurojë shumë.

Gilman Lika dhe Gocaj me penallti shënuan në të parën. Meto realizoi në pjesën e dytë

# Vllaznia fiton "derbin" e mbijetesës me Lushnjën

## Shkodranët triumfojnë 2-1 në "Loro Boriçi"

Jeton Selimi



| SUPERLIGA | | |
|---|---|---|
| **E PRAPAMBETUR** | | |
| Vllaznia - Lushnja | | 2-1 |
| **RENDITJA** | | |
| **Skuadra** | **N** | **P** |
| Skënderbeu | 11 | 27 |
| Flamurtari | 11 | 20 |
| Kukësi | 11 | 19 |
| Kamza | 11 | 17 |
| Laçi | 11 | 15 |
| Partizani | 11 | 14 |
| Teuta | 11 | 14 |
| Luftëtari | 11 | 9 |
| Vllaznia | 11 | 9 |
| Lushnja | 11 | 5 |

Vllaznia thyen Lushnjën në sfidën e pra pambetur të javës së 10-të dhe ka marrë tri pikë të arta në luftën e saj për mbijetesë. Shkodranët kanë shënuar dy herë në pjesën e parë për të futur në kasafortë rezultatin pas golit të Gilman Likës në minutën e 5-të, që shënon pas asistimit perfekt të Hasanit dhe penalltisë së shndërruar në gol nga Olsi Gocaj në minutën e 26-të. Në pjesën e dytë Lushnja e Hysen Dedjes do të përpiqet të ndryshojë diçka në fatet e këtij takimi, ndërsa goli i shkëlqyer i Agim Metos nga goditja e dënimit në minutën e 58-të duket se rikthen lagunarët në lojë, të cilët gjithsesi nuk do të arrijnë të bëjnë më shumë se kaq, duke koleksionuar në "Loro Boriçi" humbjen e tetë në këtë sezon, çka i lë në vend të fundit me 5 pikë. Vllaznia nga ana e saj ngjitet në kuotën e 9 pikëve, po aq sa Luftëtari.

**GJOKA**

Vllaznia ka arritur të fitojë ndeshjen delikate kundër Lushnjës, duke marrë pikë jetike ndaj vendit të fundit. Trajneri Ernest Gjoka për "Supersport" u shpreh shumë i lumtur për rezultatin e arritur në këtë takim, megjithëse shqetësohet nga shpërdorimi i rasteve të panumërta nga Vllaznia. "Kjo fitore ishte mjaft e rëndësishme për ne, pasi rikthehemi në 'Loro Boriçi' pas rreth 1 muaji mungesë, por edhe për shkak të rezultateve negative të koleksionuara kohët e fundit. Më vjen mirë që skuadra u impenjua dhe krijoi shumë, por duhet të punojmë që të mos e komplikojmë sfidën siç bëmë në ndeshjen e sotme (djeshme). Edhe sot (dje), ashtu si në takimet e fundit, krijuam shumë, por shfrytëzuam shumë pak. Duhet të përmirësohemi dhe të arrijmë të shënojmë gola si ekip, jo t'i presim nga individët zgjidhjet gjithmonë. Duam fitoren edhe me Luftëtarin, madje edhe në takimet në vijim, sepse duam të largojmë krizën. Hasanin e larguam sot (dje) për të mos e rrezikuar për sfidën ndaj gjirokastritëve, ndërsa besoj se edhe Gocaj do të jetë i gatshëm. Kemi një ngërç psikologjik, të cilin e treguam edhe sot me rastet e shpërdoruar, por besoj se nëse koleksionojmë 3-4 rezultate pozitive radhazi mund të dalim nga kjo situatë".

**DEDJA**

Lushnja humbi "derbin" e mbijetesës ndaj Vllaznisë në "Loro Boriçi" duke i komplikuar ndjeshëm pozitat. Trajneri i lagunarëve, Hysen Dedja, u shpreh i pakënaqur me repartin e mbrojtës, duke i cilësuar gabimet e tyre si amatoreske. Gjithsesi, shkodrani nuk dorëzohet dhe beson se skuadra mund t'ia dalë, pavarësisht rezultateve fundosëse në klasifikim, por më parë ai duhet të mbysë "lepurin" në barkun e futbollistëve. "Nuk e di ku ta gjej atë 'lepurin në bark' që kanë lojtarët dhe t'ua mbys. Kanë një mentalitet që na prish punë, kanë ndroje. Vllaznia në pjesën e dytë shpërdoroi shumë raste. E favorizoi rezultati i pjesës së parë. Në pjesën e dytë e ndryshova skemën duke kaluar me 3 sulmues dhe e dija që do të lija boshllëqe mbrapa, por gabimet që bënë mbrojtësit tanë ishin me të vërtetë amatoreske. Nëse barazonim me Sefën në pjesën e parë, mund ta ndryshim lojën. Ai goditi bukur me kokë, është lojtar i domosdoshëm për skuadrën tonë. Shansi nuk i deshi edhe sot, ashtu si me Flamurtarin. Me elementët që kemi në skuadër, ku kemi disa dëmtime, do të ecim përpara. Duhet shpërndarë energjia nga ndeshja në ndeshje. Vetëm Mone kthehet dhe duhet të përpiqemi me këta lojtarë ta përballojmë ndeshjen e radhës me Kamzën", u shpreh trajneri i Lushnjës.

DREJTORI SPORTIV



## Lacio ka prioritet rinovimin me Igli Taren

Tani nuk ka më asnjë dyshim se Igli Tare është një nga "magjistarët" më të spikatur të futbollit italian. Ish-sulmuesi i përfaqësueses shqiptare është kthyer në një nga drejtuesit sportivë më të vlerësuar në Itali për nuhatjen që ka në zbulimin e talenteve të reja dhe për "ofertat" që siguron në afrimin e tyre të klubi i Lacios. Përzgjedhjet e tij në vitet e fundit kanë kthyer skuadrën e kryeqytetit italian ndër më të mirat në Serinë A dhe sigurisht, një meritë shumë të madhe në këtë punë e ka edhe Tare, i cili ka afruar cilësi duke operuar me një buxhet shumë më të ulët se homologët e tij. Ndaj për klubin e Lacios, "blindimi" i drejtuesit sportiv shqiptar me një kontratë të re është kthyer në prioritetin e vitit 2018. Tare ka kontratë deri në verë me klubin e Lacios dhe palët pritet të ulen shumë shpejt të negociojnë për një marrëveshje të re. Presidenti Lotito kishte nuhatur që në fillim aftësitë e ish-sulmuesit, duke i besuar rolin e drejtorit sportiv dhe ai ka besim të verbër të aftësitë e Tare. Ndaj, dëshira për rinovim sigurisht që nuk mungon edhe për faktin se tani klubet e tjera italiane kanë filluar të hedhin sytë nga drejtuesi shqiptar. Sipas mediave përtej Adriatikut, Lotito do t'i bëjë një ofertë të re trevjeçare Tares, me një përmirësim të ndjeshëm të shifrave financiare që drejtuesi shqiptar do të përfitojë në vijim. Më pas, objektivi i klubit nuk do të jetë më afrimi me elitën e futbollit italian, siç ka qenë këto vite, por sigurimi i një bilete për Ligën e Kampioneve, që do të rriste edhe më shumë prestigjin e klubit dhe do të bënte më të lehtë punën e Tares.

Basrak, Herrera, Shahinas dhe Selvaxho

## Partizani nis operacionin “fshesa”, ikin 4 lojtarë







Te Partizani kanë nisur tashmë lëvizjet, që në një farë mënyre priteshin. Katër nga lojtarët e ardhur gjatë merkatos së verës kanë prishur me konsensus marrëveshjen me klubin e kuq dhe bëhet fjalë për ata që kanë pasur pak ose aspak hapësira deri tani, pasi nuk kanë paraqitur ndonjë nivel të kënaqshëm. Konkretisht, Shahinas, Selvaxhio, Herrera dhe Basrak nuk janë më pjesë e Partizanit. Kujtojmë që vetëm Basrak ka shënuar një gol me fanellën e Partizanit, atë të fitores në Shkodër ndaj Vllaznisë. Ja njoftimi i klubit të kuq në faqen e tij zyrtare: "Klubi falënderon lojtarët Romeo Shahinas, Andrea Selvagio, Eric Herrera dhe Milan Basrak për kontributin e dhënë me fanellën e Partizanit. Katër lojtarët e afruar përgjatë merkatos së verës kanë gjetur marrëveshjen me drejtuesit e klubit duke mbyllur përgjatë ditës së sotme me mirëkuptim aventurën me 15-të herë kampionët e vendit. Klubi u uron njëkohësisht lojtarëve të ndihen krenarë që kanë veshur fanellën e kuqe të Partizanit dhe suksese të mëtejshme në karrierën e tyre sportive".

SITUATA

## Dinamo Kiev udhëton me të rinjtë, lë 2 titullarë të tjerë në shtëpi

Skënderbeu mund të mos ketë mundësi tjetër më të mirë se kjo për të marrë një rezultat të rëndësishëm në Ligën e Europës, duke llogaritur se kundërshtari i radhës, Dinamo e Kievit, udhëton drejt Shqipërisë e mbushur me lojtarë nga ekipi i të rinjve, meqë e ka siguruar kualifikimin e mëtejshëm. Në orët e fundit para nisjes drejt Tiranës u bë e ditur se nuk do të udhëtoje për këtë sfidë as mbrojtësi kroat Domagoj Vida, si dhe as mesfushori ofensiv, Derlis Gonzalez. Bëhet fjalë për dy lojtarë të tjerë shumë cilësorë në këtë ekip, të cilit do t'i mungojnë për çështje dëmtimesh edhe emra si Mbokani, Kravets, Garmash, Bujalsi apo Sidorçuk, të gjithë titullarë në radhët e ekipit ukrainas. Për të zëvendësuar të gjithë këto mungesa, në listën prej 20 emrash të lojtarëve që kanë udhëtuar drejt Shqipërisë janë përfshirë edhe 5 futbollistë nga ekipi i të rinjve, disa prej të cilëve pritet të testohen në sfidën ndaj korçarëve. Trajneri Kaskeviç mendon se nuk do të ketë mundësi më të mirë se kjo për t'u dhënë pak eksperiencë ndërkombëtare.



CHAMPIONS I TË RINJVE



## Bazeli i Arjan Peços mposht Mançesterin dhe kualifikohet

Tekniku shqiptar, Arjan Peço ka arritur një sukses me ekipin e Bazelit në "UEFA Youth League". Klubi zviceran ka mundur të kalojë në fazën me eliminim direkt, pasi ka siguruar që në ditën e sotme kalimin nga grupet. Bazeli ka arritur të fitojë në një ndeshje mjaft të vështirë kundër Mançester Junajtid me rezultatin 2-1. Një fitore kjo, e cila vlen sa një kualifikim, pasi falë këtyre pikëve, trajneri shqiptar dhe Bazeli i tij nuk duhet të presin takimin e radhës për të mbyllur diskutimin e kualifikimit. Ekipi i Bazelit ka kaluar në fazën tjetër me 7 shqiptarë në organikën e tij. Bislimi, Pepsi, Lokaj, Rashiti, Ejupi, Isufi dhe Pukaj janë futbollistët me origjinë shqiptare të gjendur në ekipin e Bazelit. Madje, njëri prej tyre ka dhënë ndihmën e tij në fitoren 2-1 ndaj Mançester Junajtid. Goli i parë i kësaj ndeshje u ideua nga Lokaj për ta përfunduar në rrjetë më pas sulmuesi Pululu.

### PSG pëson gol në minutën e parë nga Sélltiku, më pas e bën goleadë

# Kualifikohen Barça e Çelsi, Atletiko mban gjallë shpresat

## Juventusit i duhet të fitojë në Athinë



Jeton Selimi

Barcelona ka marrë pikën që i nevojitej përballë Juventusit për të kaluar në turin tjetër të Ligës së Kampioneve duke siguruar njëkohësisht edhe vendin e parë në grup. Ekipi katalanas, ka zhvilluar një lojë si italianët, duke mos rrezikuar shumë për të marrë atë që i nevojitej. Në një ndeshje ku trajneri Valverde la Mesin në stol në fillim, skuadrat luajtën më hapur vetëm në 45 minutat e dyta, por asnjëra palë nuk arriti të dërgonte topin në rrjetë. Frika për të mos pësuar dhe komplikuar kualifikimin bëri që ndeshja të mbyllej pa gola, rezultat që u shkon për shtat katalanasve që blinduan vendin e parë në grupin e tyre. Italianëve tani u duhet një fitore në ndeshjen e fundit në Athinë. Kjo, për shkak se Sporting Lisbona mundi 3-1 Olimpiakos dhe është vetëm 1 pikë larg bardhezinjve në renditjen e grupit. Atletiko Madrid arriti një fitore të rëndësishme, 2-0 ndaj Romës, dhe tashmë shpreson për një biletë në turin tjetër të Championsit. Në sfidat e tjera, PSG arriti një fitore të thellë, 7-1 ndaj



Sélltik. Fitore shënuan edhe Bajerni i Mynihut, 1-2 ndaj Anderleht, si dhe Sportingu i Lisbonës, 3-1 ndaj Olimpiakosit të Pireut. Rezultat surprizë ishte fitorja e Bazelit, në minutat e fundit, 1-0 përballë Mançester Junajtid. Skuadra e Bazelit ka dhuruar një nga surprizat e mëdha të ditës së sotme në Champions duke fituar me rezultatin 1-0 ndaj Mançester Junajtid për të mbajtur ende të hapur Grupin A të Ligës së Kampioneve. Skuadra angleze, ku në minutat e fundit të sfidës u aktivizua edhe Zlatan Ibrahimoviç duke u kthyer pas shumë kohësh në turneun që nuk e ka fituar asnjëherë, u mundua të krijonte raste dhe të siguronte një fitore që do t'i priste biletën për turin tjetër dhe do ta kualifikonte si kryesuese grupi. Por në fund ishin zviceranët që festuan falë golit të Lang në minutën e 89 të duelit. Me këtë fitore, ekipi i Xhakës (mungoi për pezullim) dhe Ajetit, është në kuotën e 9 pikëve, po aq sa CSKA e Moskës, por me bilanc më të mirë dhe nëse fiton ndeshjen e fundit ndaj Benfikës, ka të sigurt kualifikimin e mëtejshëm.

**CHAMPIONS LEAGUE**

**TË MËRKURËN**

| | |
|---|---|
| **GRUPI A** | |
| CSKA Moskë - Benfika | 2-0 |
| Bazel- Mançester Junajtid | 1-0 |
| **GRUPI B** | |
| Anderleht - Bajern Mynih | 1-2 |
| Paris Sën Zhërmen-Sélltik | 7-1 |
| **GRUPI C** | |
| Karabag - Çelsi | 0-4 |
| Atletiko Madrid - Roma | 2-0 |
| **GRUPI D** | |
| Juventus - Barcelona | 0-0 |
| Sporting - Olimpiakos | 3-1 |

### Qeveria kërkon kontrollin e federatës

## Peruja rrezikon Botërorin, ka shpresë për Italinë



Kombëtarja peruane rrezikon pjesëmarrjen në botërorin "Rusi 2018". Lajmi është bërë i ditur nga një media vendëse, e cila evidenton se për shkak të një projektligji të propozuar, rrezikohet seriozisht pjesëmarrja e Kombëtares në botëror. Ky lajm ka ndezur edhe një herë shpresat për Kombëtaren italiane, e cila mund të jetë e përzgjedhura për të zëvendësuar Perunë, në eventin sportive më të rëndësishëm të botës. Deputetja peruane, Paloma Noceda ka dorëzuar për miratim një projektligj, që e vendos Federatën Peruane të Futbollit, nën varësinë e Institutit peruan të Sportit, që ka funksione ministrore në këtë shtet. Pikërisht ky fakt, është i papranueshëm nga FIFA, që kërkon pavarësinë e Federatave të Futbollit, nga institucionet shtetërore me funksion ministror. Projektligji pritet të kalojë për votim së shpejti dhe nëse miratohet, atëherë hapet rruga për pjesëmarrjen e Italisë në Botëror.

### Sulmon pikat e basteve në Shqipëri

## Cana vlerëson Taren: Nuk jam personi i duhur për ndryshim

Në një takim me temë "Gjithçka për fëmijët", ish-kapiteni i Kombëtares, Lorik Cana, ka theksuar se është mjaft pozitive nisma për të investuar për nxitjen e fëmijëve për të bërë sport, sepse para së gjithash kjo i bën mirë shoqërisë.

**A është projekti me fëmijët pikënisja e Canës pas futbollit të luajtur?**

Dëshira e madhe për të kontribuar për vendin ku jetojnë shqiptarët në përgjithësi më ka shtyrë që të përfshihem në projektet me fëmijët. Për të dhënë ndikimin pozitiv të sportit në shoqëri. Fondacioni është një pjesë që do më shoqërojë gjatë gjithë kohës në bashkëpunim me federatën dhe institucione të tjera për të mbështetur programe. E ndjej si detyrë për t'i realizuar këto projekte për të mirë të vendit dhe fëmijëve.

**Rudi Vata ju përmendi si personi i duhur për kreun e FSHF-së.**

Unë jam në një moment të jetës, që kam



shumë pak që jam larguar nga futbolli i luajtur dhe më duhet një kohë personale për të pushuar dhe për t'u përgatitur për karrierën që më pret. Nuk kam synime sidomos afatshkurtra për t'u bërë kreu i Federatës Shqiptare të Futbollit apo ndonjë institucion sportiv. Por kjo nuk do të thotë të mos angazhohem për të realizuar qëllimet e këtyre institucioneve. Kam më tepër ambicie jashtë vendit. Nuk i njoh mjaftueshëm njerëzit e sportit në vend, por ia u di nevojën. Unë e kam që nuk do merrem me politikë, por në sport nuk kam pse t'ia mbyll derën vetes. Pas disa vitesh ndoshta kur të kem pak më shumë njohje të realitet dhe mund të ndodhë që të kandidoj për postin e drejtuesit të FSHF-së.

**Komenti i Tares që futbolli shqiptar duhet të dalë nga bastet?**

Në Shqipëri ballafaqohesh me shumë probleme. Ballafaqohesh me një dashuri të madhe për sportin. Ka shumë pengesa në pjesën e infrastrukturës. Nga ana tjetër shoh njerëz që shohin shumë futboll që ty të bëjnë të ndihesh një lloj ngrohtësie. Në vendin tonë, çdo dy metra ke një pikë bastesh. Kjo të jep një ndjenjë të keq. Jemi shoqëruar në një shoqëri që e do sportin por në disa raste marrim pjesë të këqija të saj. Shoqëria është bërë shumë pasive. Ballafaqohesh me shumë ndjesi, duhen të rregullohen shumë gjëra.

**A ka nevojë federata për njerëz të rinj?**

Duhet të mbajmë njerëz që kanë përvojë, që të mbajnë di tyre vlera nga e kaluara, si dhe për efekt të njohjeve që kanë pasur. Por gjithmonë duhet të mbështetemi te njerëz të rinj, të cilët e njohin dhe realitetin tonë, por kanë qenë edhe jashtë. Është pjesë e rritjes sonë. Njerëzit e duhur në detyrat e duhura, kjo është pjesa më e rëndësishme. Nuk jam unë personi i duhur që mund të bëj ndryshime, Igli mund ta bëjë se ka më shumë përvojë dhe njohuri. Është nga Tirana dhe absolutisht duhet vlerësuar mendimi i tij.

Opinioni i Ditës

# Nuk ka shpëtim për Edi Komikun

Bardh Spahia

*(Vijon nga faqja e parë)*

... të pandalshëm.

Çfarë ishte më parë një dramë e tragjedi për vendin, po kthehet me shpejtësi në një shfaqje komike, ku edhe Edi Komiku, nuk po arrin dot të tërheqë vëmendjen nga gjithë çfarë ka ndodhur.

Nga gjithë çfarë po ndodh. Dhe mbi të gjitha, për parashikimet e zymta të asaj që pritet të ndodhe në një të nesërme të shpejtë.

Nuk ka çitjanet që e shpëtojnë njeriun që kërkon të ngrejë një sulltanat në këtë skaj Evropë.

Nuk ka shpëtim për njeriun që kërkon të sillet si sulltan në Tiranë dhe që tiraninë e djeshme, kërkon ta zëvendësojnë me detyrimin që vjen nga paraja e zezë e drogës. Me ato para që ai bleu zgjedhjet dhe me zgjedhjen e tij që t'i pastrojë ato para për të qëndruar në pushtet, me qëllimin për ta përdorur pushtetin si një imunitet të fortë që do ta mbrojë nga zullumet e tij.

Litari këputet duke u holluar dhe zullumi duke u trashur.

Kur opozita dha alarmin se vendi po kanabizohej, shumëkush, i bërë dru nga propaganda qeveritare e hashashit, bënte fajtore ish-qeverinë demokratike.

Ju vendosët ta kontrollonit këtë aktivitet në të gjithë Shqipërinë.

E filluat në disa zona pilot, për ta përhapur shumë shpejt në të gjithë vendin, më pas ju do të përfundonit me legalizimin e mbjelljes, kultivimit dhe trafikimit të kanabisit si një biznes shtetëror, i drejtuar nga një kupolë dhe me një organizim klasik të një strukture mafioze kriminale.

Ju doli nga duart. Sepse krimi bën pakt, por pakti me të është si shitja e shpirtit tek djalli. Dhe ju e bëtë këtë. Nga jugu në veri, nga lindja në perëndim, Shqipëria antiekologjike e Edi Ramës u bë Shqipëria e drogës.



Për të mbërritur në një ditë si e sotmja. Çfarë ka ndodhur me ju?

Në fillim nuk e pranonit fenomenin, sot e quani fitore tkurrjen e tij. Duke thënë si dhe herë të tjera një të vërtetë përgjysmë, e cila në thelb është një gënjeshtër e madhe.

Ju kapërcyet nga kanabisi te kokaina dhe heroina.

Nga cigarja e dredhur, tek këto droga të rënda. Nga shqetësimi lokal dhe rajonal, tek shndërrimi i vendit në një shqetësim të thellë ndërkombëtar. Shqipëria është kthyer përfundimisht në një nyje të rëndësishme të tranzitimit dhe magazinimit të këtyre drogave, që më pas depërtojnë në zemër të Evropës dhe madje kanë krijuar dhe një treg të konsoliduar përdoruesish vendës.

Kjo është fotografia e momentit, që dëshmon sesa dramatik do të jetë filmi i nesërm në Shqipërinë tonë.

Kjo është përgjigjja se pse partnerët tanë, ata amerikane dhe britanikë, gjermanë dhe italianë janë të shqetësuar për rritjen e frikshme të kriminalitetit shqiptar dhe rolin gjithmonë e më të fortë të tij në trafikun e drogave të renda.

Shqiptarët sot janë në Ekuador dhe në Kolumbi, në Peru e gjetkë në Amerikën Latine, tashmë jo si pengjet që garantojnë ardhjen e kokainës në Evropë, por si porositës të dorës së parë të saj. Si furnitorë të parë të saj, me sasi të mëdha paraje cash dhe me një infrastrukturë kriminale, që i bashkëngjitet edhe bashkëpunimi i strukturave të shtetit.

Ju duket i rëndë ky pohim? Shihni buxhetin, shihni statistikat.

Të gjithë sektorët e ekonomisë kanë shënuar rënie. Vetëm ndërtimi dhe sidomos ndërtimi i hoteleve dhe rezidencave luksoze kane njohur një boom të jashtëzakonshëm.

Lali Eri në Tiranë dhe pashallarët lokale në bregdet kanë dhënë leje të konsiderueshme ndërtimi, në këtë lavatriçe të madhe pastrimi parash. Shihni këtë detaj dhe mund të kuptoni se pse lehtësitë fiskale të qeverisë drejtohen pikërisht në këto sektorë. Nuk bëhen për shkak të një vizioni strategjik, por të një pragmatizmi okult, që kërkon të garantojë pastrimin e parave me një marzh sa më të vogël humbjeje.

Shpejt, është çështje ditësh kur do të nisim të diskutojmë edhe për import mbeturinash. Luftëtarët e djeshëm kundër kësaj nisme, sot e shohin një aspekt të tillë si mënyrën më të mirë për të nxjerrë nga kazanët e tyre paratë e lara të drogës.

Ka disa momente që ngrenë kokën dhe disa detaje në buxhetin që po diskutohet. Shihni Rrugën e Arbrit. Sipas qeverisë, kushton shumë më shumë se varianti që ofruan kinezët.

Shihni mënyrën e sjelljes ndaj biznesit të vogël. Qindra mijëra shqiptarë që jetojnë me një aktivitet të tillë dhe që qeveria e shitur si mbrojtëse e tyre dikur në opozitë, sot premton vetëm shtrëngimin e lakut.

Diskutimi i buxhetit duhet të jetë një ditë epike. Një ditë kur të gjithë bashkë, ligjvënësit të ndarë në ngjyra partiake, por të bashkuar nga shqetësimi për të ardhmen jo vetëm financiare të vendit, por edhe orientimin e tij.

Ne sot fatmirësisht jemi përballë jush. Ne do të ndeshemi me ju jo si në ndeshjen e zakonshme mes një qeverie dhe opozite, por me përplasjen mes shpresës dhe groposjes së saj përfundimtare.

Shqipëria nuk mund të jetë peng i çitjaneve dhe ëndrrave sulltanore të Edi Ramës. Dhe ai e di një gjë të tillë. E ka njohur shkëlqimin fals të tij dhe tani thjesht po shikon si gjithë shqiptarët, rënien e thellë në gremine. Por, pa Shqipërinë që t'i shkojë pas.

# Ratko Mladiq: Përbindëshi para drejtësisë

Po të kishte mundësinë të zgjedhë, Ratko Mladiqi do të zgjidhte sërish-Ratko Mladiqin. Ai nuk pendohet fare. Drejtësia fitoi, por a ka shpresë për B-H?

Shumë të thella dhe të gjata janë gjurmët e gjakut që kanë mbetur pas këtij plaku në Bosnje-Hercegovinë. Zotëruesi absolut i luftës së serbëve të Bosnje-Hercegovinës ka qenë në zenitin e fuqisë para 25 vitesh. Së shpejti ai mbase do të vdesë. Ndaj duket indiferent gjatë dhënies së dënimit, ndonëse thotë se nuk pendohet fare për asgjë. Incidentet e tij në Gjykatën e Hagës janë në përputhje totale me pohimet e tij të mëparshme, se kjo është "gjykata e djallit".

Ratko Mladiq mohon të pranojë realitetin, sikur edhe të gjitha qarqet shoviniste serbe në B-H dhe Serbi. Ato thonë se Tribunali i Hagës është një instrument politik kundër të gjithë serbëve. Në këtë mënyrë ata mohojnë edhe përgjegjësinë individuale të "heroit" të tyre dhe miqve të tij. Në këtë mënyrë marrin peng shumicën e qytetarëve normalë serbë.

Madje, edhe atëherë kur me të drejtë kritikojnë Tribunalin e Hagës, nuk ka pikë dyshimi që ish-gjenerali meriton procesin dhe dënimin për të gjitha që ka bërë në periudhën 1992-95 dhe për të gjitha që kanë ndodhur në B-H. Për keqardhje është vetëm fakti që godina e Tribunalit të Hagës nuk është në Sarajevë, Beograd apo Banjallukë. Nga afërsia do të ishte më e qartë se si "heroi" shndërrohet në një përbindësh të tmerrshëm. Ai nuk është në gjendje të shprehë madje asnjë fjalë pendimi apo keqardhje. Ai nuk ka asgjë për t'u thënë familjeve të viktimave, madje as familjeve të ushtarëve të tij të vrarë. Sikur Ratko Mladiq të kishte mundësinë që përsëri të zgjedhë, ai do të zgjidhte që sërish të jetë Ratko Mladiq.



Do të zgjidhte anën kundërshtare të botës së civilizuar, atë që vret njerëz të paarmatosur, të rinj dhe pleq. Barbarizëm është kur me vite të tëra bombardon lagje të tëra të qytetit dhe kur civilët i trajton si një objekt për argëtim sadist. E tmerrshme është sasia e urrejtjes që ai ka shprehur pas "çlirimit" të Srebrenicës dhe "hakmarrjes ndaj turqve". E pakuptimtë dhe totalisht e rrezikshme është të mendosh se humbjen e vitit 1389 (në betejën e Fushë Kosovës), mund ta kompensosh me realitetin e vitit 1995 (në Srebrenicë).

Ratko Mladiq për mua ka qenë prej fillimit grushti i verbër ideologjik dhe ushtarak i shovinizmit ekstrem serb, i cili kupton vetëm mbjelljen e vdekjes. Propaganduesit e shovinizmit të atëhershëm-sikur presidenti aktual i Serbisë Aleksandar Vuçiq-sot janë burrështetas të respektuar.

Për viktimat nuk do të ketë shumë ndryshime. Mladiqi për ta mbetet gjithmonë një kriminel cinik. Prehja e vetme për ta është që tani edhe gjykata konfirmoi atë që ata kanë menduar gjithmonë.

Për shumë ish-ushtarë të tij, dhe shumë serbë nga Bosnja, Mladiqi mbetet hero dhe viktimë e "komplotit antiserb". Pohimet e këtilla u shkojnë për dore edhe nacionalistëve boshnjakë, të cilët flasin "për serbët gjenocidialë". Politikanët populistë do ta shfrytëzojnë këtë për qëllimet e veta dhe shpresojnë lulëzimin e ri të tyre në Ballkan. Kjo është e kuptueshme, sepse pa një marrëveshje dhe mirëkuptim të përgjithshëm mes elitave politike boshnjake dhe serbe, nuk do të ketë as ndonjë koncept të qëndrueshëm për të ardhmen e Bosnje-Hercegovinës.

Kam frikë se dënimi i përbindëshit të vënë në dritaren ekspozuese të Tribunalit të Hagës, nuk do ta shuajë etjen për drejtësi në një vend, i cili edhe më tej është rob i mentalitetit të luftërave të viteve 90-të. Mladiqin e ka arritur drejtësia, por a jep shpresë ky vendim edhe për B-H? Kam frikë se për këtë është bërë tepër vonë.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

